



Botues: Rolf Gollob, Peter Krapf dhe Wiltrud Weidinger
Përkthyes: "UEGEN"
Përgjegjës për botimin shqip: Astrit Dautaj

Edukimi për demokraci

Materiale në ndihmë të mësuesve të edukimit për qytetari demokratike
dhe për të drejtat e njeriut

Edukimi për demokraci

Materiale mbështetëse për mësuesit e edukimit për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut

**Redaktorë përgjegjës: Rolf Gollob, Peter Krapf, Wiltrud Weidinger
Authorë: Rolf Gollob, Peter Krapf, Olof Olafsdottir, Wiltrud Weidinger**

Vëllimi I

i

Vëllimeve 1-6 për EQD/EDNJ

Edukimi për Qytetari Demokratike (EQD) dhe Edukimi për të Drejtat e Njeriut (EDNJ) në praktikën shkollore

Njësi mësimore, koncepte, metoda dhe modele

Botim i Këshillit të Europës

Idetë e shprehura në këtë botim janë përgjegjësi e autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare të Këshillit të Europës.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të përkthehet, të riprodhohet ose të transmetohet në çdo formë ose mjet, elektronik (CD-Rom, Internet etj) ose mekanik, duke përfshirë këtu edhe fotokopjimin, regjistrimin ose çdo sistem ruajtës informacioni, pa u pajisur paraprakisht me leje me shkrim nga Divizioni i Informimit Publik, Drejtoria e Komunikimit (F-67075 Strasbourg Cedex) ose publishing@coe.int.

Koordinimi për riprodhimin, faqosjen dhe redaktimin e këtij vëllimi është kryer nga IPE (Projekte Ndërkombëtare në Arsim; www.phzh.ch/ipe) i Universitetit të Edukimit të Mësuesve në Zyrë (Pädagogische Hochschule Zurich).

Ky projekt është financuar nga Agjencia Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (CDS)

pädagogische hochschule
Zurich



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confederation suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zviceriane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim CDS

International Projects in Education
www.phzh.ch/ipe

Ilustrimet: Peti Wiskemann
Kopertina: Peti Wiskemann
Faqosja: Jouve, Paris

Botim i Këshillit të Europës
F-67075 Strasbourg Cedex
<http://book.coe.int>

Këshilli i Europës, Dhjetor 2010,
Shtypur në Belgjikë

Bashkëpunuan:

Emir Adzovic - Bosnia and Herzegovina,

Laura Loder-Buchel - Switzerland Beatrice Burgler-Hochuli – Switzerland,

Sarah Keating-Chetwynd -Council of Europe

Sabrina Marruncheddu Krause - Switzerland

Svetlana Poznyak – Ukraine,

Arbër Salihu - Kosovo¹¹

Felisa Tibbitts - United States of America

1. Të gjitha referencat ndaj Kosovës, qofshin ato territoriale, institucionale ose të lidhura me popullsinë, në këtë tekst do të kuptohen në përputhje të plotë me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 dhe pa paragjyqime në lidhje me statusin e Kosovës

Përmbajtja

Hyrje	9
Qëllimet e këtij manuali	9
Vështrim i përgjithshëm për EQD/EDNJ	9
Pjesa 1 - Të kuptojmë demokracinë dhe të drejtat e njeriut	
Njësia 1 - Përmbajtja e koncepti	13
1. Politika, demokracia dhe qeverisja demokratike e shkollës	13
2. Të drejtat e fëmijëve dhe e drejta për arsim	19
Njësia 2 - Çelsi drejt një koncepti dinamik të qytetarisë	23
1. Sfidat ndaj modelit tradicional të qytetarisë	23
2. Kultura politike	26
Njësia 3 – Edukimi për demokraci dhe për të drejtat e njeriut	29
1. Tri përmasat e EQD/EDNJ	29
2. EDNJ dhe lidhja e tij me EQD	32
3. Kompetencat në EQD/EDNJ	34
4. Ne krijojmë botën në mendjet tona”: Të nxënit konstruktivist në EQD/EDNJ	38
5. Etika profesionale e mësuesve të EQD/EDNJ: tre parime	40
6. Koncepte themelore të EQD/EDNJ	42
7. Metoda bart mesazhin: të nxënit e bazuar në detyrë në EQD/EDNJ	46
8. Edukim i bazuar në të drejtat e njeriut	48
Njësia 4 - Edukimi për Qytetarinë Demokratike dhe Edukimi për të Drejtat e Njeriut - Një histori e shkurtër e metodologjisë së Këshillit të Europës	50
1. Kuadri	50
2. Rezultatet e projektit EQD/EDNJ	50
Instrumente praktikë	52
Pjesa 2 - Mësimdhënia e demokracisë dhe e të drejtave të njeriut	54
Njësia 1 – Kushtet e mësimdhënies dhe të mësuarit	55
1. Hyrje	55
2. Detyrat dhe çështjet kryesore që kushtëzojnë mësimdhënien dhe të mësuarit	55
Fletë pune 1: Si të shfrytëzoj aftësitë dhe njohuritë e nxënësve?	57
Fletë pune 2: Si të shfrytëzoj aftësitë dhe njohuritë e mia në fushën e mësimdhënies?	58
Fletë pune 3: Shqyrtimi i kushteve të përgjithshme të mësimdhënies dhe të mësuarit	59
Fletë pune 4: Cili është qëndrimi im ndaj nxënësve?	60
Fletë pune 5: Edhe një herë për disiplinën dhe rregullin nga pikëpamja demokratike	61
Fletë pune 6: Rishqyrtimi i rolit të mësuesit nga pikëpamja demokratike	62
Fletë pune 7: Si të zhvillojmë klimën demokratike në klasë?	63
Fletë pune 8: Si të kthejmë shkollën në një komunitet demokratik?	64
Njësia 2 – Vendosja e objektivave dhe përzgjedhja e materialeve mësimor	65
1. Hyrje	65

2. Detyrat dhe çështjet kryesore për vendosjen e objektivave dhe përzgjedhjen e materialeve mësimore	65
Fletë pune 1: Kompetencat e nxënësve për EQD/EDNJ	67
Fletë pune 2: Dy grupe materialesh mësimore në EQD/EDNJ	69
Fletë pune 3: Përzgjedhja dhe përdorimi i materialeve mësimore të EQD/EDNJ	71
Njësia 3 - Të kuptojmë politikat	73
1. Hyrje: Çfarë duhet të mësojnë nxënësit?	73
2. Detyra dhe çështje kryesore për të kuptuar politikat	73
Fletë pune 1: Si mund të trajtoj çështjet e politikës në klasat e EQD/EDNJ ?	75
Fletë pune 2: Si mund të mbështes nxënësit në gjykimin e çështjeve politike	78
Njësia 4 – Drejtimi i procesit të të nxënësve dhe përzgjedhja e formave të mësimdhënies	81
1. Hyrje	81
2. Detyra dhe çështje kryesore për drejtimin e proceseve të të nxënësve dhe përzgjedhjen e metodave të mësimdhënies	81
Fletë pune 1: Tri fazat e një procesi të mësuari	83
Fletë pune 2: Përse metoda tradicionale e mësimdhënies nuk është e mjaftueshme; çfarë thotë mësuesi ndryshon nga ajo çfarë mësohet nga nxënësi dhe ajo që mësohet nga nxënësi ndryshon nga ajo që zbatohet në jetën reale	87
Fletë pune 3: Përzgjedhja e metodave të përshtatshme të mësimdhënies dhe të mësuari	89
Fletë pune 4: Pesë forma bazë të mësimdhënies dhe të mësuarit	90
Njësia 5 – Vlerësimi i nxënësve, mësuesve dhe shkollave	93
1. Hyrje	93
2. Detyra dhe çështje kryesore për vlerësimin e nxënësve, mësuesve dhe shkollave	94
Fletë pune 1: Dimensionet e ndryshme të të mësuarit.	95
Fletë pune 2: Qëndrimet për vlerësimin	97
Fletë pune 3: Qëndrimet dhe format e vlerësimit	98
Fletë pune 4: Standardet referencë për vlerësimin	101
Fletë pune 5: Vlerësimi i nxënësve – ndikimi i vlerësimit në qëndrimin ndaj vetes	102
Fletë pune 6: Listë kontrolli: “Si i vlerësoj unë nxënësit e mi?”	103
Fletë pune 7: Vlerësimi i mësuesve	104
Fletë pune 8: Vetëvlerësimi i mësuesve	105
Fletë pune 9: Puna me gazetatat, ditaret, portofolet	107
Fletë pune 10: Mësimdhënia në bashkëpunim dhe vlerësimi mes kolegëve	108
Fletë pune 11: Vlerësimi i EQD/EDNJ në shkollë	110
Fletë pune 12: Treguesit e cilësisë së EQD/EDNJ në një shkollë	111
Fletë pune 13: Parime të përgjithshme për vlerësimin e EQD/EDNJ	112
Fletë pune 14: Udhëzime për vetëvlerësimin e shkollës	114
Fletë pune 15: Përfshirja e aktorëve të ndryshëm në procesin e vlerësimit të EQD/EDNJ në shkollë	115
Fletë pune 16: Qeverisja dhe menaxhimi në shkollë	116
Fletë pune 17: Të përqendrohemi në qeverisjen demokratike të shkollës	117
Fletë pune 18: Si të analizojmë dhe të interpretojmë rezultatet e vlerësimit të	118

Part 3 - Instrumente për të mësimdhënien dhe të mësuarit e demokracisë dhe të të drejtave të njeriut	119
Njësia 1 – Instrumente për mësuesit	123
1. Hyrje	123
Instrumenti 1: Të nxënit e bazuar në projekte	124
Instrumenti 2: Të nxënëet në bashkëpunim	125
Instrumenti 3: Drejtimi i seancave plenare (diskutim dhe mendim kritik) në veprimtaritë e EQD/EDNJ	126
Instrumenti 4: Intervistë me një ekspert – Si të mbledhim informacionin e duhur?	130
Instrumenti 5: Si të përcaktojmë objektivat e mësimdhënies që bazohen në kompetencat?	132
Njësia 2 – Instrumente për nxënësit	134
1. Hyrje	134
Instrumenti 1: Fletë pune për nxënësit për të planifikuar të nxënit	135
Instrumenti 2: Fletë pune për nxënësit për të reflektuar për të mësuarit e tyre	136
Instrumenti 3: Fletë pune për nxënësit për të reflektuar për arritjet e tyre	137
Instrumenti 4: Kërkimi në biblioteka	138
Instrumenti 5: Kërkimi në internet	139
Instrumenti 6: Intervistat dhe anketat	140
Instrumenti 7: Si të interpretojmë fotografitë	142
Instrumenti 8: Hartat mendore	144
Instrumenti 9: Si të krijojmë postera	145
Instrumenti 10: Si të organizojmë ekspozita	146
Instrumenti 11: Si të planifikojmë dhe të prezantojmë	148
Instrumenti 12: Si të paraqesim idetë tona përmes fletëve transparente ose power point	150
Instrumenti 13: Si të shkruajmë artikuj për gazetat	151
Instrumenti 14: Si të vemë në skenë idetë dhe ndjenjat	152
Instrumenti 15: Si të organizojmë debate	154

Hyrje

1. Qëllimi i këtij manuali

Objektivi i këtij manuali është të mbështesë mësuesit dhe veprimtarët në fushën e Edukimit për Qytetarinë Demokratike dhe të të Drejtave të Njeriut (EQD/EDNJ) – trajnerët, drejtuesit, inspektorët, autorët e teksteve dhe botuesit. Ai përqendrohet në çështje themelore të EQD dhe EDNJ, si më poshtë:

- Cilat janë kompetencat që qytetarët i kanë të nevojshme për të marrë pjesë në komunitetin e tyre?
- Cilët janë objektivat e EQD/EDNJ?
- Cilat janë parimet bazë të EQD/EDNJ?
- Cila është përmbajtja e koncepteve që formojnë thelbin e këtij botimi për EQD/EDNJ?
- Si lidhen konceptet e të mësuarit konstruktivist me EQD/EDNJ?
- Pse EQD/EDNJ vë theksin në metodën që përfshin në këtë edukim të gjithë shkollën?
- Si të ndihmojmë mësuesit të përgatisin, të mbështesin dhe të vlerësojnë proceset e të mësuarit në EQD/EDNJ?

Manuali ofron materiale dhe instrumente mbështetëse për t'u dhënë përgjigje këtyre pyetjeve. Ky libër nuk është një traktat në fushën e EQD/EDNJ. Për këtë arsye, ai e lejon përdoruesin të përzgjedhë kapitujt dhe materialet që mund të përdorë.

Ky manual ndryshon nga pesë manualet e tjerë të këtij botimi prej gjashtë vëllimesh për EQD/EDNJ. Vëllimet 2-4 përmbajnë përshkrimin e modeleve të projekteve dhe njësisive mësimore prej katër mësimesh. Një grup prej nëntë konceptesh përcakton kornizën e një kurrikule për ciklin parauniversitar, të organizuar në formë spirale. Vëllimi 5 përshkruan modelin e nëntë projekteve të shkurtër për të drejtat e fëmijëve në arsimin parashkollor dhe fillor. Vëllimi 6 përmban një përmbledhje të modeleve për të mësuarit ndërveprues dhe atë me bazë projekti.

Pjesa e parë e këtij manuali, në një rën anë, skicon parimet themelore të EQD/EDNJ dhe rëndësinë e tyre për mësuesit dhe veprimtarët e këtij edukimi. Pjesa e dytë ofron udhëzime dhe instrumente për të hartuar, mbështetur dhe vlerësuar proceset e të mësuarit konstruktivist. Pjesa e tretë përmban instrumente për mësuesit dhe nxënësit në fushën e EQD/EDNJ. Përdoruesi do të zbulojë që këto udhëzime dhe instrumente mbështesin jo vetëm EQD/EDNJ, por edhe efektivitetin e mësimdhënies në përgjithësi.

2. Vështrim i përgjithshëm i EQD/EDNJ

Objektivi i EQD/EDNJ, siç paraqitet edhe në titullin e këtij manuali (Edukimi për demokraci), është të aftësojë dhe të nxisë nxënësit si qytetarë të rinj, për të luajtur rol aktiv në shoqërinë dhe komunitetin e tyre politik. Për të marrë pjesë në një komunitet demokratik, nxënësit kanë nevojë të zhvillojnë një numër të madh kompetencash, të cilat përfshijnë njohuri, aftësi teknike e metodike dhe vlera e qëndrime, të tilla si toleranca e përgjegjësia.

“Edukimi për qytetarinë demokratike dhe edukimi për të drejtat e njeriut ndërthuren ngushtë dhe e mbështesin njëri-tjetrin në mënyrë të ndërsjellë. Ata ndryshojnë jo aq në synimet dhe praktikatat se sa në fushën e veprimit të tyre. Edukimi për qytetari demokratike përqendrohet kryesisht në të drejtat, në përgjegjësitë demokratike dhe në pjesëmarrjen aktive në fushën qytetare, politike, shoqërore, ekonomike, ligjore dhe kulturore të shoqërisë, ndërsa edukimi për të drejtat e njeriut lidhet me fushën e gjerë të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore në çdo aspekt të jetës së njerëzve”² Për këtë arsye, EQD vë theksin në rolin e të rinjve në komunitet, ndërsa EDNJ i shikon individin, identitetin, nevojat dhe dëshirat, liritë dhe përgjegjësitë e tij nën “lenten e të drejtave të njeriut”.

2. Karta e Këshillit të Europës për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut, e miratuar në kuadrin e Rekomandimit CM/Rec(2010) 7 të Komitetit të Ministrave (www.coe.int/edc).

EQD/EDNJ thekson rolin aktiv të nxënësve si qytetarë të rinj, duke ngulur këmbë në nevojën që ata kanë për të ditur, për të kuptuar dhe për të vlerësuar të drejtat e tyre njerëzore dhe, përmes trajnimit në klasë dhe përvojës praktike në jetën e shkollës, të fitojnë besimin për t'i ushtruar ato në praktikë. Për këtë arsye, mund të themi që EQD/EDNJ përbën një hap të rëndësishëm përpara, në krahasim me mënyrën tradicionale të edukimit qytetar. Në këtë mënyrë, duke vlerësuar interesat dhe përvojat e tyre të jetës së përditshme, EQD/EDNJ i trajton edhe nxënësit si ekspertë.

EQD/EDNJ përdor metodën *holistike* të mësimdhënies dhe të mësuarit, e cila përmbledhet në tri parime:

- Të mësuarit *rreth* demokracisë dhe të drejtave të njeriut.
- Të mësuarit *për* demokracinë dhe të drejtat e njeriut.
- Të mësuarit *përmes* demokracisë dhe të drejtave të njeriut.

2.1 Të mësuarit *rreth* demokracisë dhe të drejtave të njeriut

Për nxënësit është e rëndësishme të kuptojnë thelbin e demokracisë dhe të të drejtave të njeriut, të njohin dokumentet që i përmbajnë dhe si mund të mbrohen e të zbatohen ato. Si qytetarë të rinj, ata duhet të njohin mënyrën si kushtetuta e vendit të tyre funksionon si një sistem politik.

2.2 Të mësuarit *për* demokracinë dhe të drejtat e njeriut

Qytetarët e rinj duhet të mësojnë si të marrin pjesë në komunitetet e tyre dhe si të ushtrojnë të drejtat e njeriut: "Vlerat dhe praktikat demokratike duhet të mësohen dhe të rimësohen për të trajtuar sfidat me cilat përmballet çdo brez. Për t'u bërë anëtarë të plotë dhe aktivë të shoqërisë, qytetarëve duhet t'u krijohen mundësitë për të punuar së bashku në interes të të mirës së përbashkët. Ata duhet të respektojnë pikëpamjet e ndryshme dhe të kundërta; të marrin pjesë në proceset politike; të kultivojnë qëndrimet dhe vlerat e demokracisë dhe të të drejtave të njeriut në jetën dhe veprimtaritë e përditshme. Kështu, ata do të ndihen e do të pranohen si anëtarë të dobishëm të komunitetit, të aftë të marrin pjesë e të sjellin ndryshime në shoqëri."³

2.3 Të mësuarit *përmes* demokracisë dhe të drejtave të njeriut

Nxënësit kanë nevojë për një mjedis mbështetës të mësuarit. Ata duhet të përfshihen në veprimtari të mësuarit dhe mësimdhënies që u mundësojnë ushtrimin e të drejtave të tyre njerëzore, si liria e mendimit dhe e shprehjes. Atyre duhet t'u krijohen mundësitë për të marrë pjesë në qeverisjen e shkollës së tyre, për të ushtruar të drejtat dhe për të përmbushur përgjegjësitë e tyre. Ata mbështeten në mësuesit e tyre për të ofruar modele të respektit të ndërsjellë, të tolerancës dhe të zgjidhjes paqësore të konfliktit. Nga kjo pikëpamje, demokracia dhe të drejtat e njeriut shërbejnë si udhëzues pedagogjik, si për EQD/EDNJ, si lëndë e veçantë në shkollë, ashtu edhe për vetë shkollën, si mikromjedis shoqëror.

EQD/EDNJ shtron sfida të shumta për nxënësit, mësuesit dhe shkollat. Ky manual u ofron mësuesve dhe veprimtarëve të shkollës udhëzime dhe mbështetje për t'i zgjidhur ato.

3. Hartley M. and Huddleston T. (2009), Partneriteti *Shkollë-Komunitet-Universitet për një demokraci të qëndrueshme: Edukimi për demokraci në Europë dhe në Shtetet e Bashkuara*. Paketa EQD/EDNJ, Instrumenti 5, Këshilli i Europës, Strasbourg, fq. 8 (www.coe.int/edc).

Pjesa 1

TË KUPTOJMË DEMOKRACINË

DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Njësia 1

Përmbajtja e konceptit

Njësia 2

Çelsi drejt një koncepti dinamik të qytetarisë

Njësia 3

Edukimi për demokraci dhe të drejtat e njeriut

Njësia 4

Edukimi për Qytetari Demokratike dhe Edukimi për të Drejtat e Njeriut-Një histori e shkurtër e metodës së Këshillit të Europës

Ideja e edukimit për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut nuk është e re. Për shumë vite edukimi civik ose qytetar ka qenë i pranishëm dhe është zbatuar në mënyra të ndryshme në shumë vende të Europës. Kryesisht, përmbajtja e tij synonte informimin e nxënësve, përmes metodave tradicionale të mësimdhënies, për sistemin politik, domethënë, për kushtetutën që është në fuqi në vendin e tyre. Qytetaria që buron nga një mësimdhënie e tillë është pasive dhe e kufizuar në fushën e veprimit të saj. Për pjesën më të madhe të njerëzve qytetaria nënkuptonte kryesisht bindjen ndaj ligjit dhe votimin në zgjedhjet publike. Këto përgjegjësi janë pjesë e mjedisit ligjor dhe kulturor në të cilin jetojnë qytetarët. Disa vende kanë përfshirë edhe edukimin e të drejtave të njeriut në kurrikulat e tyre. Arsimitarët e Europës, gjithnjë e më shumë, po pranojnë lidhjen ndërmjet edukimit për qytetari demokratike dhe edukimit për të drejtat e njeriut.

Ngjarjet dhe ndryshimet që kanë ndodhur në dhjetëvjetëshat e fundit në Europë e kanë sfiduar dhe po e sfidojnë këtë model të qytetarisë. Ndër këto ndryshime përmendim:

- konfliktet etnike dhe nacionalizmi;
- rreziqet dhe pasiguria globale;
- zhvillimi i teknologjive të reja të informimit dhe të komunikimit;
- problemet mjedisore;
- lëvizjet e popullsisë;
- shfaqja e formave të reja të identiteteve kolektive të së kaluarës;
- kërkesa për rritje të autonomisë personale dhe të formave të reja të barazisë;
- dobësimi i kohezionit social dhe i solidaritetit ndërmjet njerëzve;
- dyshimi ndaj institucioneve politike tradicionale, formave të qeverisjes dhe lidershit politik.
- rritja e ndërlidhjes dhe ndërvarësisë politike, ekonomike dhe kulturore, në nivel rajonal dhe global.

Këto sfida kërkojnë edhe një lloj të ri qytetari: qytetar që jo vetëm njeh dhe kupton përgjegjësitë e tij qytetare, por edhe është aktiv e i aftë të kontribuojë vullnetarisht në jetën e komunitetit, të vendit dhe të botës, si dhe të marrë pjesë aktive e të shprehë individualizmin dhe të zgjidhë problemet.

Njësia 1

Përmbajtja e konceptit

1. Politika, demokracia dhe qeverisja demokratike e shkollës

Qëllimi i EQD/EDNJ, është të aftësojë dhe të nxisë të rinjtë të marrin pjesë në komunitetin ku jetojnë. Ky qëllim lidhet me konceptin e demokracisë dhe të politikës. Qeverisja demokratike e shkollës luan një rol thelbësor në EQD/EDNJ, sepse ai ofron për nxënësit mundësitë të mësojnë të marrin pjesë në një komunitet. Për këtë arsye, kjo njësi mësimore shqyrton këto tri koncepte, si pjesë qendrore për EQD/EDNJ.

1.1 Politika

1.1.1 Politika – Loja e pushtetit dhe zgjidhja e problemit

Lexusit e gazetave ose ndjekësit e lajmeve televizive do të vënë re se raportet e medias për politikën ndahen në dy kategori:

- *Politikanët sulmojnë kundërshtarët e tyre.* Në këtë mënyrë, ata mund të vënë në dyshim integritetin e rivalëve, aftësinë e tyre për të drejtuar ose për të zgjidhur probleme të veçanta. Ky perceptim i politikës – si një “*punë e ndyrë*”- i bën njerëzit të largohen me përbuzje prej saj.
- *Politikanët diskutojnë për zgjidhjet e problemeve të vështira të vendit ose të vendeve të tyre.*

Këto dy kategori dukurish politike i përgjigjen përcaktimit klasik të Maks Veber për politikën:

- Politika është çështje e luftës për pushtet. Pa pushtet, asnjë forcë politike nuk mund të përmbushë objektivat e saj. Në sisteme demokratike, forcat politike konkurrojnë me njëra-tjetrën, për të siguruar miratimin e publikut dhe mbështetjen e shumicës. Për këtë arsye, pjesë e lojës politike është sulmi ndaj kundërshtarëve, për shembull, në fushata elektorale, për të tërhequr votuesit dhe anëtarë të rinj të partisë.
- Politikë do të thotë “të hapësh ngadalë, me pasion e gjykim të shëndoshë, vrimat në një pllakë të trashë druri”.⁴ Metafora nënkupton përpjekjen për të zgjidhur problemet politike. Këto probleme kanë nevojë për kohën e duhur për t’u trajtuar, pasi ato, përveçse janë urgjente, kanë ndikim në të gjithë shoqërinë. Si të tilla, ato janë komplekse e të vështira për t’u zgjidhur. Politika është njëherazi, sa e rëndësishme, aq edhe praktike. Për këtë arsye diskutimet e saj duhet të shoqërohen me vendime konkrete.

Politika në mjediset demokratike kërkon aktorë politikë të aftë të kryejnë role të ndryshme. Lufta për pushtet kërkon figura politike tërheqëse, që zotërojnë pushtetin e fjalës dhe aftësinë për të shpjeguar çështjet e ndryshme me fjalë të thjeshta. Sfidat e zgjidhjes së problemeve të mëdha të ditës dhe të të ardhmes sonë, kërkon njerëz me përvojë shkencore, me përgjegjësi e qëndrueshmëri morale.

1.1.2 Politika në demokraci – një kërkesë e domosdoshme


Fillimisht, ne mendojmë për udhëheqësit politikë që duhet të përmbushin këto standarde, të cilat bien ndesh dhe priren të përjashtojnë njëri-tjetrin. Shembujt për udhëheqës politikë që mbajnë qëndrime të skajshme – të populistit dhe të profesorit- janë të shumtë. Njëri skaj priret të kthejë politikën në një skenë shfaqjeje, ndërsa tjetri - në një sallë leksioni. I pari fiton zgjedhjet, por bën pak për shoqërinë. I dyti mund të ketë ide të mira, por që nuk kuptohen nga shumica.

Megjithatë, me dilema të tilla nuk përballen vetëm udhëheqësit politikë dhe vendimmarrësit, por edhe qytetarët që dëshirojnë të marrin pjesë në politikë. Koha për të folur në mjediset publike është e kufizuar dhe, në to, do të kenë sukses vetëm folësit që arrijnë të shprehin qartë dhe thjesht idetë e tyre. Mësuesit do të zbulojnë ngjashmërinë që ekziston ndërmjet komunikimit në publik dhe komunikimit në shkollë – koha e pamjaftueshme, nevoja për të qenë, njëherazi, i qartë dhe i thjeshtë si dhe aftësia për të menaxhuar kompleksitetin e çështjeve.

4. Weber M. (1997), *Politik als Beruf (Politika si profesion)*, Reclam, Stuttgart, p. 82 (përkthyer nga Peter Krapf).

Ushtrimi i të drejtave të njeriut, si liria mendimit dhe e shprehjes, marrja pjesë në zgjedhje, është detyrë e çdo qytetari. Në EQD/EDNJ, të rinjtë trajnohen në dimensione të ndryshme kompetencash dhe me idenë e nevojës për të marrë pjesë në debatet publike dhe në proceset e vendimmarrjes. Nxënësit, si anëtarë të komunitetit të shkollës, mësojnë të marrin pjesë në një shoqëri që qeveriset nga parimet e demokracisë dhe të të drejtave të njeriut.

1.1.3 Modeli ciklik i politikës: politika si një proces i zgjidhjes së problemeve të komunitetit.



Modeli ciklik i politikës është një instrument për të përshkruar dhe kuptuar proceset e vendimmarrjes politike. Ai përqendrohet në aspektet e përcaktimit të Maks Weber për politikën si "një hapje e ngadaltë, me pasion e gjykim të shëndoshë, e vrimave në një pllakë të trashë druri".

Politika perceptohet si procesi i përcaktimit të problemeve politike në procesin kontradiktor të hartimit të programit politik. Përcaktimi i një problemi politik, ashtu edhe përjashtimi nga programi i interesave të tjera, kërkon përfshirjen e rëndësishme të pushtetit. Modeli ofron një përshkrimin ideal të fazave të njëpasnjëshme të vendimmarrjes politike: debati dhe vendimmarrja për zbatimin e zgjidhjeve. Opinioni publik dhe kundërpërgjigjet e personave dhe grupeve të cilëve u preken interesat tregojnë nëse zgjidhjet do t'i shërbejnë qëllimit të tyre dhe, për rrjedhojë, do të pranohen. Për të bërë të njohura interesat e tyre të mohuara, pakicat ose grupet dobëta e të paafta duhet të shprehin protestën dhe kritikizmin e tyre. Nëse përpjekja për të zgjidhur një problem është e suksesshme (ose vlerësohet si e tillë), cikli politik merr fund (ndërprerja e politikës); nëse ajo dështon, cikli rifillon. Në disa raste, zgjidhja një problemi shkakton probleme të reja të cilat duhet të shihen nën një cikël të ri politik.

Modeli i ciklit politik thekson rëndësinë e aspekteve të vendimmarrjes politike në një sistem demokratik dhe të qeverisjes demokratike të shkollës.

- Përmbajtja e konceptit "problem politik" dhe "e mirë e përbashkët" nuk është e dhënë njëherë e përgjithmonë. Askush nuk mund të japë një përkufizim të të mirës së përbashkët që të vlejë për të gjithë dhe për të gjitha kohërat. Partitë, grupet dhe individët që marrin pjesë në një proces duhet të arrijnë një kompromis në lidhje me të;
- Hartohen programe konkurruese; shpesh herë, në shoqëri pluraliste, argumentet politike lidhen me interesat.

- Në realitetin social, pjesëmarrja nuk është e përsosur; disa individë dhe grupe humbasin sistematikisht të drejtat ndaj pushtetit dhe proceseve të vendimmarrjes politike dhe, për këtë arsye, kthehen në një model që kërkon vëmendje për rritjen e të drejtës së grupeve me më pak pushtet për të pasur më shumë të drejta në këtë drejtim.
- Vendimmarrja politike është proces i të mësuarit kolektiv, në të cilin mungojnë aktorët që dinë gjithçka (si udhëheqësit ose partitë e pajisura me ideologjitë e shpëtimit). Kjo nënkupton konceptin konstruktivist të të mirës së përbashkët: *E mira e përbashkët është çfarë shumica e beson të tillë në një kohë të dhënë.*
- Ndikimi i opinionit publik dhe i medias është i madh- më shumë mundësi për qytetarët dhe grupet e interesit për ndërhyrje dhe pjesëmarrje.

Cikli politik është një model – një skicë që punon si një hartë gjeografike. Ajo tregon shumë dhe ofron edhe logjikën për ta kuptuar. Për këtë arsye, modelet përdoren si në arsim ashtu dhe në shkencë, sepse pa modele ne do të kuptonim shumë pak nga kompleksiteti i botës së sotme.

Ne asnjëherë nuk gabojmë në kuptimin e një harte fizike-një hartë tregon shumë, por vetëm sepse ajo, në të njëjtën kohë, lë jashtë shumë. Një hartë që do të tregonte shumë do të ishte shumë e vështirë për t'u kuptuar nga të gjithë. Kjo është e vërtetë edhe për modele të tilla si cikli politik. Ky model asnjëherë nuk do të ngatërrohej me realitetin. Ai përqendrohet në proceset e vendimmarrjes politike – "një hapje e ngadaltë, me pasion e gjykim të shëndoshë, e vrimave në një pllakë të trashë druri"- por që i kushton më pak vëmendje dimensionit të dytë të politikës, sipas përcaktimit të Maks Veber, çështjes dhe luftës për pushtet dhe ndikim.

Në sisteme demokratike, të dyja dimensionet e politikës janë të ndërlidhura: vendimmarrësit e politikave ndeshen me problemet e vështira dhe me njeri-tjetrin si kundërshtarë politikë. Në modelin ciklik të politikës, faza e hartimit të programit tregon mënyrën si ndërthuren këto dy dimensionet. Përcaktimi i një problemi politik në një program mbetet çështje pushteti dhe ndikimi.

Po japim një shembull: Një grup pretendon se "Taksat janë shumë të larta dhe frikësojnë investitorët", ndërsa grupi i dytë mbron pikëpamjen se "Taksat janë shumë të ulëta dhe, për këtë arsye, arsimi dhe siguria sociale nuk marrin mbështetjen e duhur financiare". Prapa çdo përcaktimi të problemit të taksave qëndrojnë interesa dhe qëndrime themelore politike dhe zgjidhjet, që ato nënkuptojnë, të çojnë në kahe të kundërta: pakësim të taksave për grupet me të ardhurat më të larta – ose ngritje e tyre. Përcaktimi i problemit të parë është neoliberal, i dyti është social demokrat.

Qytetarët duhet të njihen me të dyja qëndrimet. Modeli ciklik i politikës është instrumenti që ndihmon qytetarët të identifikojnë dhe të gjykojnë përpjekjet e vendimmarrësve politikë për të zgjidhur problemet e shoqërisë.

1.2 Demokracia

1.2.1 Parimet themelore

Në vitin 1863, Abraham Linkoln e përcaktoi demokracinë si: "qeverisje e popullit, nga populli, për popullin". Si mund të kuptohet përmbajtja e kësaj thënieje të famshme?

- Qeverisje e popullit do të thotë që pushteti buron nga populli. Populli është bartës i sovranitetit, që ushtron pushtetin ose jep mandatin për ushtrimin e këtij pushteti, dhe të gjithë ata që janë pjesë e këtij pushteti janë edhe përgjegjës përpara popullit.
- Qeverisje nga populli do të thotë që pushteti ushtrohet nga përfaqësuesit e zgjedhur ose drejtpërdrejt prej qytetarëve.
- Qeverisje për popullin do të thotë që pushteti ushtrohet për t'i shërbyer interesave të popullit, domethënë, të mirës së përbashkët.

Këto përcaktime mund të kuptohen dhe të ndërlidhen në mënyra të ndryshme. Mendimtarët politikë të traditës së Rusoit ngulin këmbë në sundimin e drejtpërdrejtë nga qytetarët (identiteti i të qeverisurve dhe qeveria). Populli vendos për gjithçka dhe nuk kufizohet nga ligjet. Mendimtarët politikë të traditës së Lok-ut theksojnë konkurrencën ndërmjet interesave të ndryshme në një shoqëri pluraliste; në kuadrin e një kushtetute ata duhet të merren vesh për vendime që i shërbejnë të mirës së përbashkët.

Demokracia nuk vjen vetvetiu, pavarësisht nga tradita demokratike e një vendi dhe nga mënyra si ajo është zhvilluar. Në çdo vend, demokracia dhe kuptimi i të drejtave të njeriut duhet të jenë përherë në zhvillim. Vetëm në këtë mënyrë, ajo do t'i japë çdo brezi mundësitë për të zgjidhur sfidat me të cilat përballlet, ndërkohë që ai ka detyrën të edukohet për demokracinë dhe për të drejtat e njeriut.

1.2.2 Demokracia si një sistem politik

Një demokraci kushtetuese bashkëkohore përfshin elementë të tillë, si:

- Kushtetuta, zakonisht e shkruar, përcakton kuadrin institucional për demokracinë, që në disa vende, mbrohet nga një gjykatë e lartë e pavarur; të drejtat e njeriut, që mbrohen (zakonisht jo të gjitha) si të drejta civile;
- Të drejtat e njeriut shpallen në kushtetutë dhe konkretizohen si të drejta civile që garantoohen nga kushtetuta. Qeveritë që kanë firmosur konventat e të drejtave të njeriut janë të detyruar të mbrojnë të drejtat që kanë ratifikuar, pavarësisht nëse ato përfshihen apo jo në kushtetutë.
- Statusi i barabartë ligjor i të gjithë qytetarëve: të gjithë qytetarët mbrohen në mënyrë të barabartë nga ligji përmes parimit të mosdiskriminimit dhe duhet të përmbushin detyrimet e tyre ligjore.
- E drejta universale e votës: Kjo u jep qytetarëve të rritur, burra e gra, të drejtën për të votuar për partitë ose kandidatët në zgjedhjet parlamentare. Përveç kësaj, disa sisteme përfshijnë referendumin ose plebishitin, domethënë, të drejtën e qytetarëve për të marrë vendime për çështje të caktuara përmes votës së drejtpërdrejtë.
- Qytetarët gëzojnë të drejta njerëzore që u garantojnë atyre mundësi të madha për pjesëmarrje. Këtu përfshihet liria e medias nga censura dhe kontrolli shtetëror, liria e mendimit, e shprehjes dhe e grumbullimeve paqësore, e drejta e lirisë së veprimit të pakicave dhe të kundërshtarëve politikë.
- Pluralizmi dhe konkurrenca e interesave dhe e objektivave politikë: qytetarët e veçantë dhe grupet mund të formojnë ose të bashkohen në parti ose grupe interesi, organizata joqeveritare etj., për të nxitur interesat ose objektivat e tyre politikë. Konkurrenca në nxitjen dhe zhvillimin e interesave dhe shpërndarja e pabarabartë e pushteteve dhe e shanseve për realizimin e tyre janë gjithmonë të pranishme në shoqëri.
- Parlamenti: organi i përfaqësuesve të zgjedhur ka pushtet ligjvënës, domethënë, për të miratuar ligjet, të cilat, në përgjithësi, kanë karakter detyrues. Autoriteti i parlamentit qëndron në vullnetin e shumicës së votuesve. Nëse shumica e votuesve në një sistem parlamentar zhvendoset nga një zgjedhje në tjetrën, kjo sjell edhe një qeveri të re. Në një sistem presidencial, kryetari i qeverisë- presidenti -zgjidhet me votë të drejtpërdrejtë.
- Sundimi i shumicës: shumica vendos, pakica duhet të pranojë vendimin. Kushtetuta përcakton kufijtë për sundimin e shumicës, kështu mbron të drejtat dhe interesat e pakicave. Numri më i vogël i anëtarëve të parlamentit, i detyrueshëm për të votuar, mund të ndryshojë në varësi të çështjes për të cilën votohet. Për shembull, për të votuar për kushtetutën kërkohen dy të tretat e parlamentarëve.
- Kontrolli dhe kufizimi i pushtetit: demokracia harmonizon dy parime: autoriteti për të ushtruar forcë i takon shtetit. Kjo shtrihet deri të “çarmatosja e qytetarëve”.⁵ Megjithatë, për të parandaluar shndërrimin e pushtetit për të ushtruar forcë në një sundim autokratik ose dikatorial, të gjitha demokracitë zbatojnë parimin e kontrollit dhe të barazpeshës së pushteteve. Modeli klasik e ndan pushtetin në tri degë: në pushtetin legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor (dimensioni horizontal). Shumë sisteme marrin masa të mëtejshme: një sistem legjislativ të përbërë nga dy dhoma, autonomi federale ose kantonale, që ngrihet deri në dimensionin vertikal të kontrollit dhe të barazpeshës së pushteteve (Zvicër, SHBA ose Gjermani).
- Autoriteti i përkohshëm: një mjet i mëtejshëm i kontrollit të pushtetit është dhënia e pushtetit për një kohë të shkurtër. Ky është tipar i çdo zgjedhjeje dhe, në disa raste, e tërë periudha e mbajtjes së pushtetit mund të kufizohet, si në rastin e presidentit të SHBA, i cili mund të zgjidhet vetëm për dy periudha katër vjetore. Në Romën e lashtë, konsujt zgjidheshin me radhë dhe duhet të linin postin pas një viti.

1.2.3 Një keqkuptim i të drejtave të njeriut dhe i demokracisë

Demokracia bazohet në standardet dhe parimet e të drejtave të njeriut. Të drejtat e njeriut shpesh keqkuptohen si një sistem në të cilin individët gëzojnë liri të plotë. Megjithatë, çështja nuk qëndron kështu:

5. Ekziston një shembull shumë kuptimplotë se si ky parim i çarmatosjes së qytetarëve, ka ndryshuar për shembull, në SHBA.

Të drejtat e njeriut pranojnë të drejtat dhe liritë individuale, të cilat janë pjesë e qenësishme e qenieve njerëzore. Megjithatë këto të drejta nuk janë absolute. Të drejtat e të tjerëve duhet të respektohen. Ndonjëherë ato hyjnë në konflikt me njëra-tjetrën. Proceset demokratike ndihmojnë proceset që, nga njëra anë, lehtësojnë lirinë e njerëzve dhe, nga ana tjetër, vendosin kufizime të nevojshme për to. Për shembull, në një klasë të EQD/EDNJ zhvillohen diskutime. Për t'u dhënë të gjithë nxënësve mundësinë për të shprehur opinionin e tyre, vendosen kufij të kohës së të folurit. Koha e të folurit në debatet parlamentare ose në programet televizive kufizohet për të njëjtën arsye.

Shumë rregulla të qarkullimit në autostradë, kufizojnë lirinë tonë të lëvizjes: kufizimi i shpejtësisë në qytet, ndalesat në semafore etj. Është e qartë që këto rregulla janë vendosur për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e njerëzve.

Demokracia mundëson liri më të madhe për njerëzit dhe për individët se sa sistemet e tjera të qeverisjes. Këtë ajo e bën në kuadrin e një rendi të caktuar, domethënë, në mënyrë të institucionalizuar dhe ajo zbatohet si e tillë. Për të funksionuar si duhet, demokracia duhet të mbështetet në një shtet të fortë të së drejtës dhe të arrijë të sigurojë një shkallë të pranuar të drejtësisë për të gjithë. Një shtet i dobët ose sundimi i paktë i ligjit, do të thotë një qeveri që nuk është në gjendje të kryejë detyrat e saj kushtetuese dhe ligjore.

1.2.4 Anët e forta dhe të dobëta

Në përgjithësi, tipat e ndryshëm të demokracive kanë të përbashkëta disa anë të forta dhe të dobëta:

a. Anët e forta të demokracive

- Demokracia siguron kuadrin dhe mjetet e duhura për zgjidhje të qytetëruara e paqësore të konflikteve; dinamikat e konfliktit dhe pluralizmi janë mbështetje për zgjidhjen e problemeve.
- Demokracitë janë “pacifiste të fuqishme”, si në shoqëritë e tyre, ashtu edhe në politikat ndërkombëtare.
- Demokracia është i vetmi sistem që lehtëson ndërrimin e drejtuesve në pushtet, pa ndryshuar sistemin e qeverisjes.
- Demokracitë janë komunitete që mësojnë. E mira e përbashkët përcaktohet me marrëveshje dhe nuk imponohet nga ndonjë pushtet autokratik.
- Të drejtat e njeriut e forcojnë demokracinë, sepse ato sigurojnë kuadrin ligjor për proceset politike që bazohen në dinjitetin njerëzor. Përmes ratifikimit të traktateve të të drejtave të njeriut, një qeveri mund të rritë premtimet që kanë të bëjnë me ruajtjen e lirive personale dhe me të drejta të tjera.

b. Probleme dhe anë të dobëta

- Partitë dhe politikanët priren të sakrifikojnë objektivat afatgjatë në interes të suksesit në zgjedhje. Demokracitë krijojnë motive për politika dritëshkurtëra, për shembull, në kurriz të mjedisit ose të brezave të ardhshëm (duke “turbulluar ujërat”)
- Qeverisja për një popull është qeverisje brenda kufijve të shtetit. Rritja e ndërvarësisë globale, si në zhvillimet ekonomike dhe mjedisore, e kufizon sferën e ndikimit të vendimtarjeve demokratike në një shtet.

1.2.5 Përfundime

Demokracitë varen nga qytetarët e tyre në shkallën që shpalosen anët e forta të saj, ndërkohë që mbahen në kontroll anët e dobëta. Demokracitë janë sisteme që bazohen në përfshirjen aktive dhe në mbështetjen e qytetarëve të tyre – në besnikërinë e vetëdijshme dhe kritike.

Në demokracitë e konsoliduara dhe në ato të reja, EQD/EDNJ luan rol vendimtar në kulturën politike, të cilën demokracitë duhet ta rrënjosin për të lulëzuar e mbijetuar.

1.3 Qeverisja demokratike e shkollës

1.3.1 Shkolla- një mikro demokraci?

Edukimi për qytetarinë demokratike dhe edukimi për të drejtat e njeriut (EQD/EDNJ) bazohet në parimet themelore të mësimdhënies *përmes*, *rreth* dhe *për* demokraci dhe të drejtat e njeriut në shkollë. Shkolla vlerësohet si një mikro komunitet, një shoqëri në fazën e saj “embrionale⁶”, që karakterizohet nga rregulla dhe procedura zyrtare, nga procese të vendimmarrjes dhe nga një rrjet marrëdhëniesh që ndikojnë në cilësinë e jetës së përditshme.

Në këtë këndvështrim shtrohet pyetja: A mund të vlerësohet shkolla edhe si një shembëlltyrë e zvogëluar e demokracisë? Një shikim i shpejtë dëshmon se shkollat nuk janë shtete të vogla, në të cilat zhvillohen zgjedhje dhe në të cilat mësuesit veprojnë si qeveritë dhe drejtorët si presidentë etj. Megjithatë, çfarë mund të bëjnë shkollat për EQD/EDNJ?

1.3.2 Qeverisja demokratike e shkollës: katër fusha kryesore, tri kritere progresi

Elisabet Bekman (Backman) dhe Bernard Traford (Trafford), drejtues shkollash në Suedi dhe në Angli dhe autorë të manualit të Këshillit të Europës “Qeverisja demokratike e shkollave”,⁷ janë përpjekur t’i japin një përgjigje më të thelluar pyetjes së mësipërme. Ata pohojnë se shkollat kërkojnë menaxhim dhe qeverisje. Menaxhimi i shkollës nënkupton administrimin e saj, për shembull, zbatimin e kërkesave ligjore, financiare dhe kurrikulare. Marrëdhëniet ndërmjet drejtuesve dhe nxënësve janë hierarkike dhe bazohen në mësimdhënie dhe rregull. Nga ana tjetër, qeverisja e shkollës pasqyron dinamikën e ndryshimit shoqëror në shoqërinë e sotme. Shkolla ka nevojë të bashkëveprojë me partnerët dhe aktorët e ndryshëm jashtë saj dhe t’i përgjigjet problemeve dhe sfidave që nuk mund të parashikohen. Për këtë arsye, të gjithë anëtarët e komunitetit të shkollës, veçanërisht fëmijët, duhet të luajnë rolin e tyre për këtë qëllim. Anëtarët e komunitetit bashkëveprojnë, diskutojnë, arrijnë kompromise, ushtrojnë presione, marrin vendime së bashku. Asnjëri prej tyre nuk ka të drejtën e kontrollit mbi tjetrin.⁸

Bekman and Traford sugjerojnë katër fusha kryesore për qeverisjen demokratike të shkollës:

- Qeverisje, lidhshmëri dhe llogaridhënie publike
- Arsimim që ka në qendër vlera
- Bashkëpunim, komunikim dhe përfshirje, konkurrencë dhe vetvendosje e shkollës
- Disiplina e nxënësve

Bekman dhe Traford zbatojnë tre kritere që kanë në themel tri parime kryesore të Këshillit të Europës për EQD/EDNJ, që shërbejnë për të matur progresin në këto fusha:

- Të drejtat dhe përgjegjësitë
- Pjesëmarrja aktive
- Vlerësimi i diversitetit.

1.3.3 Mësimi i demokracisë dhe i të drejtave të njeriut përmes qeverisjes demokratike të shkollës

Bekman dhe Traford ofrojnë një set instrumentesh që shërbejnë për të plotësuar kërkesat e mësimdhënies dhe ushtrimit të demokracisë e të drejtave të njeriut në të gjithë shkollën. Nxënësit përjetojnë pjesëmarrjen demokratike në shkollë, ndërkohë që shkolla ruan karakteristikën e saj kryesore si institucion arsimor: ndonëse është shembëlltyrë e zvogëluar e shoqërisë, shkolla nuk shndërrohet edhe në shembëlltyrë e shtetit.

6. Shih Xhon Djui (2007), *Shkolla dhe shoqëria*, Cosimo, Nju Jork, f.72

7. Backman E. and Trafford B. (2007), *Democratic Governance of Schools*, Council of Europe, Strasbourg.

8. Po aty.. f. 9.

2. Të drejtat e fëmijëve dhe e drejta për arsimim⁹

Të drejtat e fëmijëve mbrohen gjerësisht nga një numër i madh instrumentesh ndërkombëtarë dhe rajonalë, që përfshijnë të drejtat e njeriut, të drejtën humanitare dhe ligjin për refugjatët. Fëmijët përfitojnë nga të drejtat që përfshihen në traktatet e përgjithshme. Përveç kësaj, një numër dokumentesh të veçanta janë hartuar për të siguruar mbrojtje të veçantë për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe për të siguruar zhvillimin e shëndetshëm dhe pjesëmarrjen aktive të rinjve në shoqëri.

Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (“Konventa”) ka shumë nene për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve, për shembull, Protokollin 1, neni 2, “e drejta për arsimim”. Megjithatë, si kuadër i përgjithshëm për të drejtat e fëmijëve shërben “Konventa për të Drejtat e Fëmijës” e Kombeve të Bashkuara, e vitit 1989. Kjo konventë përbën dokumentin e parë të hartuar posaçërisht për të drejtat e fëmijëve dhe shënon një kthesë të rëndësishme në këndvështrimin e qasjes që bazohet në të drejtat, duke i bërë qeveritë ligjërisht përgjegjëse për dështimet në drejtim të përmbushjes së të drejtave të fëmijëve. Konventa për të drejtat e fëmijës krijon një vizion të ri për fëmijët, si bartës të së drejtave dhe të përgjegjësisë, në përputhje me moshën e tyre. Kjo ndryshon nga ideja që i sheh ata si pronë e prindërve ose si përfitues të pambrojtur të lëmshës.

Të drejtat e fëmijëve mbulojnë çdo aspekt të jetës së fëmijëve dhe adoleshentëve, të cilat mund të kategorizohen si më poshtë:

- Të drejtat e mbijetesës: e drejta e jetës dhe e drejta për të plotësuar nevojat bazë (për shembull, e drejta për një standard të kënaqshëm jetese, strehë, ushqim, trajtim mjekësor).
- Të drejtat për zhvillim: të drejtat që aftësojnë fëmijët të zhvillojnë tërësisht potencialin e tyre (këtu përfshihen: arsimimi, loja dhe argëtimi, veprimtaritë kulturore, shfrytëzimi i informacionit dhe liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë).
- Të drejtat e pjesëmarrjes: të drejtat që i mundësojnë fëmijët dhe adoleshentët të luajnë rolin e tyre në komunitet (për shembull, liria e shprehjes së opinionit, e drejta për të patur një zë në çështjet që lidhen me jetën e tyre, liria për t’u organizuar etj.)
- Të drejtat e mbrojtjes: të drejtat që janë thelbësore për ruajtjen e fëmijëve dhe adoleshentëve nga të gjitha format e abuzimit, shpërfilljes dhe shfrytëzimit (për shembull, e drejta fëmijëve refugjatë për kujdes i veçantë dhe mbrojtja kundër përfshirjes së tyre në konfliktet e armatosura, si dhe të drejtat që lidhen me punën e fëmijëve, torturën dhe abuzimin me drogën).

Arsimimi vlerësohet si e drejtë e njeriut në vetvete dhe si mjet i domosdoshëm për realizimin e të drejtave të tjera. Një sistem arsimor që bazohet në të drejta plotëson më mirë misionin e tij për arsimim cilësor për të gjithë.

Neni 26 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut shpall se:

- (1) Çdo individ ka të drejtë për arsimim. Arsimi duhet të jetë i lirë, të paktën, arsimi fillor dhe ai bazë. Arsimi fillor duhet të jetë i detyruar. Arsimi teknik dhe profesional duhet të mundësohet në shkallë të gjerë dhe arsimi i lartë duhet të jetë njëlloj i mundshëm nga të gjithë, në bazë të meritës.
- (2) Arsimi duhet t’i shërbejë zhvillimit të plotë të personalitetit njerëzor dhe rritjes së respektit për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore. Ai duhet të zhvillojë mirëkuptimin, tolerancën dhe miqësinë ndërmjet të gjitha kombeve, racave dhe grupeve fetare dhe të çojë më tej veprimtaritë e Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes.
- (3) Prindërit duhet të kenë përparësinë në të drejtën për të zgjedhur llojin e arsimimit për fëmijët e tyre.

9. Autor: Felisa Tibbitts (2009). Shënime nga Felisa Tibbitts, përgatitur nga Konferenca e Këshillit të Europës për Vlerësimin e Vitit European të Qytetarisë përmes Arsimit, 27-28 prill 2006, Sinaia, Rumani.

Neni 28 i Konventës për të Drejtat e Fëmijës (KDF), si zgjerim i disa prej ideve të shprehura në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (DUDNJ), e përcakton arsimin si një të drejtë, ndërsa neni 29 komenton që arsimi duhet të ndihmojë fëmijën në zhvillimin e plotë të “personalitetit, talenteve dhe aftësive të tij mendore e fizike”.¹⁰

KDF dhe DUDNJ pranojnë që një ndër qëllimet e shkollimit është të zhvillojë respektin për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore. Që të kuptohen dhe të zhvillohen më mirë, të drejtat e njeriut duhet të jetohen në marrëdhënie me të tjerët. Kjo nënkupton jo vetëm të mësuarit rreth të drejtave të njeriut, por edhe të jetuarit në to dhe përmes tyre. Shkollimi i bazuar në qasjen e të drejtave të njeriut përfshin mundësinë për të mësuar dhe për t’i ushtruar të drejtat e njeriut në klasë. Shkollat që interesohen për të drejtat e fëmijëve e përqendrojnë punën e tyre në dinjitetin njerëzor të fëmijëve.

E drejta për arsimim duhet të zbatohet dhe të gëzohet nga të gjithë – pavarësisht nga aftësitë, racat, feja, gjinia, kombësia, parapëlqimet seksuale, klasa ose nga faktorë të tjerë dallues. Përveç kësaj, një arsim i tillë, si përcaktohet nga KDF, duhet të strukturohet në mënyrë që të respektojë të drejtat themelore të nxënësve.

Një parim i rëndësishëm e qëndror për të drejtat e njeriut dhe i qasjes me bazë të drejtat e njeriut është ai i mosdiskriminimit. Në fushën e shkollimit, pasojat janë të shumëfishta dhe përfshijnë të drejtën e barabartë për arsimim dhe vëmendje të veçantë për grupet e pafavorizuara ose të marginalizuara.

Nisma e UNESCO-s për një shkollë miqësore dhe qasja me bazë të drejtat e njeriut bazohet në zbatimin e KDF, në dhe përmes arsimit. Aftësia për të zbatuar këtë qasje kërkon njohjen më të mirë të të drejtave të njeriut dhe të fëmijës, si dhe rëndësinë e saj për mendimin, planifikimin dhe vlerësimin në arsim. Ajo na detyron të shtrojmë pyetje të tilla, si:

- Kush nuk po arsimohet. Ku ndodhen ata dhe cilat janë arsyet e përjashtimit?
- Kush është përgjegjës për të mbrojtur, për të zhvilluar dhe për të përmbushur të drejtën për arsimim?
- Çfarë është e nevojshme të zhvillohet për të siguruar të drejtën për arsimim?
- Kush duhet të veprojë dhe çfarë duhet të bëjë për të siguruar këtë të drejtë dhe si mund të ndihmojnë partneritetet në këtë proces?

Parimi 1. Shpreh lidhjet me të drejtat

Pyetjet për ne: A lidhen përpjekjet tona arsimore, në mënyrë të veçantë, me të drejtat e njeriut? A përfshijnë këto përpjekje të gjitha të drejtat e njeriut? A lidhen realisht të drejtat e njeriut me nevojat dhe çështjet e komuniteteve tona? A mund të realizohet kjo lidhje? A jemi ne të gatshëm të shkojmë përtej “zonës së rehatisë vetjake” dhe të lidhim punën tonë me vlerat e të drejtave të njeriut?

Parimi 2. Përgjësia

A ndodh që ne, si përfaqësues të qeverisë ose të punësuar nga shteti, të shohim veten si përgjegjës për të siguruar edukimin për të drejtat e njeriut? Në ç’drejtim jemi përgjegjës? Në ç’mënyrë fëmijët dhe kujdestarët e tyre mund të përmbushin një përgjegjësi të tillë?

Parimi 3. Fuqizimi dhe pjesëmarrja

Le të mendojnë për ata individë për të cilët ndihemi përgjegjës në drejtim të sigurimit të arsimit për të drejtat e njeriut. A i kemi marrë ne parasysh idetë e atyre që ndikohen nga politikat dhe veprimtaritë tona? Kush mungon në takimet vendimmarrëse dhe kujt i dëgjohet zëri në bisedat tona? Nëse ata nuk janë të pranishëm ose nuk përfshihen në biseda në shtëpitë e tyre, si mund ta realizojmë këtë në tryezat publike? Si mund të lehtësojmë shprehjen e pikëpamjeve të tyre për “kur”, “si”, “kush” dhe “çfarë” edukimi për demokraci dhe të drejtat e njeriut ata kanë nevojë?

10. E drejta për arsim shprehet në një numër të madh dokumentesh të Kombeve të Bashkuara dhe të të drejtave të njeriut, duke përfshirë këtu Paktin Ndërkombëtar të të Drejtave Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (neni 14) dhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës (neni 28 dhe 29). Deklarata të rëndësishme, komente të përgjithshme dhe dokumente të tjera kanë pasuruar më tej këto konventa në lidhje me të drejtën për arsimim, si Deklarata Botërore për Arsimin për të Gjithë (neni I, III, IV, VI, VII), Kuadri për veprim i Dakar dhe Arsimi për të gjithë.

Parimi 4. Mos diskriminimi dhe vëmendja ndaj grupeve të pafavorizuara

Në lidhje me çështjen e fundit: cilat janë grupet që, aktualisht, kanë më pak të ngjarë të përfitojnë nga programet tona arsimore dhe si mund të sigurojmë pjesëmarrjen e tyre në to? Grupet të cilëve u mohohen rregullisht të drejtat e njeriut-grupet e marginalizuara, të pafavorizuara, të diskriminuara-janë ata që duhet të përfitojnë më shumë nga përpjekjet tona në fushën e arsimit. Si mund t'i identifikojmë e të mbërrijmë tek ta e më pas të krijojmë programe arsimore që të jenë realisht të rëndësishme e të vlefshme për ta?

Njësia 2

Çelësi drejt një koncepti dinamik të qytetarisë¹¹

1. Sfidat ndaj modelit tradicional të qytetarisë

Që nga koha e Luftës së Ftohtë, disa procese modernizimi, të cilat kanë modeluar për një kohë të gjatë historinë tonë (shih tabelën poshtë) janë përshpejtuar dhe intensifikuar më tej, duke kaluar në një cilësi të re. Ngjarjet e përjetuara dhe ndryshimet që po ndodhin në Europë kanë sfiduar modelin tradicional të qytetarisë:

- Globalizimi i tregtisë së lirë dhe ekonomitë konkurruese të tregut kanë sjellë në nivel më të lartë mirëqënie për shumë njerëz në shumë vende, por jo në të gjitha. Hendeku i shpërndarjes ndërmjet të pasurve dhe të varfërve është rritur, si brenda ashtu edhe ndërmjet shoqërive, duke kërcënuar kohezionin shoqëror dhe solidaritetin ndërmjet njerëzve.
- Konkurrenca i çon ndërmarrjet në rritje të vazhdueshme të prodhimit për të ulur shpenzimet. Kjo ka rritur procesin e pandërprerë të modernizimit, që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë të produkti, teknologjia dhe te vendet e punës dhe, në mënyrë të tërthortë, në gjithë mënyrën e jetesës. Xhozef Shumpeter (Joseph Schumpeter) e quante këtë proces të vazhdueshëm modernizimi “shkatërrim krijues”.¹² Transformimi i të gjitha ekonomive në Europën lindore mund të vlerësohet si një shembull i goditur i një shkatërrimi të tillë.
- Rritja ekonomike ka prodhuar mirëqënie në rritje, por edhe ka rritur konsumin e burimeve natyrore. Rritja e CO₂ e bën gjithnjë e më të vështirë dhe më të kushtueshëm parandalimin ose përshtatjen ndaj ndryshimit klimatik.
- Teknologjitë e reja të informacionit dhe komunikimit ofrojnë rrugë të reja për të rritur rendimentin, për të shkëmbyer, për të marrë informacion dhe për të ofruar zbatimje etj. Ne jetojmë në një kulturë dhe letërsi mediatike dhe përdorimi i medias së re për të dërguar dhe për të marrë mesazhe vlerësohet si aftësi bazë, njëlloj si leximi dhe shkrimi.
- Popullsia, në shumë vende të botës, po plakët si rrjedhojë e rritjes ekonomike dhe e arritjeve të mjekësisë moderne, ndërkohë që numri i saj në të gjithë botën po rritet. Të dyja problemet kanë sjellë probleme serioze për shekullin e 21.
- Kombet kanë të drejtën e sovranitetit dhe të vetëvendosjes. Por koncepti i kombeve është, njëherazi, përfshirës dhe përjashtues. Që nga fundi i Luftës së Ftohtë janë shfaqur forma të reja të identiteteve kolektive, të shtypura në të kaluarën.
- Shoqëritë moderne janë tipike shekullore dhe pluraliste. Migrimi në Europë, veçanërisht në Bashkimin Europian ka ndihmuar në këtë drejtim. Shoqëritë pluraliste janë më dinamike dhe më prodhimtare, por edhe me kërkesa më të mëdha për kohezion shoqëror, për të integruar njerëzit me besime, vlera, interesa, prejardhje shoqërore dhe etnike të ndryshme.
 - Demokracia ofron mundësitë më të mira për të përballuar këto sfida, pasi çdo përpjekje për t'i zgjidhur këto dhe të tjera probleme me anë të autoritetit nuk do të jetë në gjëndje të marrë parasysh të gjithë realitetin kompleks të shoqërisë, të ekonomisë, të mjedisit, të zgjidhjes së konfliktit në nivel kombëtar, e veçanërisht në atë global. Nga ana tjetër, demokracia qëndron dhe bie në varësi të sigurimit të pjesëmarrjes së barabartë. Sa më komplekse të jetë bota jonë dhe sfidat që përcaktojnë të ardhmen tonë, aq më e vështirë është për “qytetarin e zakonshëm” të kuptojë dhe të marrë pjesë në vendimmarrje. Mungesa e besimit në institucionet politike tradicionale, format e qeverisjes dhe udhëheqësit politike janë rrënjësor në ndjesinë e përjashtimit dhe të shpërfilljes. Demokracia dhe të drejtat e njeriut janë projekte të përkohshme dhe mbijetesa e tyre varet nga shkalla e kalimit të trashëgimisë së tyre në brezin e ri.

11. Bazuar në Huddleston T. (2004), *Instrument për trajnimin e mësuesit për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut, Këshilli i Europës*, Strasbourg, pp. 9f., rishikuar nga Peter Krapf.

12. Shumpeter J. (1942, 2008) Kapitalizmi, Socializmi dhe Demokracia; Harper and Brothers, Nju Jork fq.83.

Këtu, ne vetëm mund të skicojmë shkurtimisht këto linja zhvillimi. Ato janë produkte të njeriut dhe jo procese natyrore, të lidhur me njëri-tjetrin, me ndikim të ndërsjellë dhe përforcues të njëri-tjetri. Duke qenë të tillë, “produkte”, tek ata mund të ndikosh dhe t'i ndryshosh në drejtimin dhe në rezultatet e zhvillimit, por jo në kompleksitetin e tyre.

Modernizimi

Modernizimi është një kategori sociologjike që ka të bëjë me proceset shumëanshme të ndryshimit shoqëror. Në dy dhjetëvjetëshit e fundit ai është rritur në shpejtësi, gjerësi dhe kompleksitet, megjithatë, në këndvështrimin historik, burimet e tij përfshijnë Reformimin, shpikjen e shtypit, kohën e Rilindjes, revolucionet angleze, amerikane dhe franceze, revolucionin industrial. Modernizimi, në kuptimin e vërtetë të fjalës, ka ndryshuar çdo aspekt të jetës njerëzore, duke përfshirë edhe mënyrën si ne punojnë dhe çfarë bëjmë, ku jetojmë dhe sa shpesh udhëtojmë, nivelin tonë dhe shpërndarjen e pasurisë, zhvillimin e të drejtave të njeriut, globalizimin, teknologjinë, vlerat dhe bindjet të cilave u përkushtohemi ose nga të cilat heqim dorë, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes tonë në shoqëri dhe politikë.

Modernizimi është në të njëjtën kohë edhe një proces i dyanshëm, të cilin ne nuk mund ta shmangim. Ai është fati ynë, në të mirë e në të keq. Shkencëtarët dhe filozofët kanë pikëpamje, deri të kundërta, nëse modernizimi, në tërësi, duhet të vlerësohet si një bekim apo si një peshë. Ne e gjykojmë modernizimin si një sfidë, që bart në vetvete, njëherazi, rreziqe dhe mundësi. Sfidat duhen përballuar për të mbajtur në kontroll rreziqet.

Për shumë njerëz, në shumë shoqëri, modernizimi krijon mundësi dhe shanse për të gëzuar një nivel më të lartë mirëqënieje dhe lirie. Në anën tjetër, qytetarët dhe udhëheqësit e tyre duhet të përballen me kërkesa më të larta për të qenë gjithnjë vigjilentë ndaj rreziqeve në rritje që shoqërojnë proceset e modernizimit.

Arsimi luan rol qendror në pajisjen e njerëzve me kompetencat e nevojshme për të arritur baraspeshën e duhur ndërmjet sukseseve dhe kërkesave në rritje

Sfida të tilla kërkojnë edhe forma të reja qytetarie: qytetarët nuk duhet vetëm të informohen dhe të kuptojnë përgjegjësitë e tyre si qytetarë, por edhe të jenë aktivë, të aftë dhe me vullnetin e duhur për të kontribuar në jetën e komunitetit të tyre, të vendit dhe të botës së gjerë, në mënyra që shprehin individualitetin e tyre dhe ndihmojnë për të zgjidhur problemet. Sfidat në rritje kërkojnë shoqëri të forta, me udhëheqës dhe qytetarë kompetentë, pra me arsimin e duhur.

Arsimtarët janë optimistë. Ata besojnë se, përmes arsimit të duhur, si të rinjtë ashtu edhe të rriturit mund të pajisen me dijet dhe mjetet për të ndikuar në zhvillimin e komunitetit të tyre dhe të planetit. Qytetaria aktive, edukohet më mirë me anë të të mësuarit me në qendër nxënësin.

1.1 Një lloj i ri qytetarie kërkon edhe një lloj të ri arsimit

Modelet e të mësuarit të orientuar nga të mësuarit përmendësh janë të pamjaftueshme për të krijuar qytetarin e përgjegjshëm, aktiv dhe të mirinformuar që kërkon demokracia moderne.

Ajo që kërkohet janë format e arsimit që përgatitin nxënësit për përfshirjen aktuale në shoqëri, format e arsimit që janë sa praktike aq edhe teorike, të rrënjësura në çështjet e jetës reale, të cilat kanë ndikimin e tyre si të nxënësit ashtu edhe të komunitetit, dhe të mësuarit përmes pjesëmarrjes në jetën e shkollës e përmes kurrikulës zyrtare.

Roli i qytetarit aktiv përputhet me atë të nxënësit aktiv. Koncepti i të mësuarit konstruktivist siguron mbështetje për nxënësit që përballen me probleme të reja për ta. Në shkollë, mësuesi mund të ketë gjetur një zgjidhje optimale, por më vonë, gjatë përballjes me sfidat e përmendura më sipër, brezi i ardhshëm do të veprojë si pionier.

Nevoja për të siguruar një mësimdhënie me në qendër nxënësit shoqërohet me sfida të mëdha për profesionin e mësuesit. Kjo do të thotë që duhet të mësohen forma të reja njohurish, të zhvillohen metoda të reja të mësimdhënie, të gjenden mënyra ta reja të punës dhe krijohen forma të reja të marrëdhënieve profesionale, si me kolegët ashtu edhe me nxënësit. Kjo do të thotë që mësimdhënia të zhvendosë përparësinë, nga të kuptuarit e sistemeve historike, në të kuptuarit e çështjeve aktuale; krahas transmetimit të njohurive, të vërë theksin tek të menduarit kritik dhe te të mësuarit e aftësive, tek bashkëpunimi dhe bashkëveprimi më shumë se te përgatitja e izoluar, tek autonomia profesionale, në vend të varësisë nga diktati qendror. Ajo kërkon të ndryshojmë mënyrën si ne perceptojmë të mësuarit, të zhvendosim përparësinë nga të mësuarit me në qendër mësuesin, tek të mësuarit përmes përvojës, pjesëmarrjes, kërkimit dhe shkëmbimit të ideve.

Didaktika e orientuar nga mësuesi, e sunduar nga teksti dhe e orientuar vetëm drejt njohurive duhet të zëvendësohet nga ajo që vë theksin tek përfshirja e nxënësit, tek larmia e teknikave të mësimdhënies dhe tek qasja e bazuar në aftësitë. Ky është kontributi që shpreson të sjellë kjo seri botimesh për EQD/EDNJ.

2. Kultura politike

2.1 Demokracia merr jetë përmes qytetarëve të saj

Shembull:

Zgjedhjet parlamentare kanë fitues dhe humbës. Shumica formon qeverinë e re, kurse pakica formon opozitën. Qeveria mëparshme mund të humbasë funksionet, kurse qeveria e re, me një pamje të ndryshme politike, e zëvendëson atë.

Rregullat janë të qarta, por kjo nuk është e mjaftueshme. Sistemi zgjedhor mund të funksionojë vetëm nëse mbështetet tek humbësit, te pakica, e cila pranon rezultatet. Nëse kjo nuk ndodh, atëherë zgjedhjet mund të shkaktojnë konflikte të dhunshme, që përçajjnë shoqërinë në vend që të fuqizojnë kohezionin shoqëror ndërmjet anëtarëve të saj.

Një fushatë zgjedhore u jep partive mundësinë për t'ua komunikuar idetë e tyre qytetarëve. Çfarë ndodh nëse partitë që marrin pjesë nxisin programe raciste, fundamentaliste ose antidemokratike?

Që zgjedhjet të kryejnë rolin e tyre, si një ndër rrugët më të rëndësishme për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje demokratike, nuk mjafton vetëm kuadri ligjor që rregullon sistemin e zgjedhjeve. Për këtë është i nevojshëm besimi në procesin politik dhe sigurimi i rrugëve që garantojnë kryerjen e duhur të tyre.

Shembujt tregojnë se demokracia varet njëlloj, si nga rregullat ashtu edhe nga qëndrimet e qytetarëve ndaj saj. Qytetarët duhet të kuptojnë e të vlerësojnë sistemin dhe të ndihen përgjegjës për qëndrueshmërinë e tij. Partitë duhet të trajtojnë njëra-tjetrën si konkurrenca dhe jo si armike. Vetëm në këtë mënyrë, demokracia do të dëshmojë fuqinë e saj si sistemi i vetëm në të cilin ndryshimet e qeverive janë të mundshme pa qenë e nevojshme të ndryshohet sistemi politik.

Demokracia ngrihet mbi një sistem institucionesh dhe procesesh që përfshijnë zgjedhje të përgjithshme, përfaqësim parlamentar dhe kontroll mbi pushtetet përmes sistemit të llogaridhënies. Disa institucione përfshijnë pjesëmarrjen e drejtpërdrejt përmes referendumit ose një gjykate kushtetuese. Kjo është skena dhe qytetarët janë aktorët e saj. Kjo do të thotë që qytetarët duhet të kenë vullnetin dhe aftësinë të luajnë rolin e tyre, duke u identifikuar me sistemin politik të demokracisë.

Demokracia është një sistem institucionesh që i ka rrënjët në kulturën politike. Sistemi institucional mund të përcaktojë kuadrin e një kulture të tillë, por ai nuk mund ta krijojë ose të sigurojë qëndrueshmërinë e saj. Këto parime zbatohen edhe në qeveritë autokratike, sepse edhe një autokrat varet nga një kulturë e përshtatshme politike, që bazohet më shumë në subjekte politikisht pasive se në sisteme aktive dhe të përkushtuara.

2.2 Dimensioni kulturor i të drejtave të njeriut

Të drejtat e njeriut të natyrës civile dhe politike shpallin natyrën e proceseve demokratike në praktikë, duke përfshirë këtu lirinë e mendimit dhe të shprehjes, lirinë e medias (domethënë, ndalimin e censurës), të drejtën e votës dhe parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit që zbatohet në interes të çdo qenieje njerëzore. Kur vendet ratifikojnë një traktat të të drejtave të njeriut, ata premtojnë, me vullnetin e tyre të lirë, të harmonizojnë legjislacionin dhe praktikën e tyre të brendshme me standardet ndërkombëtare. Çfarë ndodh nëse një shtet dështon në përpjekjet tij për t'i mbajtur premtimet për të drejtat e njeriut? Për këtë ekzistojnë mekanizmat e ndryshëm për mbrojtjen e të drejtave të vendosura nga Kombet e Bashkuara ose nga institucionet rajonale, që hartojnë ligjet rajonale të të drejtave të njeriut që mund të firmosen nga qeveritë. Për shembull, në Europë ekziston Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila përqëndrohet në të drejtat civile e politike. Qeveritë mund të nënshkruajnë edhe Kartën Sociale Europiane, e cila përfshin të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore. Nëse një qeveri e ka ratifikuar Konventën, por nuk e zbaton atë, atëherë qytetarët e shteteve anëtarë të Këshillit të Europës (në të vërtetë çdo person brenda juridiksionit të një shteti) mund të paraqesin një ankesë në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut, në Strasbourg.

Në pjesën më të madhe të rasteve, gëzimi i të drejtave të njeriut realizohet në kuadrin e qeverive të organizuara si demokraci kushtetuese, përmes mekanizmave të zakonshëm të proceseve demokratike. Këta mekanizma përfshijnë zhvillimin e ligjeve, të kulturës së pjesëmarrjes dhe të përkushtimit qytetar.

Demokracia dhe të drejtat e njeriut varen nga kuadri institucional i përbërë nga dy pjesë: nga një numër rregullash dhe parimesh të vendosura në sistemin ligjor dhe kushtetues dhe nga kultura politike. Demokracia dhe të drejtat e njeriut mishërohen në një numër parimesh, vlerash dhe përgjegjësish. Demokracia dhe të drejtat e njeriut lejojnë qëndrimet e kundërta për çështje të caktuara, por ato mund ta bëjnë këtë gjë vetëm në kuadrin e një mirëkuptimi dhe pranimit të fortë që lejon, mbron, por edhe kufizon liritë. Ju mund të mos jeni dakord në të gjitha pikat, por një qëndrim i tillë funksionon vetëm nëse të gjithë identifikohen me sistemin që lejon mosmarrëveshjet dhe kundërshtimet.

2.3 Mësimdhënia përmes demokracisë dhe të drejtave të njeriut-kultura demokratike në shkollë

Nuk ka demokraci pa demokratë të përkushtuar.

Çdo brez trashëgon demokracinë e tij dhe ndoshta arrin ta kuptojë, ta vlerësojë dhe të mësojë ta vërë atë në shërbim të tij në mënyrë aktive. Detyra e EQD/EDNJ dhe e arsimit në përgjithësi është të mbështesë e të nxitë të rinjtë të bëhen demokratë aktivë dhe të përkushtuar.

Përvoja historike e shumë vendeve dëshmon se traditat kulturore që mbështesin demokracinë zhvillohen ngadalë. Projektet për ndërtimin e kombeve në shoqëritë e pas luftës, në kushtet e mungesës së traditave të kulturës demokratike, përballen me pengesa shumë të mëdha. Mund të importohet një model institucionesh demokratike, por nuk mund të importohen rrënjët kulturore të demokracisë. Ato duhet të burojnë nga trashëgimia kulturore e shoqërisë.

Kultura politike mund të kuptohet në kuadrin e kategorive konstruktiviste. Ajo fitohet përmes proceseve të të mësuarit dhe të shoqërizimit. Për këtë arsye, nga fakti nëse shkolla qeveriset në mënyrë demokratike apo autokratike, varet edhe ajo që pritet prej tyre: të mësojnë si të jetojnë në ose nën atë formë qeverisjeje në të cilën ata kanë jetuar deri tani.

Shkolla, si mikro shoqëri, mund të mbështesë nxënësit e saj të përvetësojnë dhe të vlerësojnë elemente të një kulture demokratike dhe të të drejtave të njeriut, domethënë, që ata të aftësohen:

- Të njohin dhe të shprehin interesat dhe pikëpamjet e tyre me vetbesim.
- Të trajtojnë njeri-tjetrin me respekt të ndërsjellë, duke përfshirë këtu të dëgjuarit dhe empatinë, domethënë, vullnetin dhe aftësinë për të vënë veten në vend të tjetrit.
- Të zgjidhin konfliktin në rrugë dhe me mjete paqësore, domethënë të bëjnë marrëveshje dhe kompromise.
- Të vlerësojnë funksionet e strukturave funksionale që mbrojnë dhe kufizojnë liritë individuale. Në këtë mënyrë ata shtojnë shpirtin e tyre, si element i kulturës politike, në strukturat ekzistuese zyrtare të rregullave e ligjeve.
- Të vlerësojnë politikën si përpjekje praktike që synon të zgjidhë problemet që kërkojnë vëmendjen e duhur dhe marrjen e një vendimi.
- Të marrin pjesë në procesin e zgjedhjes së përfaqësuesve dhe në proceset e vendimmarrjes.
- Të përpiqen të ndikojnë në vendimmarrjet, përmes rrugëve të tilla, si: rritja e vetëdijes, pjesëmarrja aktive, grupet e interesit dhe menaxhimi i problemeve nga vetë nxënësit.
- Të marrin përsipër përgjegjësinë për vendimet dhe zgjedhjet e tyre, duke vlerësuar edhe ndikimin që ato kanë për vete dhe për të tjerët.
- Të kuptojnë që, nëse nuk marrin pjesë në vendimet që kanë pasoja për jetën e tyre, të tjerët do ta bëjnë një gjë të tillë për ta e, në këtë rast, pasojat mund të jenë jo në interesin e tyre.

Kultura politike lidhet ngushtë me qëndrimet dhe vlerat që qytetarët e rinj i formojnë përmes procesit të shoqërizimit, duke përfshirë këtu edhe përvojën shkollore. Të tjerë faktorë që ndikojnë në këtë proces janë: familja, bashkëmoshatarët dhe media. Nga ana tjetër, komuniteti i shkollës i ofron fëmijëve dhe adoleshentëve shanset e para për të ushtruar ndërveprimin në shoqëri dhe në mjedise publike; që këtej buron edhe roli i rëndësishëm i shkollës për mënyrën si trashëgimia demokratike kalon te brezi i ri. Përmes të mësuarit dhe përvojës në mjediset shkollore, të rinjtë mund të zhvillojnë qëndrime dhe aftësi për t'iu përkushtuar, gjatë gjithë jetës, proceseve demokratike dhe vlerave të të drejtave të njeriut, si përmes proceseve zyrtare të vendimmarrjes, ashtu edhe në bashkëveprimet e jetës së përditshme.

Njësia 3

Edukimi për demokraci dhe për të drejtat e njeriut

1. Tri përmasat e EQD/EDNJ

Edukimi për qytetari demokratike dhe edukimi për të drejtat e njeriut (EQD/EDNJ) përqendrohet më shumë në atë që nxënësi duhet të jetë në gjendje të bëjë, se sa në atë që mësuesi duhet t'u mësojë atyre. Tri parimet bazë që qëndrojnë në themel të kësaj qasjeje që vë në qendër nxënësit dhe atë që ai duhet të bëjë, mund të ilustrohen me shembullin e mëposhtëm:

- Liria e mendimit dhe e shprehjes është kusht themelor i pjesëmarrjes demokratike dhe një ndër të drejtat themelore civile dhe politike. Në EQD/EDNJ, nxënësit njohin, kuptojnë dhe vlerësojnë të drejtën e mendimit dhe të shprehjes së lirë dhe mënyrën si ajo mbrohet nga kushtetuta. Ky përbën dimensionin **njohës të të mësuarit (njohuritë, konceptet dhe të kuptuarit)**.
- Nxënësit mësojnë të përdorin të drejtat njerëzore themelore. Përdorimi aktiv i kësaj të drejte është i rëndësishëm për pjesëmarrjen në një komunitet demokratik. Për këtë arsye, nxënësit nxiten të reflektojnë për pikëpamjet e tyre dhe të jenë të aftë t'i shprehin ato në mënyra të ndryshme, duke përfshirë këtu edhe aftësinë për t'i argumentuar ato publikisht (**përmasa e të mësuarit që lidhet me aftësitë**).
- Për të ushtruar lirinë e shprehjes, nxënësit duhet të nxiten të shprehin pikëpamjet e tyre edhe në situata në të cilat ata përballen me një shumicë kundërshtuese. Ata dëgjojnë mendimet e të tjerëve në frymën e tolerancës dhe të respektit.
- Duke i kufizuar mosmarrëveshjet dhe ndryshimet e ideve në çështjen konkrete dhe duke mos i personalizuar ndryshimet e tyre, krijohet mundësia që konfliktet të zgjidhen në mënyrë paqësore (**përmasa e të kuptuarit që lidhet me qëndrimet dhe vlerat**).

Ky shembull, që ia vlen të përgjithësohet, tregon jo vetëm çfarë nxënësit duhet të jenë në gjendje të bëjnë për të ushtruar të drejtat e njeriut, por edhe për të mësuarit dhe edukimin në përgjithësi. Procesi i të mësuarit duhet të shpaloset në të tria këto përmasa, të cilat, në mënyrë të ndërsjellë, mbështesin njëra-tjetrën: njohuritë, konceptet dhe të kuptuarit; aftësitë; qëndrimet dhe vlerat. Në këtë mënyrë, procesi i të mësuarit do të lidhet dhe do t'i shërbejë formimit të kompetencave të nxënësit.

Nëse kjo është mënyra si nxënësit mësojnë, atëherë çfarë duhet të bëjnë mësuesit e EQD/EDNJ për të garantuar shanset e duhura për të mësuar? Më poshtë për përmbledhim përgjigjen e kësaj pyetjeje:

Synimi i EQD/EDNJ është të mbështesë nxënësit për të qenë qytetarë që:

- njohin të drejtat e tyre dhe kuptojnë kushtet nga të cilat ato varen (të mësuarit "rreth" demokracisë dhe të drejtave të njeriut);
- e përjetojnë shkollën si një mikro shoqëri, në të cilën respektohen liritë dhe barazia e nxënësve të saj, janë trajnuar në ushtrimin e të drejtave të tyre dhe në respektimin e të drejtave të të tjerëve (të mësuarit "përmasë" demokracisë dhe të drejtave të njeriut).
- për arsyet e mësipërme, janë të aftë dhe besimplotë në ushtrimin e të drejtave të tyre njerëzore, duke ndërë përgjegjësinë ndaj të tjerëve dhe komunitetit (të mësuarit "për" demokraci dhe të drejtat e njeriut).

1.1 Përmasa njohëse e EQD/EDNJ: të mësuarit "rreth" demokracisë dhe të drejtave të njeriut

EQD/EDNJ kërkon nga nxënësit të njohin dokumente të tillë si Deklarata Universale të të Drejtave të Njeriut (DUDNJ) dhe Konventën Europiane. Me një fjalë, ata duhet të dinë që çdo person gëzon të drejtën për të menduar dhe për t'u shprehur lirisht, të drejtën për një informacion të pacensuar nga media, me përjashtimet dhe kufizimet e justifikuar ligjrisht (neni 10 i Konventës Europiane). Kushtetutat e shteteve dhe kuadri ligjor duhet t'i pasqyrojnë dhe t'i mbrojnë standardet e të drejtave

të njeriut, të cilat duhet të studiohen nga nxënësit në këtë këndvështrim. Në këtë mënyrë, ata do të kuptojnë rëndësinë dhe domosdoshmërinë e kësaj të drejte për t'i dhënë jetë demokracisë.

Nxënësit duhet të kuptojmë edhe nenin 14 të Konventës, i cili trajton parimin themelor të barazisë dhe të mosdiskriminimit: gratë dhe burrat, të pasurit dhe të varfërit, të rinjtë dhe të moshuarit, anëtarët e një kombi dhe emigrantët- të gjithë duhet t'i zotërojnë këto të drejta në mënyrë të barabartë. Gëzimi i këtyre të drejtave nënkupton një proces zhvillimi dhe një ndër programet e sistemeve demokratike të qeverisjes së bazuar në të drejtat e njeriut.

Së fundi, nxënësit duhet të kuptojnë përse liritë kërkojnë një kuadër ligjor dhe bartësin e përgjegjësive (DUDNJ, Neni 29). Liria e shprehjes u mundëson qytetarëve të nxisin interesat e tyre në një shoqëri pluraliste dhe në një mjedis konkurrues, me fitues dhe humbës. Kushtetuta, rregullat dhe ligjet duhet të sigurojnë kuadrin e duhur që kufizon liritë e të më të fortëve dhe mbron të dobët, pa përlegjur ndryshimet ndërmjet tyre. Megjithatë, ligjet nuk mund të zgjidhin çdo problem dhe, për këtë arsye, anëtarët e një komuniteti duhet të ndajnë përgjegjësinë e tyre të përbashkët ndaj njeri-tjetrit.

Të drejtat e njeriut nënkuptojnë edhe një përmasë **detyruese**. Ato kërkojnë që nxënësit të njohin shkallën në të cilën parimet e të drejtave të njeriut realizohen në komunitetin e shkollës dhe më gjerë, në shoqëri.

KONVENTA EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT (4.11.1950)

NENI 10

Liria e shprehjes

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t'u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë.

2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

NENI 14

Ndalimi i diskriminimit

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

DEKLARATA UNIVERSALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT (10.12.1948)

Neni 29.

1. Secili ka detyrime ndaj bashkësisë ku vetëm aty i mundësohet zhvillimi i lirë dhe i plotë i personalitetit të tij.

2. Në ushtrimin e të drejtave dhe lirive të veta, secili do t'u nënshtrohet vetëm atyre kufizimeve të cilat janë përcaktuar me ligj, vetëm me qëllim të sigurimit të njohjes dhe të respektimit të domosdoshëm të të drejtave dhe lirive të të tjerëve dhe të plotësimit të kërkesave të drejta të moralit, të rendit publik dhe të mirëqenies së përgjithshme në një shoqëri demokratike.

Këto tri nene skicojnë edhe konfliktin që ekziston ndërmjet lirive individuale dhe nevojës për të siguruar barazinë e trajtimit të tyre përmes një kuadri ligjor që, njëherazi, i kufizon dhe i mbron këto të drejta. Nxënësit që mund të shpjegojnë këtë kanë mësuar shumë "rreth" demokracisë dhe të drejtave të njeriut; kjo është përmasa njohëse e EQD/EDNJ.

1.2 Përmasa pjesëmarrëse e EQD/EDNJ: të mësuarit "për" demokraci dhe të drejtat e njeriut

Për të marrë pjesë në demokraci, nxënësit duhet të mësojnë si të ushtrojnë të drejtat dhe liritë e tyre, për shembull, të drejtën për informacion, për mendim të lirë dhe për ta shprehur atë lirisht. Atyre duhet t'u mundësohet bashkëveprimi aktiv me të tjerët, si zhvillimi i interesave të tyre, marrëveshjet për kompromise ose për të përcaktuar çfarë kuptojnë me "mirëqënien e përgjithshme" (DUDNJ, neni 29). Nxënësit duhet të jenë të aftë të veprojnë në përputhje me ligjet dhe të pranojnë kufizimet që mund t'u diktohen prej tyre. Ata duhet të zhvillojnë ndjenjën e përgjegjësisë për mirëqënien e të tjerëve dhe të komunitetit në tërësi.

Me pak fjalë, ata jo vetëm duhet të kuptojnë lidhjen ndërmjet tre neneve të të drejtave të njeriut të trajtuar më sipër, por edhe të vlerësojnë vlerat që qëndrojnë në themel të tyre e të veprojnë në përputhje me to. Në këtë mënyrë, përmes proceseve demokratike të vendimmarrjes, që nuk shkelin të drejtat e njeriut, ata duhet të aftësohen të harmonizojnë interesat e tyre me ato të të tjeëve dhe komunitetit.

Nxënësit e trajnuar në këtë mënyrë, do të dinë edhe si të marrin pjesë në demokraci. Kjo është përmasa e EQD/EDNJ që lidhet me veprimin – të mësuarit "për" demokraci dhe të drejtat e njeriut, d.m.th. për mbrojtjen dhe zhvillimin e demokracisë, të shtetit të së drejtës dhe të të drejtave të njeriut.

1.3 Përmasa kulturore e EQD/EDNJ: të mësuarit "përmes" demokracisë dhe të drejtave të njeriut

Njohuritë dhe aftësitë mund të lehtësojnë pjesëmarrjen në demokraci, por ato jo domosdoshmërisht e kthejnë një person në demokrat. Për shembull, kjo përvojë, në duart e racistëve, mund të përdoret si armë për të sulmuar një komunitet demokratik të bazuar në të drejtat e njeriut. Në kuptimin e vërtetë të fjalës, njohuritë dhe aftësitë, të pa shoqëruara dhe të pa mbështetura nga vlerat e të drejtave të njeriut nuk kanë vlerë për demokracinë. Për këtë arsye, EQD/EDNJ përfshin një përmasë kulturore. Kultura e të mësuarit (mësimdhënia dhe të mësuarit) duhet të pasqyrojë mesazhet e EQD/EDNJ.

Kur nxënësit fitojnë njohuri përmes procesit të mësimdhënies (dëgjimi i një leksioni, leximi) dhe kompetenca përmes trajnimit (demostrim, praktikë dhe drejtim nga trajneri), ata zhvillojnë vlerat dhe qëndrimet përmes përvojës. Për shembull, të rinjtë ndërtojnë sistemin e tyre të vetvlerësimit, të nxitur nga prindërit dhe mësuesit. Por, vetëm nxënësit që janë trajtuar me respekt nga mësuesit mund të sillen po me respekt me shokët e tyre. Vlerat e të drejtave të njeriut fitohen përmes një procesi shoqërizimi në shkollë – mësimdhënia "përmes", ose nën frymën e demokracisë dhe të drejtave të njeriut.

Vlerat e të drejtave të njeriut janë përcaktuar nga Kombet e Bashkuara, Këshilli i Europës dhe organizata të tjera dhe përfshijnë parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit; pjesëmarrjen, përfshirjen dhe llogaridhënien.

Ndërsa të mësuarit "rreth" demokracisë dhe të drejtave të njeriut mund të realizohet përmes lëndëve të veçanta (shkencat shoqërore, qytetaria, historia), dimensionin kulturor i EQD/EDNJ, të mësuarit "përmes" demokracisë dhe të drejtave të njeriut është një sfidë për të gjithë shkollën – të drejtat e njeriut dhe demokracia bëhen pedagogjia e komunitetit të shkollës dhe kriteri me të cilin gjykohet qeverisja e shkollës.

2. Edukimi për të drejtat e njeriut dhe lidhja e tij me Edukimin për qytetari demokratike ¹³

Edukimi për qytetari demokratike dhe edukimi për të drejtat e njeriut janë në ndërlidhje të ngushtë dhe në mbështetje të ndërsjellë. Ndryshimi ndërmjet tyre nuk qëndron aq në synimet dhe praktikat se sa në fokusin dhe në fushën e veprimit. Edukimi për qytetari demokratike fokusohet kryesisht në të drejtat dhe përgjegjësitë demokratike dhe në pjesëmarrjen aktive në sferat qytetare, politike, shoqërore, ekonomike, ligjore dhe kulturore të shoqërisë, kurse edukimi për të drejtat e njeriut lidhet me fushën e gjerë të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore, në çdo aspekt të jetës së njerëzve.

(Karta e Këshillit të Europës për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe Edukimin për të Drejtat e Njeriut, e miratuar në kuadrin e Rekomandimit CM/Rec(2010)7 të Komitetit të Ministrave n 11 Maj 2010)

Më poshtë përshkruhet më me hollësi lidhja ndërmjet EDNJ dhe EQD.

Dekada më parë, Kombet e Bashkuara dhe agjencitë e specializuara të saj, njohën zyrtarisht edukimin e të drejtave të njeriut, d.m.th., të drejtën e qytetarëve për t'u informuar për të drejtat dhe liritë që përbëjnë përmbajtjen e traktateve të të drejtave të njeriut, të ratifikuara nga vendet e tyre. Qeveritë kanë përgjegjësi dhe japin llogari për zbatimin e standardeve të të drejtave të njeriut përmes ligjeve, politikave dhe praktikave. Ata raportojnë në mënyrë periodike për progresin e bërë në këtë drejtim. Organizatat mbikëqyrëse të tilla si grupet e të drejtave të njeriut ndihmojnë në regjistrimin e këtij progresi.

Është e qartë që qytetarët duhet të dinë dhe të vlerësojnë të drejtat e tyre dhe të respektojnë të drejtat e të tjerëve. Ne duhet të kuptojmë përgjegjësitë ligjore të qeverive tona në përmbushjen e të drejtave tona. Ne duhet të vlerësojmë përgjegjësitë etike të qytetarëve për të mbështetur dhe për të mbrojtur të drejtat e njeriut në jetën e përditshme. Njohuritë dhe prirja për të njohur dhe për të mbrojtur në mënyrë të përgjegjshme të drejtat tona dhe të të tjerëve fillon që në fëmijëri: në familjet tona, në shkollën tonë dhe në komunitetin tonë.

Agjencitë e Kombeve të Bashkuara, si Zyra e Komisionerit të Lartë të të Drejtave të Njeriut, UNESCO dhe UNICEF, së bashku me organizata të tjera ndërqeveritare, si Këshilli i Europës dhe agjenci kombëtare të të drejtave të njeriut, kanë propozuar, në mënyrë të veçantë, që shqyrtimi i temave të të drejtave të njeriut duhet të jetë i pranishëm në shkollë.

Edukimi i të drejtave të njeriut ka përmasën **normative dhe ligjore**. Përmasa ligjore përfshin njohjen e përmbajtjes së standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, ashtu si ato mishërohen në traktatet dhe paktet ndaj të cilave shtetet tona janë angazhuar. Këto standarde përfshijnë të drejtat civile dhe politike si dhe ato shoqërore, ekonomike dhe kulturore. Në vitet e fundit, në këtë kuadër, janë shtuar edhe të drejtat mjedisore dhe kolektive. Qasja që trajton aspektin ligjor të të drejtave pranon rëndësinë e mbikëqyrjes dhe të llogaridhënies për të siguruar që qeveritë mbështetin idenë dhe frymën e detyrimeve për të drejtat e njeriut.

Në të njëjtën kohë, EDNJ është një sipërmarrje **normative dhe kulturore**. Ai është një sistem vlerash që ndihmon për të reflektuar për shkallën në të cilën përvojat tona të përditshme përputhen me normat dhe vlerat e të drejtave të njeriut. Shkrirja e qasjes me bazë të drejtat e njeriut në shkollë do të trajtohet më poshtë në këtë vëllim.

Nga pikëpamja e të mësuarit në klasë, metodat ndërvepruese me në qendër nxënësit, zbatohen gjerësisht si në EDNJ, ashtu dhe në EQD. Pedagogjitë që vijojnë përfaqësojnë ato që mbështeten nga EDNJ:

- Qasja që vë në qendër përvojën dhe veprimin: përfshirja dhe nxitja e njohurive paraprake të nxënësit dhe zhvillimi i veprimtarive që bëjnë të mundur shfrytëzimin e përvojës dhe njohurive të tyre.
- Qasja problemore: sfida e njohurive paraprake të nxënësit.
- Qasja pjesëmarrëse: nxitja e përpjekjeve kolektive në qartësimin e koncepteve, analiza e temave dhe zhvillimi i veprimtarive.
- Qasja dialektike: kërkon nga nxënësit të krahasojnë njohuritë e tyre me ato nga burime të tjera.
- Qasja analitike: kërkon nga nxënësit të mendojnë për t'u dhënë përgjigje pyetjeve “pse” dhe “si”.

13. Autor: Felisa Tibbitts (2009) Burimi origjinal: tibbitts F. (20018), “Human Rights Education” in Bajaj M. (ed.), *Encyclopedia of Peace Education*, Information Age Publishing, Charlotte, NC

- Qasja shëruese: nxitja e të drejtave të njeriut në raport me veten dhe në marrëdhënie me të tjerët.
- Qasja e orientuar nga mendimi strategjik: nxënësit udhëzohen të vendosin synimet e tyre dhe të mendojnë për rrugët strategjike për arritjen e tyre.
- Qasja e orientuar nga objektivi dhe veprimi: u mundëson nxënësve të planifikojnë dhe të organizojnë veprimet në lidhje me këto objektiva ¹⁴

Edukimi i të drejtave të njeriut në kurrikulën e shumë vendeve ndërthuret me edukimin për qytetari demokratike dhe edukimin global, duke u mbështetur në konceptet e edukimit qytetar dhe duke i zbatuar ato në mënyrë më të përgjithshme dhe kritike. Njohuritë për konceptet dhe faktet kryesore, çështjet e prirjeve dhe të aftësive qytetare zbatohen në fusha të përgjegjësive shoqërore globale, të drejtësisë dhe të veprimit shoqëror.

Më tej, edukimi për të drejtat e njeriut kultivon përgjegjësinë sociale dhe nxit veprimin në radhët e nxënësve. EDNJ shkon përtej nxitjes së pjesëmarrjes si element i demokracisë përfaqësuese, duke i drejtuar këto veprime në të gjithë spektrin e të drejtave. Këto veprime mund të jenë të dobishme si mjet për të luftuar shtypjen dhe padrejtësinë.

Kuadri i gjerë normativ i EDNJ dhe spektri i gjerë i nxënësve të mundshëm kanë çuar në një larmi të madhe të rrugëve të zbatimit të EDNJ. Ndonëse EDNJ përcaktohet nga kuadri i përgjithshëm i standardeve ndërkombëtare (ndonjëherë rajonale), çështjet e veçanta dhe zbatimet e tyre varen nga konteksti lokal dhe kombëtar. Edukimi i të drejtave të njeriut në mjedise shkollore përshtatet me moshën e nxënësve dhe veçoritë e politikave arsimore kombëtare/lokale dhe të shkollave.

Temat dhe përmbajtja e të drejtave të njeriut në kurrikulën shkollore mund të marrë formën e temave kroskurrikulare të udhëzuara nga politika arsimore ose ato mund të integrohen në lëndët ekzistuese, si edukimi qytetar, historia, shkencat shoqërore dhe humane. EDNJ mund të jetë pjesë e programeve të arteve dhe të klubeve jashtëshkollore, si dhe e veprimtarive të veçanta që organizohen në mjediset e shkollës.

Karta e Edukimit për Qytetari Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut e Këshillit të Europës rekomandon që këto fusha arsimore të jenë të ndërlidhura dhe të mbështetin reciprokisht njëra-tjetrën. Ato ndryshojnë më shumë në fokus dhe në fushën e veprimit, sesa nga qëllimet dhe praktikat e tyre. Edukimi për qytetari demokratike fokusohet kryesisht në të drejtat dhe përgjegjësitë demokratike si dhe në pjesëmarrjen qytetare, në lidhje me sferat qytetare, politike, shoqërore, ekonomike, ligjore dhe kulturore të shoqërisë, ndërsa edukimi për të drejtat e njeriut përqendrohet më shumë në spektrin e gjerë të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore në çdo aspekt të jetës së njerëzve.

Kur EQD dhe EDNJ ndodhen të pranishëm në mjediset shkollore, ata përforcojnë njëri-tjetrin në mënyrë të ndërsjellë.

Studimi për Edukimin Qytetar i Shoqatës Ndërkombëtare të Arsimit (IEA) i botuar në vitin 1999, ka përdorur të dhëna të mbledhura nga 88000 nxënës të moshës 14 vjeç nga 27 vende.¹⁵ Analiza u krye për të shqyrtuar ndryshimet që ekzistonin ndërmjet vendeve në fushën e njohurive që lidhen me të drejtat e njeriut, të krahasuara me ato të formave të tjera të njohurive qytetare, si dhe qëndrimet e nxënësve në lidhje me nxitjen dhe ushtrimin e të drejtave të njeriut.

Kjo analizë tregoi që përvojat e nxënësve në lidhje me demokracinë në shkollë dhe çështjet ndërkombëtare lidhen me njohuritë e tyre për të drejtat e njeriut. Faktorë të tillë, që mund të përmbliken në konceptin “demokraci në shkollë”, kanë rëndësi për qëndrimet e nxënësve të veçantë ndaj të drejtave të njeriut. Analiza e të dhënave të IEA vërteton që nxënësit, të cilët kanë marrë pjesë në ushtrimin e idealeve demokratike në klasë dhe shkollë, kanë më shumë të ngjarë të kenë qëndrime pozitive në zbatimin e të drejtave të njeriut. Po kështu, nxënësit që zotërojnë më shumë njohuri për të drejtat e njeriut interesohen më shumë për temat ndërkombëtare, mbështetin më shumë qytetarinë pjesëmarrëse dhe janë më të efektshëm politikisht.

Shkollat që mundësojnë EQD dhe EDNJ në kuadrin e njëra-tjetrës, po i aftësojnë nxënësit të jenë qytetarë të përgjegjshëm, që njohin dhe vlerësojnë të drejtat dhe liritë e tyre.

14. ARRC [Asia-Pacific Regional Resource Center for Human Rights Education] (2003), “What is Human Rights Education”, Paketa e Edukimit të të Drejtave të Njeriut, ARRC, Bangkok.

15. Torney-Purta J., Barber C. H. and Wilkenfeld B. (2008), “Si i kuptojnë, i mbështetin dhe i ushtrojnë të drejtat e njeriut adoleshentët e shekullit të njëzet e një”, *Journal of Social Issues*, 64: 1.

3. Kompetencat në EQD/EDNJ

3.1 “Unë dëshiroj që nxënësit e mi të jenë të aftë të...”

“Pasi ushtruar teknikën e prezantimit, unë do të dëshiroja që të gjithë nxënësit e mi të jenë të aftë t’i drejtohen klasës pa lexuar shënimet e tyre”.

“Pas gjashtë orë mësim, kushtuar bazave të kushtetutës, më e pakta që unë do të prisja nga nxënësit e mi është të jenë të aftë të shpjegojnë si funksionon sistemi ynë zgjedhor, cilat janë partitë që konkurrojnë aktualisht për qeverisje”.

“Para disa muajve, ne patem probleme me disa nxënës që nuk pranorin të dëgjonin njëri-tjetrin në diskutime dhe i ndërprisnin ata me të cilët nuk ishin dakord. Ne biseduam shumë për të drejtën e lirisë së shprehjes dhe kjo zbatohet vetëm nëse ne të gjithë i trajtojmë të tjerët me respekt. Deri në fund të vitit shkollor, unë shpresoj që pjesa më e madhe e nxënësve ta kenë kuptuar këtë dhe të dinë si të sillen gjatë diskutimeve”.

Këta shembuj tregojnë çfarë ka në mendje një mësues i EQD/EDNJ kur planifikon mësimin:

Ai përcakton objektivat. Ai vendos çfarë duhet të jenë në gjendje të bëjnë nxënësit dhe çfarë ata mund të arrijnë nëse përpiqen për këtë: ai vendos objektivat që dëshiron të arrihen nga nxënësit dhe, në vijim, merret me procesin e të mësuarit dhe me nevojat e të mësuarit të nxënësve të tij në pikën fillestare – vështirësitë dhe aftësitë e tyre, pikat e forta dhe të dobëta.

Kjo mënyrë të menduari nuk është e re për mësuesit, madje është një praktikë e zakonshme për ta. Pjesa më e madhe e mësuesve jo vetëm mendon për temën dhe lëndën –“Unë duhet të përfundoj shekullin e 19-të, përpara pushimeve” –por edhe për rezultatet që ata presin prej nxënësve të tyre.

Objektivat që përqendrohen te nxënësit dhe për çfarë ata duhet të aftësohen ka lidhje me kompetencat e nxënësit. Pas shkollimit, të gjithë nxënësve do t’u duhet të zgjidhin problemet e jetës pa pasur një mësues, një trajner ose një monitor pranë tyre. Modeli tradicional i mësimdhënies – ofrimi i një grupi solid njohurish, nuk i ndihmon shumë ata të bëhen të pavarur, besimplotë dhe kompetent në të gjitha përmasat e aftësive, vlerave dhe qëndrimeve.

Tri shembujt e mësipërm vënë në dukje ndryshimet që ekzistojnë në tri përmasat e zhvillimit të kompetencës:

- E para – vendosja e kontaktit pamor me audiencën dhe të folurit lirisht – këto aftësi nuk lidhen me një përmbajtje specifike, por ofrojnë mjetet që nxënësit i duhen gjatë gjithë jetës për të përdorur çdo njohuri ose informacion. Kjo ka të bëjë me trajnimin e aftësive “për” qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut – për të aftësuar nxënësit të ushtrojnë të drejtat e njeriut dhe të marrin pjesë në demokraci.
- E dyta – njohja dhe të kuptuarit e bazave të sistemit zgjedhor, e fituesit të zgjedhjeve të fundit dhe që, për këtë arsye, formoi qeverinë aktuale – përbën një “kazu” për të mësuar “rreth” demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Të rinjtë duhet të dinë cilat prej të drejtave të njeriut - për shembull, duke marrë pjesë në zgjedhje – janë integruar, si të drejta civile, në kushtetutën e vendit dhe cili është roli i votës së tyre në sistemin zgjedhor të vendit.
- Së fundi- shembulli i fundit tregon rëndësinë e vlerave dhe qëndrimeve. Demokracia mbështetet në një kulturë politike që formohet nga qëndrimet dhe vlerat e qytetarëve, në këtë rast, respekti i ndërsjellë dhe toleranca për pikëpamjet e kundërta me të tyret. Nxënësit duhet të kenë vullnetin të pranojnë që të drejtat e tyre për liri kërkojnë të merren parasysh edhe të drejtat e të tjerëve. Pra, liria bart përgjegjësi. Një kulturë e të drejtave të njeriut pasqyron fuqizimin e nxënësve dhe të mësuesve të tyre, por edhe të kuptuarit e faktit që respektimi i të drejtave të të tjerëve kërkon nga ne përgjegjësi të ndërsjellë. Vlerat mësohen përmes përvojës dhe modeleve bindëse – mësimi “përmes” demokracisë dhe të drejtave të njeriut.

3.2 Kompetencat – një përkufizim i përgjithshëm

Kompetencat lidhen me atë që një person është në gjendje të bëjë në tri aspekte që formojnë thelbin e identitetit të një personi:

- Çfarë një person di dhe kupton.
- Aftësitë që i japin mundësi një personi të përdorë njohuritë e tij.
- Vetëdija dhe vlerësimi i njohurive dhe aftësive që një person zotëron, që shoqërohen nga vullneti për t'i përdorur ato me vetbesim dhe përgjegjësi.

Aspekti i tretë është shumë i rëndësishëm. Jo vetëm mësuesi duhet jo vetëm të dijë çfarë nxënësi është i aftë të bëjë, por edhe nxënësit. Ata duhet të dinë çfarë zotërojnë në kutinë e veglave mendore dhe për çfarë detyrash ose problemesh mund të përdoren ato. Mbi të gjitha, ata kanë nevojë për vetbesim për të pranuar rrezikun e dështimit në procesin e të mësuarit gjatë gjithë jetës.

3.3 Si do t'i zbulojnë mësuesit kompetencat që zotërojnë nxënësit e tyre? Kompetenca dhe performanca

Kompetencat kanë të bëjnë me aftësitë dhe potencialin brenda nesh. Për këtë arsye ato janë të padukshme. Por, si do t'i zbulojnë mësuesit kompetencat që zotërojnë nxënësit e tyre?

Shembull. Noem Çomski, gjuhëtar, përshkroi kompetencën gjuhësore të banorëve vendas. Këta banorë, që flasin gjuhën amtare, krijojnë në mënyrë të përhershme dhe kuptojnë fjali të cilat nuk i kanë folur ose dëgjuar më parë. Ne nuk mund të shohim kompetencën gjuhësore, por ne e dallojmë performancën e banorëve të tillë. Ne duhet të marrim për të mirëqenë faktin që kompetenca për të komunikuar lirshëm është pjesë e qënësishme e saj.

Nuk ka kompetencë pa sjelljen e vëzhgueshme, por nuk ka asnjë veprim pa kompetenca. Mësuesi vlerëson zhvillimin e kompetencës së nxënësve të tij, duke gjykuar nga performanca e tyre – çfarë ata janë në gjendje të bëjnë. Të mësuarit që bazohet tek një detyrë e caktuar aftëson nxënësit të ushtrojnë kompetencat e tyre, ndërsa mësuesit i aftëson të vlerësojnë arritjet e të mësuarit të nxënësve dhe të identifikojnë nevojat për të ardhmen. Kjo zbatohet jo vetëm në EQD/EDNJ, por në të gjithë procesin e të mësuarit.

3.4 Një model i kompetencave të nxënësit në EQD/EDNJ

Ne vlerësojmë zhvillimin e kompetencës së një nxënësi përmes vëshgimit të arritjeve të tij. Kompetencat janë të padukshme dhe ne mund të hyjmë tek to përmes modeleve që na ndihmojnë të përcaktojmë objektivat e të mësuarit dhe na udhëheqin në procesin e vlerësimit të arritjeve të të nxënësve.

Në këtë botim të EQD/EDNJ ne kemi përshtatur modelin e mëposhtëm të kompetencave. Ai përputhet me parimet themelore të EQD/EDNJ – të mësuarit *përmes*, *rreth* dhe *për* demokraci dhe për të drejtat e njeriut.

Në kompetencat e nxënësit në fushën e EQD/EDNJ, bëjnë pjesë:

- Analiza dhe gjykimi politik
- Aftësitë (shih pjesën 3 të këtij vëllimi)
- Ndërmarrja e veprimeve dhe pjesëmarrja politike;
- Kompetencat personale dhe shoqërore.

3.4.1 Kompetenca e analizës dhe e gjykitimit politik

Qytetaria demokratike kërkon nga qytetarët të kuptojnë çështjet në diskutim, të cilat kërkojnë qytetarë të mirinformuar dhe të aftë të analizojnë problemet dhe linjat e argumentit dhe konfliktit. Kjo përbën përmasën njohëse të zhvillimit të kompetencës (të mësuarit rreth çështjeve politike).

Pa këtë nivel të të kuptuarit, një qytetar do të ishte pre e lehtë e demagogjive, e lobistëve, e populistëve dhe nuk do të ishte në gjendje të identifikonte dhe të negocionte për interesat e tij individuale ose të grupit në të cilin bën pjesë. Ne varemi nga media, për një pjesë të madhe të informacioneve tona. Kjo kërkon nga ne të jemi të aftë ta përdorim këtë informacion në mënyrë kritike.

Ndërmarrja e veprimeve në fushën e politikës, si në çdo fushë të jetës, bëhet e mundur vetëm nëse e dimë çfarë kërkojmë të arrijmë. Ne duhet të jemi të aftë të përcaktojmë interesat dhe objektivat tona, të harmonizojmë nevojat dhe dëshirat, vlerat dhe përjegjësitë. Procesi politik është një **proces vendimmarrjeje për të zgjidhur problemet dhe konfliktet**; Ne nuk mund të shmangim marrjen e vendimeve dhe ato nuk merren pa procesin paraprak të gjykimit.

Larmia, karakteri i ndërlikuar, dëndësia e problemeve të shoqërive të sotme priren të rëndojnë së tepërmi mbi aftësinë analitike dhe gjykimin e “qytetarit normal”. Personalizimi – besimi ose mobesimi ndaj drejtuesve politikë- është një ndër rrugët për ta thjeshtuar tablonë e ndërlikuar të botës dhe të problemeve të saj. Edukimi, jo vetëm në fushën e EQD/EDNJ, vlerësohet thelbësor për të aftësuar qytetarët të jenë gjithmonë të informuar për vendimet që ndikojnë jetën e tyre.

3.4.2 Aftësitë

Nxënësit kanë nevojë për instrumente mendore – aftësi dhe teknika- për të marrë dhe për të përdorur informacion dhe për të formuar idetë e tyre në mënyrë të pavaruar dhe sistematike. Këto instrumente aftësojnë nxënësit:

- të marrin informacion nga media, nga përvoja e drejtpërdrejtë dhe nga kërkimet- teknikat e përdorimit të medias së shkruar dhe elektronike, intervistat, kërkimi, reflektimi etj.;
- të përzgjedhin dhe të studiojnë informacionin (të mësuarit konstruktivist) – teknikat e planifikimit, menaxhimi i kohës, leximi, të menduarit, mbajtja e shënimeve etj.;
- të përcaktojnë, të paraqesin, të ndajnë dhe të argumentojnë pikëpamje e tyre – teknikat e krijimit të fletëve të punës, posterave, letrave, paraqitjes në Poëerpoint, leksionet, diskutimet, debati etj. (të mësuarit e përbashkët konstruktivist)
- të reflektojnë për rezultatet dhe proceset e të mësuarit dhe zbatimit.

Këto aftësi, në shkallë të madhe, janë të nevojshme jo vetëm për EQD/EDNJ, por dhe për shkollën në tërësi. Ato i përgatitin nxënësit për studime të përparuara akademike dhe për punë të kualifikuara. Trajnimet kroskurrikulare të këtyre aftësive, të cilat nuk lidhen domosdoshmërisht me një përmbajtje të caktuar, janë sa të nevojshme aq edhe të mundshme.

3.4.3 Ndërmarrja e veprimit

Trajnimi i aftësive të përgjithshme në fushën e EQD/EDNJ mbështet të mësuarit për demokraci dhe për të drejtat e njeriut. Megjithatë, kjo nuk është e mjaftueshme. EQD/EDNJ e sheh shkollën si një komunitet në të cilin nxënësit mësojnë si të marrin pjesë, praktikisht, në shoqëri dhe në politikë. Kompetencat që synohen të zhvillohen në shkollë përfshijnë:

- reflektimin për dëshirat dhe nevojat dhe qartësimin dhe nxitjen e interesave;
- votimin, marrjen pjesë në zgjedhje si votues dhe si kandidatë (përfaqësuesit e klasave);
- negocimin dhe vendimmarrjen;
- ndikimin në proceset e vendimmarrjes, përmes rritjes së vetëdijes, në grupet e interesit dhe në veprimin kolektiv;

ED/EDNJ në shkollë luan një rol vendimtar në sigurimin e shanseve të të mësuarit për nxënësit, për të dhënë kontributin e tyre në komunitet. Megjithatë, vlerësimi real i arritjeve dhe i zhvillimit të kompetencave të mësim-përme nuk mund të bëhet i plotë brenda shkollës. Ai mundësohet përtej mureve të shkollës, në shoqëri dhe gjatë tërë jetës. Por, edhe në këtë kohë, është e vështirë, në mos e pamundur, të lidhësh rezultatet e të mësuarit me mundësitë dhe kushtet e shkollës.

3.4.4 Kompetencat personale dhe shoqërore

Koncepti i kompetencës merr më shumë peshë se duhet kur shtrihet në përmasën e vlerave dhe qëndrimeve. Nga ana tjetër, janë arritjet e nxënësve, mënyra si ata sillen ajo që ka rëndësi. Edhe prirja për t'u sjellë në një mënyrë të caktuar mund të konsiderohet si kompetencë. Përmasa e zhvillimit të kompetencës përputhet me të mësuarit përmes demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Ajo përfshin:

- vetëdijen dhe vetëvlerësimin;
- empatinë;

- respektin e ndërsjellë;
- vlerësimin e nevojës për kompromis;
- përgjegjësinë;
- vlerësimin e të drejtave të njeriut si një grup vlerash të përbashkëta kolektive për të mbështetur paqen, drejtësinë dhe kohezionin shoqëror.

3.5 Kompetencat e mësuesit në EQD/EDNJ

Në fushën e EQD/EDNJ, mësuesit duhet të zotërojnë disa kompetenca të veçanta për t'u mundësuar nxënësve shanse të përshtatshme të mësuari. "Kutia" e instrumenteve për mësuesit përfshin një mjet për të mbështetur mësuesit në përcaktimin e objektivave në bazë kompetencash në fushën e EQD/EDNJ, në përputhje me ato çfarë janë parashtruar deri tani. Për më tepër informacion, konsultohuni me botimin e Këshillit të Europës "Si mund të mbështesin mësuesit edukimin për qytetari dhe të drejtat e njeriut: një kuadër për zhvillimin e kompetencave (Strasbourg 2009)

4. “Ne rikrijomë botën në mendjet tona”: të mësuarit konstruktivist në EQD/EDNJ¹⁶

Kur lexojmë një histori, në mendjen tonë e kthejmë atë në diçka të ngjashme me një film. Ne shtojmë hollësi të tjera dhe skena të cilat autori i nënkupton ose i lë jashtë. Ne mund edhe të përfytyrojmë fytyrat e personazheve. Disa romane i ngulisin aq shumë këto në përfytyrimet tona, sa ndonjëherë pësojmë zhgënjim kur shohim të njëjtën ngjarje në një film të vërtetë. Imagjinata jonë ka krijuar një “film” tjetër, shumë më të mirë dhe të veçantë, siç është edhe mendja e çdo lexuesi.

Ky është një shembull i aftësisë sonë “për të rikrijuar botën në mendjet tona”. Bota në të cilën jetojmë, në një farë mënyre, është bota si ne e perceptojmë: ajo përbëhet nga konceptet dhe gjykimet që ne kemi krijuar për të. Si nxënës, ne përpiqemi të kuptojmë atë që lexojmë ose dëgjojmë. Një studiues i trurit e karakterizon trurin e njeriut si një “makinë që kërkon kuptim”. Gjërat që nuk kanë kuptim duhet të veçohen. Nëse mungon informacioni, ne duhet ta gjejmë atë ose ta plotësojmë, duke e hamendësuar vetë.¹⁷

Me pak përvojë, mësuesi vë re se gjatë leksionit, çdo nxënës merr dhe kujton një mesazh të ndryshëm. Disa nxënës do ta kujtojnë këtë informacion edhe kur të jenë të rritur, sepse ajo mund të jetë lidhur ngushtë me interesat e tyre. Të tjerë mund ta harrojnë atë që ditën tjetër, sepse nuk lidhet me strukturën e tyre të njohurive dhe të vlerave. Pikëpamja konstruktiviste, interesohet për atë që ndodh në mendjen e nxënësit.

Konstruktivizmi e koncepton të mësuarit si një proces shumë të individualizuar:

- Nxënësit ndërtojnë, ndryshojnë ose krijojnë strukturat e të kuptuarit. Informacioni i ri lidhet me njohuritë paraprake të tyre.
- Nxënësit vijjnë në një orë EQD/EDNJ me përvojat dhe biografitë e tyre vetjake.
- Gjinia, klasa, moshë, prejardhja etnike ose besimet fetare dhe identitetet e tjera mund të ndikojnë në qëndrimin e nxënësit.
- Ne zotërojmë forma të ndryshme inteligjence që shkon përtej të kuptuarit të thjeshtë të të qenit nxënës i mirë në matematikë ose në gjuhë.¹⁸
- Nuk ka standarde absolute për qëndrimet personale ose politike.

Të mësuarit konstruktivist mund të ndahet në tri nënkategori dhe mësuesi luan rol të rëndësishëm në mbështetjen e tyre.

4.1 Nxënësit “ndërtojnë” kuptimin – ata zbulojnë dhe krijojnë diçka të re

Mësuesit mund të mbështesin nxënësit e tyre, përveç të tjerave:

- duke krijuar shanse të mësuarit;
- duke caktuar detyra sfiduese;
- duke mundësuar mësimin përmes medias dhe leksioneve që përfaqësojnë objektet e të mësuarit;
- duke nxitur dhe duke mbështetur vetvlerësimin e nxënësit.

16. Për trajtim më të plotë të kësaj teme shiko Vëllimin IV në këtë seri botimesh.

17. Shiko Gollob R. dhe Krapf P. (eds) (2008), EQD/EDNJ Volume III, Njësia 1, *Stereotipat dhe paragjykimet. Çfarë është identiteti? Si i shoh të tjerët, si të tjerët më shohin mua?* Strasbourg, pp. 19-38.

18. Shiko veprën e Hoëard Gardner për inteligjencat e shumëfishta.

4.2 Nxënësit “rindërtojnë” ata çfarë kanë mësuar – ata e zbatojnë dhe e verifikojnë atë

Të gjithë ne, në përgjithësi, jemi autorë të zbatimeve të tilla, por në shkollë, mësuesi i mundëson ato:

- duke krijuar shanse për shkëmbim, paraqitje dhe diskutim të ideve;
- përmes testimit dhe vlerësimit;
- përmes punës për portofolit;
- përmes detyrave sfiduese, për shembull, përmes projekteve.

4.3 Nxënësit analizojnë ose kritikojnë rezultatet e tyre dhe të të tjerëve

Pa rishikimin dhe testimin kritik çdo përpjekje do të ishte e padobishme për shoqërinë dhe për vetë nxënësin. Që këtëj buron, në një farë mënyre, dimensionin shoqëror i të mësuarit.

5. Etika profesionale e mësuesit të EQD/EDNJ: tre parime

Në një orë mësimi të EQD/EDNJ, nxënësit mund të vijnë me mendimet e tyre, të ndryshme nga ato të mësuesit. Zakonisht, kjo është problem për mësuesit. Mësuesit e EQD/EDNJ duhet të bëjnë kujdes të mos i detyrojnë nxënësit të përqafojnë pikëpamjet ose vlerat e mësuesit. Shkollat janë institucione publike dhe prindërit e shoqëria presin prej mësuesve të mos abuzojnë e të indoktrinojnë fëmijët me pushtetin e tyre.

Etika profesionale e mësuesve të EQD/EDNJ është e rëndësishme për suksesin dhe për vetë rëndësinë e EQD/EDNJ si pjesë e kurrikulës shkollore. Ajo mund të përmbledhet në tri parime që burojnë nga një debat i zhvilluar për këtë çështje në Gjermaninë e viteve 70'.¹⁹

5.1 Parimi i mos-indoktrinimit

Mësuesi, në asnjë mënyrë, nuk duhet të përpiqet të indoktrinojë nxënësit e tij për të pranuar një ide të dëshiruar, për shembull, nga pikëpamja e korrektësisë politike. Për këtë arsye, mësuesi nuk duhet t'u kërkojë nxënësve të heshtin ose të mbysë fjalën e tyre në emër të pushtetit më të lartë. Në të kundërt, nxënësit duhet të gjykojnë lirisht pa ndërhyrje ose pengesa. Çdo përpjekje nga mësuesi për të indoktrinar nxënësit nuk përputhet me EQD/EDNJ dhe objektivit e edukimit të qytetarëve të aftë dhe me vullnetin për të marrë pjesë në një shoqëri të hapur dhe demokraci të lirë, pluraliste.

5.1.1 Zbatimet praktike

Mësuesi duhet të drejtojë diskutimet gjatë veprimtarisë së EQD/EDNJ, por nuk duhet të marrë pjesë në to. Nga ana tjetër, nëse nxënësit kërkojnë pikëpamjen e mësuesit në lidhje me çështjen në diskutim, ne këshillojmë që mësuesi ta shprehë atë. Nxënësit e dinë se mësuesi ka qëndrimin e tij politik, si çdo qytetar tjetër dhe, shpesh herë, ata janë të interesuar ta dëgjojnë atë. Atëherë, mësuesi duhet të bëjë të qartë se ai ose ajo nuk po shprehen në rolin e një profesionisti, por të një qytetari. Në fakt, nxënësi mund ta gjykojë si të çuditshëm qëndrimin neutral nga pikëpamja politike e një mësuesi të EQD/EDNJ, në një kohë që nxënësve u kërkohet ta shprehin atë vazhdimisht.

Një mësues i përkushtuar ndaj të drejtave të njeriut mund të vuajë nëse një nxënës shpreh prirjen e tij ndaj racizmit, nacionalizmit ose të ndonjë lloj fundamentalizmi. Mësuesi duhet të shmangë përdorimin e pushtetit më të lartë ndaj nxënësit, por të përpiqet të kuptojnë përse një i ri ka përqaftuar një linjë të tillë mendimi dhe të gjejë rrugët për të sfiduar nxënësit për të menduar ndryshe.

5.2 Parimi i diskutimit kundërshtues

Cilado qoftë çështja kundërshtuese në fushën e shkencës ose politikës, ajo duhet të paraqitet si e tillë edhe në fushën e EQD/EDNJ. Ky parim lidhet ngushtë me atë të mos-indoktrinimit: nëse fshihen pikëpamjet e ndryshme dhe shpërfillen alternativat, vetë EQD/EDNJ vihet në rrugën e indoktrinimit. Klasat e EQD/EDNJ duhet të lejojnë vështirësitë, kundërshtitë, madje edhe kontradiktat. Për shembull, edhe pse të drejtat e njeriut janë universale, të drejtat individuale mund të hyjnë në konflikt me njëra-tjetrën.

Në një shoqëri pluraliste, mosmarrëveshjet, vlerat ndryshe dhe interesat konkurruese janë rregull dhe jo përjashtim. Në demokraci, debati dhe diskutimi janë mjete për zgjidhjen e problemeve dhe të konflikteve. Marrëveshjet dhe një shkallë e caktuar harmonie e arritur përmes kompromisit është rezultat i negociimit. Harmonia e arritur me anën e detyrimit, pa diskutime të hapura të çon në shtypje.

5.2.1 Zbatime praktike

Në EQD/EDNJ, mësuesi duhet të paraqesë të paktën dy pikëpamje në lidhje me çështjen në diskutim, ashtu sikurse edhe baraspeshën e duhur në trajtimin e saj.

19. Shih "Der Beutelsbacher Konsens" (www.lpb-bw.de).

Në diskutimet gjatë seancave plenare, mësuesi duhet të mirëpresë pikëpamjet e ndryshme të nxënësve. Nëse një pikëpamje shprehet nga një pakicë ose edhe vetëm nga një nxënës, mësuesi duhet ta pranojë atë edhe për hir të argumenteve të nevojshme, duke shprehur qartë rolin e tij të veçantë dhe jo mendimin e tij vetjak. Mësuesi duhet të bëjë kujdes që të përshtasë pushtetin e tij të argumenteve me atë të nxënësve.

5.3 Fuqizimi i nxënësve për të mbrojtur interesat tyre

Nxënësit duhet të jenë të aftë të analizojnë një situatë politike dhe të dallojnë interesat e tyre për të gjetur rrugët dhe mjetet për të kthyer situatën në interes të tyre. Ky objektivi kërkon që nxënësit të pajisen me aftësi dhe kompetenca për të ndër marrë veprime. Kjo mund të arrihet vetëm nëse merren parasysh edhe dy parime të tjera, ai i mos indoktrinimit dhe ai i diskutimit kundërshtues. Ky parim nuk duhet të shihet si nxitës i egoizmit dhe i heqjes dorë nga përgjegjësia. Çdo komunitet mbështetet në këto vlera, por e rëndësishme këtu është që mësuesi të mos pengojë nxënësit të ngrenë lart dhe të mbrojnë interesat e tyre, duke u kujtuar atyre vazhdimisht vetëm detyrat dhe përgjegjësitë.

5.3.1 Zbatim praktike

Shkolla është një shoqëri në miniaturë, ku nxënësit mësojnë si të marrin pjesë në të. Kjo mund të bëhet në disa mënyra. Mësuesi u jep nxënësve mundësinë të zgjedhin temat që u interesojnë dhe të marrin pjesë në planifikimin e mësimit, në veprimtari të tilla si qeverisja demokratike e shkollës (të mësuarit përmes demokracisë dhe të drejtave të njeriut) si dhe në veprime konkrete.

Të mësuarit në bazë detyre dhe problemi ndihmon në zhvillimin e aftësive të nxënësve për gjykime dhe vendimmarrje të pavarura.

6 Konceptet themelore në EQD/EDNJ

6.1 Përse kemi nevojë për koncepte themelore në EQD/EDNJ ?

EQD/EDNJ është një proces i të mësuarit konstruktivist.²⁰ Nxënësi krijon ose ndërton kuptimin duke lidhur konceptet konkrete dhe abstrakte. Të menduarit abstrakt bazohet në koncepte. Ne mund të shkëmbejmë ide, të diskutojmë, të debatojmë e të gjykojmë vetëm nëse përdorim koncepte për përmbajtjen e të cilave ndajmë të njëjtin kuptim.

Për këtë arsye, konceptet janë të domosdoshme, si për të mësuarit konstruktivist, ashtu dhe për vendimmarrjet politike. Cilat janë konceptet që duhet të zgjedhim? Ne jetojmë në një shoqëri pluraliste. Kjo do të thotë që individët dhe grupet mbështetin interesa dhe vlera të ndryshme. Për më tepër, edhe filozofia dhe shkencat sociale përdorin metoda të ndryshme, deri edhe të kundërta me njëra-tjetrën. Për këtë arsye, është e pamundur që të përzgjedhësh një grup konceptesh kryesore vetëm nga një burim. Në të mësuarit konstruktivist, zhvillimi i kompetencave e bën përdorimin e koncepteve të domosdoshëm dhe, për këtë arsye, edukimi për qytetari është ende në kërkim të modeleve konceptuale. Modeli i ofruar në këtë botim është njëri prej tyre.

Ne kemi zgjedhur grupin prej nëntë konceptesh, sepse ata përfshijnë si përvojat e nxënësve në një shoqëri në miniaturë, ashtu edhe komunitetin politik si një të tërë:

- identiteti;
- diversiteti dhe pluralizmi;
- përgjegjësia;
- konflikti;
- rregullat dhe ligji;
- qeverisja dhe politikat;
- barazia;
- liria;
- media.

Konceptet themelore krijojnë një kurrikul që zhvillohet në formë spirale, ndërkohë që volumet e zhvendosin fokusin nga komuniteti i shkollës (niveli fillor, vëllimi II) te komuniteti politik (niveli i arsimit të mesëm, vëllimi IV), me vëllimin III që i përfshin të dyja aspektet (shih pjesa I, Njësia 4 në këtë vëllim). Konceptet “demokraci” dhe “të drejtat e njeriut”, si konceptet themelore të EQD/EDNJ, përshkojnë të nëntë konceptet e renditura më sipër e që trajtohen në njësi të veçanta të këtij vëllimi. Të gjithë konceptet kryesorë mund dhe duhet të lidhen me koncepte dhe kategori të tjera, në varësi të moshës së nxënësit dhe lëndës. Të tre vëllimet përfshijnë nëntë njësi model, të përbërë nga katër mësimet secili, të cilët trajtojnë të njëjtin grup konceptesh themelore. Në këto vëllime, tregohen mënyra të ndryshme të përshtatjes së të njëjtit koncept me nivelin e të kuptuarit të nxënësit dhe të moshës së tij. Këto vëllime, në koherencë vertikale, ndërtohen në bazë të procesit të të mësuarit konstruktivist dhe, kur është e mundur, mbështeteten nga një koncept i veçantë. Në të njëjtën kohë, konceptet themelore ndërlidhen edhe në plan horizontal, në formën e një rrjete. Një tregues i përgjithëm i lidhjeve të mundshme të koncepteve ka të bëjë me lidhjet me dimensionin politik të cilit ato i referohen.²¹

6.2 Thelbi i koncepteve themelore

Kjo pjesë përshkruan shkurtimisht thelbin e nëntë koncepteve kryesore në këtë botim në fushën e EQD/EDNJ, dhe trajton rëndësinë e tyre për këtë edukim në nivelin e shkollës dhe të komunitetit politik.

20. Shih Njësia 3 për të mësuarit konstruktivist në Pjesën 1 të këtij vëllimi.

21. Për më shumë informacion për tri dimensionet kryesore të politikës, shih Fletë pune në këtë vëllim. (si mund të trajtoj politikat në orën e EQD/EDNJ?)

6.2.1 Identiteti

Të drejtat e njeriut, si të drejta natyrore, përqendrohen tek individit. Të gjitha qëniet njerëzore janë të pajisura me dinjitetin njerëzor dhe me të drejtën për të jetuar në liri dhe për t'i gëzuar të drejtat të lirë nga diskriminimet. Shteti duhet t'i shërbejë individit dhe jo e kundërta. Liria personale i jep individit të drejtën për të zhvilluar lirisht personalitetin e tij, duke përfshirë këtu edhe zgjedhjet për gjërat kryesore të jetës si vlerat, partnerët, profesionet, fëmijët etj. Në shoqëritë moderne, kjo liri është një sfidë, ashtu sikurse është e tillë edhe dobësimi i lidhjeve dhe i traditave (familja, feja etj.). Kjo kërkon nga njeriu të bëjë zgjedhje të rëndësishme, të cilat ndikojnë tek njera-tjetra në mënyrë të ndërsjellë, duke modeluar identitetet tona. Kjo kërkon që ne të marrim përsipër përgjegjësi për zgjedhjet që bëjmë. Që në shkollë, nxënësit shkëmbejnë me njëri-tjetrin përvojat e tyre dhe punojnë së bashku për zgjedhjet që të gjithë duhet të bëjnë në jetë, si në fushën e arsimimit, ashtu edhe në atë të karrierës. Koncepti i identitetit lidhet ngushtë me diversitetin dhe pluralizmin, lirinë, barazinë dhe përgjegjësinë.

6.2.2 Diversiteti dhe pluralizmi

Shoqëritë moderne janë shoqëri pluraliste. Individët, duke ushtruar të drejtat njerëzore të lirisë, do të prodhojnë pluralizëm – një larmi identitetesh të veçanta me zgjedhje të ndryshme jetësore, përparësish dhe interesash, të kufizuara ose të mbështetura, sipas rastit, nga burime materiale – të ardhura ose pronë. Diversiteti përfshin larminë e bazuar në gjini, origjinë etnike, klasë, moshë, rajon, besim fetar dhe vlera. Shoqëritë pluraliste vendosin përpara njeriut një sfidë të tillë: Cilat janë vlerat që mund të pranojnë anëtarët e një shoqërie? Stabiliteti i komuniteteve që bazohen në të drejtat e njeriut varet nga kushtet që mund të sigurojë një shoqëri demokratike (dilema ndërmjet lirisë dhe stabilitetit). Kjo vlen edhe për shkollat, ku nxënësit duhet të mësojnë të kuptojnë dhe të trajtojnë diversitetin dhe pluralizmin si një sfidë. Ky stabilitet duhet të arrihet dhe kjo kërkon trajtimin e harmonizuar të problemeve dhe risqeve me shanset. Koncepti i diversitetit dhe i pluralizmit lidhet ngushtë me qeverisjen dhe politikën, lirinë, konfliktin dhe përgjegjësinë.

6.2.3 Përgjegjësia

Liria duhet të gëzohet nga të gjithë dhe, për këtë arsye, të gjithë duhet të pranojnë edhe kufizimet e saj. Kjo fillon, për shembull, me respektimin e kohës së njëjtë të ligjërimit dhe vëmendjen që duhet t'i kushtohet çdo nxënësi në klasë. Në shoqëritë që bazohen në tregtinë dhe konkurrencën e lirë, shpërndarja e pabarabartë e të ardhurave dhe e mirëqënies të çon në shpërndarje të pabarabartë të shanseve për të ushtruar lirinë. Në demokraci, parimi i sundimit të shumicës duhet të baraspeshohet me mbrojtjen e interesit të pakicave, me qëllim që të sigurohet kohezioni shoqëror.

Të vendosësh baraspeshën ndërmjet lirisë dhe barazisë në shoqëri nuk është e lehtë, madje është shumë e vështirë. Një mënyrë për t'i harmonizuar ato është përmes përgjegjësisë personale, tjetra është përmes vendimmarrjeve politike detyruese. Të dyja mënyrat janë të domosdoshme dhe plotësojnë njëra-tjetrën. Ligjet nuk mund të kujdesen për çdo rastësi të jetës së përditshme dhe nuk do të ishte as e mundëshme dhe as e dëshirueshme që jetët tona të mbikëqyreshin dhe të kontrolloheshin nga shteti. Një komunitet i bazuar në të drejtat e njeriut mbështetet në vullnetin dhe aftësinë për të marrë përsipër përgjegjësinë për sjelljet tona dhe nevojat e të tjerëve.

Përgjegjësia lidhet ngushtë me lirinë, barazinë, identitetin, rregullat, ligjet dhe konfliktet.

6.2.4 Konflikti

Larmia e opinionëve, konkurrenca e nevojave, interesave dhe konflikteve janë pjesë e jetës njerëzore dhe veçanërisht e shoqërive pluraliste. Shumë njerëz e konsiderojnë konfliktin të dëmshëm, që pengon harmoninë dhe, për këtë arsye, duhet të shmanget. Megjithatë, konflikti, në vetvete, nuk është i dëmshëm. Të tilla janë disa nga mënyrat me të cilat ai trajtohet dhe zgjidhet. Në EQD/EDNJ nxënësit duhet të mësojnë që, në kuadrin e rregullave procedurale, të mbështetura nga një kulturë politike e respektit të ndërsjellë, ekziston hapësirë e mjaftueshme për kundërshtime dhe argumente. Individët dhe grupet mundet dhe në të vërtetë, duhet të shprehin interesat e tyre për të siguruar që ato do të merren parasysh. Në diskutimet dhe negociatat, të gjitha palët duhet të jenë të përgatitura për negociata e kompromise. Pa qëndrimet dialektike dhe konstruktive ndaj interesave vetjake asnjë kompromis nuk do të ishte i mundshëm.

Në parim, çdo konflikt në lidhje me shpërndarjen e burimeve që mund të kthehet në një shumë ose numër konkret, mund të zgjidhet me anë të një kompromisi. Nga ana tjetër, konfliktet që lidhen me ideologjinë, vlerat ose origjinën etnike, është vështirë të zgjidhen me kompromis. Kultura e zgjidhjes paqësore të konfliktit, e bazuar në respektin e ndërsjellë është e domosdoshme për qytetarinë demokratike. Konfliktet krijohen në shkollë si në çdo vend tjetër pune ose komuniteti, duke u dhënë nxënësve mundësinë të mësojnë t'i pranojnë ata pa frikë dhe t'i zgjidhin në rrugë paqësore. Konflikti lidhet ngushtë me diversitetin dhe pluralizmin, qeverisjen dhe politikën, rregullat, ligjet dhe përgjegjësinë.

6.2.5 Rregullat dhe ligjet

Ligjet sigurojnë kuadrin institucional për komunitetet demokratike që bazohen në të drejtat e njeriut. Në parim, nga të gjithë pritet zbatimi i ligjit, sepse ai është miratuar me shumicë votash. Zakonisht, kjo nënkupton votën parlamentare, e cila i takon shumicës në zgjedhjet e përgjithshme, por mund të jetë edhe rezultat i një referendumi. Ligjet janë bërë për të pasqyruar dhe për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe shoqërohen me një sërë procedurash për zgjidhjen e konflikteve dhe për proceset e vendimmarrjeve politike. Rregullat shërbejnë për të njëjtat qëllime, por ato krijohen nga organizma të tjerë dhe mund të jenë të shkruara ose të pashkruara.

Nga ne pritet të zbatojmë ligjin. Por çfarë ndodh nëse ne mendojmë që ligji është i padrejtë? Ekzistojnë shumë raste të reformave sociale dhe ligjore që kanë pasur si shkëndijë mosbindjen civile: qytetarët, me vullnetin e tyre të lirë, nuk i binden ligjit për të cilin mendojnë se është i padrejtë ose përbën shkelje e të drejtave të njeriut, dhe kërkojnë përmirësim të tij.

Nxënësit duhet të kuptojnë dhe të vlerësojnë dialektikën ndërmjet lirive, mbrojtjes së tyre dhe kufizimeve përmes kuadrit ligjor. Nëse mungon kuadri ligjor, liria do të kthehej në anarki, e kjo e fundit në dhunë. Në të mësuarit në bazë detyre, nxënësit e zbatojnë këtë parim në shkollë. Vendosija e detyrave, e kohës dhe rregullave për këtë lloj të mësuarit nuk e pengon krijueshmërinë e nxënësve por, në të kundërtën, i fut ata në hapësirën e madhe të lirisë dhe të krijimit. Nxënësit mund të marrin pjesë edhe në reformimin e ligjeve të shkollës që nuk pasqyrojnë vlerat demokratike ose ato të të drejtave të njeriut.

Rregullat dhe ligjet lidhen ngushtë me konfliktet, lirinë dhe barazinë

6.2.6 Qeverisja dhe politika

Në EQD/EDNJ, konceptet kryesore të politikës fokusohen në aspektet e politikës si një proces i zgjidhjes së konflikteve dhe problemeve. Qeverisja lidhet me aspektet institucionale të politikës, domethënë me vendimmarrjen politike në kuadrin e institucional. Qeverisja demokratike e shkollës u jep nxënësve mundësinë të mësojnë si të ndikojnë dhe si të marrin pjesë në proceset vendimmarrëse që menaxhojnë një komunitet dhe përcaktojnë objektivat e tij. Modeli i ciklit politik mund të zbatohet në proceset e vendimmarrjes, si në nivelin e komunitetit të shkollës ashtu edhe në atë të komunitetit politik si një i tërë (niveli koombëtar ose rajonal). Media luan rol vendimtar në kontrollin e vendimmarrësve në fushën politikës dhe të përcaktimit të programeve politike. Ky model zbatohet edhe në shkollë, siç e dëshmojnë njësitet mësimore për medien në vëllimet 2-5.

Si një çift konceptesh, qeverisja dhe politikat kanë të bëjnë me mjediset e ndryshme të vendimmarrjeve politike. Qeverisja vë theksin në dimensionin institucional dhe hierarkinë, kurse politika përfshin dimensionin informal – dimension më i gjerë por, pa ose me më pak rregulla. Ana informale, plotësuese e politikës është e rëndësishme për vetë efektshmërinë e sistemi institucional. Si në shkollë ashtu edhe në politikë, institucionet nuk mund të merren me të gjitha problemet dhe çështjet. Për këtë arsye, ato varen nga qytetarët, prej të cilëve kërkohet të zgjidhin vetë mosmarrëveshjet dhe konfliktet ndërpersonale. Qeverisja dhe politika lidhen ngushtë me konfliktin, rregullat dhe ligjet, përgjegjësinë dhe medien.

6.2.7 Barazia dhe liria

Këto koncepte themelore, këtu, trajtohen së bashku për dy arsye:

Së pari, dinjiteti njerëzor përbën vlerën qendrore të të drejtave të njeriut. Këto dy parime bazë të drejtësisë që përbëjnë thelbin e dinjitetit njerëzor nga pikëpamja ligjore janë barazia (mosdiskriminimi) dhe liria (që përjetohet përmes të drejtave civile dhe politike). Dinjiteti i një personi kërcënohet nga diskriminimi dhe burgosja. Dy gjeneratat e para të të drejtave të njeriut fokusohen në të drejtat e lirisë dhe të barazisë së shpërndarjes dhe shanseve.

Së dyti, ndërmjet lirisë dhe barazisë ekzistojnë kundërshti. Për shembull, liria e shprehjes nënkupton që një nxënësi duhet t'i jepet mundësia të shprehë opinionin e tij në klasë, ashtu si ai e mendon atë. Nga ana tjetër, barazia e shanseve për të gjithë nxënësit kërkon që koha që i takon secilit për t'u shprehur të jetë e barabartë, për shembull, një ose dy minuta. Kjo do të thotë që liria individuale e shprehjes duhet të kufizohet, madje rreptësisht, për t'i garantuar çdo nxënësi shansin të marrë pjesë në debat. Shkalla në të cilën një nxënës i veçantë e "vuan" këtë kufizim varet nga aftësia e tij për të paraqitur shkurt dhe qartë pikëpamjen e tij. Për këtë arsye, në fushën e EQD/EDNJ, nxënësit duhet të zhvillojnë kompetencën për të vendosur një raport të drejtë e të barazpeshuar ndërmjet lirisë së shprehjes dhe barazisë së shanseve. Këto kompetenca përfshijnë aftësitë gjuhësore, të kuptuarit e çështjeve në diskutim dhe vlerësimin e rregullave që garantojnë barazpeshën ndërmjet lirisë dhe barazisë.

Nxënësit duhet të mësojnë të ushtrojnë të drejtat e lirisë, për shembull, lirinë e mendimit, të shprehjes dhe të informimit. Ata duhet të mësojnë të sfidojnë diskriminimin, si në emrin e tyre ashtu edhe në emër të të tjerëve. Mësuesit duhet të jenë të vetëdijshëm për kushtet dhe shanset e pabarabarta të të mësuarit të rrënjësura në diferencat, për shembull, në të ardhura dhe në nivelin e arsimimit të prindërve, ose në prejardhjen dhe origjinën e tyre kulturore dhe etnike. Shkolla dhe shoqëria nuk mund të arrijnë shpërndarjen e barabartë, por ato mund të garantojnë kushte fillestare të barabarta për të gjithë nxënësit. Në shkollë, kjo kërkon nga mësuesit të marrin parasysh nevojat e veçanta të të mësuarit të çdo nxënësi. Barazi do të thotë të mos trajtosh çdo individ në të njëjtën mënyrë, por në mënyrën që i shërben nevojave individuale të secilit. Kjo nënkupton atë që mësimdhënia përmes të drejtave të njeriut përmbledh në praktikë.

Ashtu si në demokraci, liria dhe barazia lidhen ngushtë me të gjithë konceptet. Asnjë aspekt i EQD nuk mund të kuptohet i shkëputur nga trajtimi i çështjeve që lidhen me lirinë dhe barazinë, të cilat përbëjnë thelbin e dinjitetit njerëzor dhe, njëherazi, edhe kundërshtitë ndërmjet tyre.

6.2.8 Media

Ky koncept lidhet me faktin që në shoqërinë moderne ne jetojmë në një kulturë mediatike. Media është e domosdoshme në ushtrimin e të drejtave të njeriut, duke përfshirë lirinë e shprehjes, shkëmbimin e informacionit, të drejtën për informim dhe sigurimin e saj, pjesëmarrjen politike, kontrollin ndaj qeverisjes dhe procesit të vendimmarrjes politike dhe programit politik. Sa më komplekse bëhen shoqëritë tona dhe strukturat e ndërvarësisë globale, sa më shumë të kemi nevojë për mbështetje dhe drejtim për të kuptuar sfidat dhe çështjet e të sotmes dhe të ardhmes, aq më shumë ne mbështetemi te media. Media vendos para nesh shumë sfida, duke hapur para nesh shanse dhe mjete komunikimi dhe pjesëmarrjeje, por edhe për manipulim dhe krim

Media është një ndërmarrje tregtare dhe "tregimi dhe shitja" priret të jetë e tillë. Media transformon informacionin që transmeton. Nxënësit duhet të fitojnë kompetencën të përdorin mjetet e medias (si të ndërtojnë një mesazh) dhe të analizojnë e kuptojnë mesazhet e transmetuara prej saj. Media luan rol të rëndësishëm edhe në komunitetin e shkollës. Nxënësi mund të jenë më të vetëdijshëm për faktin që media bën pjesë në jetën e tyre, se sa brezi i prindërve të tyre. Për këtë arsye, ka të rinj që kanë më shumë përvojë se prindrit dhe mësuesit e tyre në përdorimin e medias. Në EQD/EDNJ, kompetenca që lidhet me medien është kyç për pjesëmarrjen dhe zhvillimin e kompetencave në shumë fusha të tjera.

Koncepti i medias lidhet ngushtë me qeverisjen dhe politikën, identitetin, lirinë dhe përgjegjësinë.

7 Metoda bart mesazhin: të mësuarit e bazuar te detyra në EQD/EDNJ

7.1 Kufizimet e edukimit tradicional të qytetarisë

Në mësimdhënien tradicionale që bazohet te përmbajtja, edukimi qytetar përqendrohet tek faktet dhe informacioni rreth kuadrit institucional të vendit. Përmbajtja ka qenë pak a shumë “pa kohë” dhe mund të mësohet dhe të testohet sistematikisht. Nga këndvështrimi i nxënësit, ka pak ndryshim ndërmjet të mësuarit përmendësh të fakteve rreth parlamentit ose rreth specieve të ndryshme të peshqëve të ujëra të ëmbla për qëllimet e një testi të sotëm, por të harruara nesër. Një qasje e tillë nuk ofron vlera të shtuara për edukimin e qytetarëve në komunitete demokratike, të bazuara në të drejtat e njeriut.

7.2 Të mësuarit *përmes* dhe *për* demokraci dhe për të drejtat e njeriut kërkon të mësuar aktiv

Në fushën e EQD/EDNJ, informacioni për sistemin politik të vendit ka një qëllim: ai mundëson aftësimin e nxënësit të marrë pjesë në të (të mësuarit “*për*” demokraci dhe të drejtat e njeriut). Megjithatë, pjesëmarrja politike këkon trajnim dhe përvojë. Për këtë arsye, në fushën e EQD/EDNJ, metoda duhet të bartë edhe mesazhin. Të mësuarit “*rreth*” demokracisë dhe të drejtave të njeriut ka nevojë të mbështetet nga mënyra si nxënësit mësojnë- të mësuarit “*përmes*” demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Nxënësit kanë nevojë për mjedise të nxëni që mbështetin të mësuarit ndërveprues, konstruktivist si dhe trajnimin e kompetencave. Pra, ata duhet të jenë aktivë dhe ndërveprues, në mënyrë që mësuesit të ndihen të detyruar t’i lejojnë ata “t’i hapin vetes punë” dhe të komunikojnë.

7.3 Detyrat – Mjetet që mësuesi përdor për të mbështetur të mësuarit aktiv

Në këndvështrimin e mësuesit, detyrat e përgatitura me kujdes janë mjetet kryesore për të mbështetur proceset aktive të të mësuarit. Në skicimin ose në përshtatjen e detyrave të të nxënit, mësuesi merr parasysh të gjitha aspektet kryesore të mësimdhënies dhe të mësuarit: struktura e përmbajtjes dhe e objektivave të të mësuarit, nivelet fillestare të arritjes së nxënësve, të kuptuarit dhe aftësitë, shanset e të mësuarit, media dhe atmosfera e punës në klasë.

EQD/EDNJ, në thelb, organizohet si mësim me bazë detyre. Vëllimet II – VI përmbajnë shumë demostrime dhe përshkrime të të mësuarit me bazë detyre, të integruar në katër mësim rradhazi, për të lejuar planifikim më realist të saj. Të mësuarit me bazë detyre ndahet në tre kategori bazë: simulimi i realitetit, eksplorimi i realitetit dhe prodhimi. Tabela e mëposhtme përmban shembuj për këto kategori.

Të mësuarit në bazë detyre		
Simulatimi i realitetit në klasë	Eksplorimi dhe ndërmarrja e veprimeve në situatat e jetës reale	Produkti
Lojë me role	Intervistë me një ekspert	Prezantim
Lojëra për vendimmarrje	Intervistë në rrugë	Fletë pune
Statujat që luajnë	Pyetësor dhe kërkim	Poster
Konferenca	Profesion	Qarkore
Biseda televizive	Kërkim pune	Gazetë muri
Debate	Studim raste	Video ose pjesëz muzikore
Seanca dëgjimore Panel	Të marrësh pjesë në qeverinë e shkollës Të marrësh pjesë në planifikimin e mësimit	Internet site Prezantim Raport: të rejat e javës Ekspozitë Portfofol
Trajnimi i aftësive		

7.4 Të mësuarit në bazë të detyrës është të mësuar në bazë problemi

Përvoja ka treguar se nxënësit vlerësojnë shumë lirinë që ata gëzojnë në mjedise të tilla dhe besimin që mësuesi ka tek ta në përdorimin me efektshmëri të kohës. Nxënësit mësojnë të marrin përsipër përgjegjësi vetëm nëse atyre u jepet dhe liria për këtë qëllim. Rreziku i dështimit është gjithmonë i pranishëm, por pa rreziqe nuk ka progres. Mund të ndodhë që nxënësit të arrijnë rezultate që nuk përputhen me shpresat e mësuesit, por mësuesi fiton ide të vlefshme për zhvillimin e nivelit të kompetencës së nxënësit dhe nevojat për të mësuarit e tyre në të ardhmen. Procesi i të mësuarit është po aq i rëndësishëm sa rezultati i tij.

Në të mësuarit në bazë detyre, nxënësit përballen me probleme, jo vetëm me ato që lidhen me përmbajtjen dhe lëndën, por edhe me organizimin e punës së tyre. Ata duhet të njihen me to, për të gjetur edhe zgjidhjet personale. Në sajë të sfidës për të zgjidhur probleme, çdo formë e të mësuarit me bazë detyre, ofron mundësi të pasura për formimin e aftësive, për shembull, për menaxhimin e kohës, për planifikimin e punës, për të bashkëpunuar në grup, për të siguruar materiale dhe përzgjedhur informacione, për të gjetur dhe për të përdorur vegla të ndryshme etj. Të mësuarit në bazë detyre është fleksibël, pasi nxënësi mund të përshtasë detyrën në përputhje me aftësitë e tij.

7.5 Roli i mësuesit në fazat e të mësuarit me bazë detyre

Të mësuarit në bazë detyre të afrohet me jetën e të rriturit; ne të gjithë duhet të përballojmë problemet dhe detyrat vetë, pa praninë e një mësuesi ose trajneri. Mësuesi duhet të kujdeset të mos cënojë shanset e mëdha të të mësuarit, duke ndërhyrë para kohe ose më tepër se duhet. Në këtë lloj të mësuarit, mësuesi luan më shumë rolin e trajnerit se sa atë tradicional, të lektorit ose të mbikëqyrësit.

- Mësuesi vëzhgon si nxënësit menaxhojnë zgjidhjen e problemeve me të cilat ndeshen dhe nuk duhet të dorëzohet që me kërkesat e para të tyre për t'u treguar zgjidhjen. Nëse e shoh të nevojshme, mësuesi mund t'u japë atyre sugjerime për të lehtësuar detyrën, pa harruar që nxënësit duhet të "vuajnë" disi për zgjidhjen, siç do të vuajnë në jetën e tyre reale.
- Mësuesi vëzhgon nxënësit në punë, me dy skenare vlerësimi në mendje: procesi i të mësuarit dhe arritjet në punë.²² Nxënësit në punë dorëzojnë materialet e papërpunuara për vlerësimin e nevojave të të mësuarit. Ndërsa nxënësit punojnë, mësuesi ndërmerr hapat e para për planifikimin e mësimave të ardhshme të EQD/EDNJ.
- Mësuesi mund të ofrojë veten "për t'u përdorur" si burim informacioni me kërkesën e nxënësve, kur bëhet fjalë për shembull, për një pyetje që kërkon përgjigje të shpejtë. Në këtë rast, rolet përmbysen – nxënësit vendosin kur dhe për çfarë kërkohet ndërhyrjen e mësuesit të tyre.

7.6 Të mësuarit ndërveprues kërkon vazhdimësi

Të mësuarit në bazë detyre duhet të përfshijë procesin e reflektimit. Ai mund të kërkojë përmbledhje të shpejtë, për shembull, nëse nxënësit, pas një loje me role, shfaqin ndjenja të forta gëzimi, zhgënjimi, inati etj.

Në një seancë plenare të drejtuar nga mësuesi, nxënësit shkëmbejnë idetë dhe reflektojnë për veprimtarinë e tyre. Çfarë kemi mësuar? Si mësuam? Për çfarë qëllimi po mësojmë? Pa këtë reflektim, të mësuarit në bazë detyre është thjesht një veprim, vlera e të cilin nuk del jashtë vetes. Nga pikëpamja e të mësuarit konstruktivist, reflektimi është koha që i kushtohet analizës abstrakte e sistematike dhe gjykimeve. Mësuesi jep udhëzimet, konceptet, informacionin shtesë, konteksti i të cilit ofrohet nga vetë veprimtaria e të mësuarit në bazë detyre.

22. Shih Pjesa 2, Njësia 5, Fletë pune 3: Këndvështrime dhe forma të vlerësimit, në këtë vëllim.

8. Shkollim i bazuar në të drejtat e njeriut²³

Edukimi i të drejtave të njeriut, që përqendrohet kryesisht në mësimdhënien dhe të mësuarit, mund të shihet edhe si pjesë e metodës së shkollimit të bazuar në të drejtat e njeriut. Një metodë e tillë vë theksin në kulturën, politikat dhe praktikën e përgjithshme të shkollës, të para në këndvështrimin e vlerave të të drejtave të njeriut.

Konventa e të drejtave të fëmijës përmend arsimin në dy nene. Neni 28 përcakton arsimin si e drejtë dhe neni 29 komenton që arsimit duhet të ndihmojë fëmijën në zhvillimin e plotë të personalitetit, talentit dhe të aftësive të tij mendore dhe fizike. Sipas Konventës së fëmijës, një qëllim tjetër i shkollës është kuptimi dhe zhvillimi i të drejtave të njeriut dhe i lirive themelore. Ajo që ne dimë është fakti që: për të kuptuar si duhet dhe për të zhvilluar të drejtat e njeriut ne duhet t'i jetojmë ato në marrëdhënie me të tjerët.

Vlerat themelore të “dinjitetit, respektit dhe përgjegjësisë” duhet të jenë forca shtytëse e shkollës. Kjo do të thotë që, shkolla jo vetëm duhet të njohë nxënësit me vlerat e të drejtave të njeriut dhe me përmbajtjen e tyre në klasë, por ajo duhet të shkojë më tej. Kuadri i të drejtave të njeriut duhet të krijojë një shkollë me në qendër nxënësin, në të cilën këto vlera qëndrojnë në themel të mënyrës se si nxënësit mësojnë, si trajtohen nga mësuesit dhe si trajtojnë njeri-tjetrin dhe si ata do të fitojnë vendin që u takon në botën e sotme, duke qenë bartës edhe të misionit të nxitësit dhe çuarjes më tej të drejtësisë shoqërore, një rend i lartë, pa dyshim, por një rend që ka vendosur të drejtat e njeriut në ballë dhe në qendër të shkollës.

Mësuesit mund të sjellin të drejtat e njeriut në klasë përmes shembujve, pyetjeve dhe diskutimeve të gjalla, mendimit kritik dhe reflektimit, punës së bazuar në projekte dhe në vizita edukative në terren. Mësuesit sfidohen jo vetëm në fushën e të mësuarit të përmbajtjes së të drejtave të njeriut, por edhe si ta paraqesin atë, në mënyrë që të ketë kuptim për nxënësit dhe t'i shërbejë aftësimin të tyre. Një ndër sfidat më të rëndësishme për mësuesit është jo vetëm të lehtësojnë të kuptuarit e të drejtave të njeriut, por t'i bëjnë nxënësit të bien në dashuri me idenë e tyre.

Metoda e shkollimit që bazohet në të drejtat e njeriut qëndron në dëshirën e saj për të përfshirë tiparet e mëposhtme, të cilat mund të veçohen si qendrore ndër metodat në bazë shkolle të edukimit të të drejtave të njeriut në përgjithësi. Këto tipare janë pjesë e një dokumenti të zhvilluar nga UNICEF.²⁴ Kjo metodë:

- Pranon të drejtat e çdo fëmije.
- E shikon fëmijën në një kontekst të gjerë. Stafit është i shqetësuar për çfarë u ka ndodhur fëmijëve përpara se të hyjnë në sistemin shkollor (për shembull, nga pikëpamja e shëndetit), si dhe për atë që i ndodh ose mund t'i ndodhë pasi kthehen në shtëpi.
- Ka në qendër fëmijën. Kjo do të thotë që theksi vihet në mirëqënien psiko-sociale të fëmijës.
- Është e ndjeshme ndaj barazisë gjinore dhe miqësore ndaj femrave. Stafit është i përqëndruar për të pakësuar kufizimet ndaj barazisë gjinore dhe stereotipat gjinore, si dhe duke nxitur arritjet si të vajzave ashtu edhe të djemve.
- Nxit objektiva cilësorë të mësuarit. Nxënësit nxiten të mendojnë në mënyrë kritike, të bëjnë pyetje, të shprehin mendimin e tyre dhe të përvetësojnë aftësitë bazë.
- Siguron arsim të bazuar në jetën reale të fëmijëve. Nxënësit kanë individualitete dhe përvoja paraprake të veçanta të lidhura me sistemin arsimor, me komunitetin dhe familjet, të cilat mund të merren parasysh nga mësuesi për të zhvilluar të mësuarit dhe zhvillimin e fëmijëve.
- Vepron për të siguruar përfshirjen dhe barazinë e shanseve për të gjithë fëmijët. Stereotipat, përjashtimet dhe diskriminimi nuk tolerohen.
- Nxit të drejtat dhe përgjegjësitë e nxënësve në mjedisin shkollor si dhe aktivitetin brenda komunitetit.
- Rrit aftësitë e mësuesit, statusin dhe përkushtimin moral, duke siguruar që mësuesit të kenë trajnimin, certifikimin dhe shpërblimin e duhur.

23. Author: Felisa Tibbitts (2009). Burimi Original: Tibbitts F. (2005), “Çdo të thotë qasje me bazë shkolle për të drejtat e njeriut dhe qasje me bazë të drejtat e njeriut për shkollim” në Amnesty International USA, *Article 26 Newsletter*, Gusht.

24. Manuali shkolla miqësore për fëmijët, Programi Division/Education, UNICEF, www.friendly_Schools_Manual_EN_040809.pdf. Accessed on 23 September 2010.

- Përqendrohet te familja. Stafit mësimor bën përpjekje për të punuar dhe për fuqizuar familjet, për të ndihmuar fëmijët, prindërit dhe mësuesit në vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit.

Këto parime shërbejnë si një kuadër konceptual të cilin mësuesi mund ta zbatojë në shkollën e tij. Ato mund të shërbejnë edhe si kritere të cilat mund t'i përdorim për të vlerësuar një praktikë të veçantë në shkollë. A e vendos politika për disiplinën nxënësive në qendër? A zhvillon ajo të drejtat dhe përgjegjësitë e nxënësve? A ekzistojnë shanse të mjaftueshme për pjesëmarrjen e nxënësve në shkollë? A ka rëndësi kjo pjesëmarrje për nxënësit? Këto parime mund të drejtojnë shkollën në një përfshirje më të madhe për shkrimin e vlerave të të drejtave të njeriut në dimensionet e ndryshme të jetës shkollore: të mësuarit, menaxhimi dhe zhvillimi i shkollës, politikat e shkollës dhe të komunitetit.

Ne mund të pranojmë që të drejtat e njeriut në shkollë nuk kanë të bëjnë vetëm me atë që zhvillohet në klasë, por ato janë një mënyrë e jetës së shkollës. Kjo nuk duhet të burojë vetëm nga dëshira e mië e një numri të vogël mësuesish, por duhet të jetë angazhim i liderit dhe i masës së madhe të mësuesve në shkollë. Si duket, kjo ende është larg së qeni realitet, megjithëse treguesit e derisotëm janë premtues.

Nisma “të Drejtat, Respekti, Përgjegjësia” e Këshillit të Kontesë Hampshire (Hampshire) në Mbretërinë e Bashkuar është gjithëpërfshirëse dhe bazohet në Konventën e të Drejtave të Fëmijës.²⁵ Parimet e saj universale theksojnë nevojën për të mbrojtur të drejtat e të gjithë fëmijëve, për të ndihmuar fëmijët të kuptojnë përgjegjësitë e tyre dhe për të ofruar një kuadër për mësimdhënien dhe të mësuarit. Këto parime përdoren për të zhvilluar praktikën e qytetarisë demokratike dhe respektin për të drejtat e njeriut tek të gjithë anëtarët e komunitetit të shkollës. Me qindra shkolla fillore, rreth 50 shkolla të mesme dhe disa shkolla të arsimit të veçantë kanë marrë pjesë aktive në programin e kësaj nisme. Tiparet kryesore të të kësaj praktike janë:

- Konventa për të Drejtat e Fëmijës mësohet si një përmbajtje njohurish dhe si një kuadër për krijimin e kulturës së shkollës, të mësimdhënies dhe të mësuarit.
- Fëmijët dhe të rinjtë trajtohen si qytetarë
- Nxiti identitetin dhe vetvlerësimin në mënyrë të tillë që fëmijët të vlerësojnë veten si bartës të të drejtave, njëlloj si të rriturit.
- Këndvështrimi i të drejtave të njeriut bëhet pjesë integrale e lëndëve të tilla si letërsia, matematika, shkenca dhe historia, dhe gjuha e bazuar në të drejtat zhvillohet përmes punës sistematike të mësuesve.
- Si rrjedhojë e kësaj praktike, në shkollë përdoren më shumë metoda demokratike të mësimdhënies dhe të mësuarit (të cilat vënë theksin te pjesëmarrja dhe të drejtat)
- Karta e klasës për të drejtat dhe përgjegjësitë firmoset nga nxënësit dhe mësuesit.

Shkollat raportojnë që kjo nismë vepron si kuadër model edhe për punën e tyre qytetare (për shembull, shkolla të shëndetshme, edukimi i marrëdhënieve ndërmjet të rinjve, edukimi kundër drogës, letërsia artistike, këshillat e shkollës), të cilat mund të lidhen me nenet e Konventës për të Drejtat e Fëmijës. Anëtarët e komunitetit të shkollës vlerësojnë faktin që mund të përdorin një autoritet më të lartë (standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut) si bazë për vlerat e shkollës së tyre dhe kodin e sjelljes në të.

Vlerësimi i jashtëm tri vjeçar që përfundoi në vitin 2008 dëshmon për ndikim të konsiderueshëm të kësaj nisme në mjediset ku u zbatuar plotësisht. Ky ndikim përfshin rezultatet positive në rritjen e vetëdijes së nxënësve për të drejtat e tyre, për respektin për të tjerët dhe shkallën e pjesëmarrjes dhe të përfshirjes në shkollë. Mësuesit raportojnë më pak stres dhe më shumë kënaqësi nga procesi mësimor në klasat e tyre. Pra, metoda e bazuar në të drejtat e njeriut rrit dinjitetin njerëzor të anëtarëve të komunitetit dhe aftësinë e shkollave në përmbushjen e misionit të saj akademik-përfshirja e suksesshme e nxënësve në arsimimin e tyre.

25. Këshilli i Kontesë Hampshire (2009), “Të drejtat, Respekti, Përgjegjësia: Një metodë gjithëpërfshirëse me bazë shkolle” në Edukimin e të Drejtave të Njeriut në Sistemet Arsimore të Europës, Azisë Qendrore dhe Amerikës së Veriut: Një përmbledhje e praktikave të mira, ORganizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë, VArshavë, faqe. 72-74.

Njësia 4

Edukimi për Qytetari Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut -

Një histori e shkurtër e metodës së Këshillit të Europës

1. Tablo e përgjithshme

Këshilli i Europës, si organizata më e vjetër evropiane u themelua në vitin 1949, si rrjedhojë e Luftës së II Botërore. Qëllimi i saj kryesor është të mbrojë dhe të zhvillojë të drejtat e njeriut, të demokracisë dhe shtetit të së drejtës në Europë. Këshilli i Europës është aktiv në shumë fusha, duke përfshirë këtu edhe fushën e arsimit dhe të kulturës.

Për më shumë se 50 vjet, ai ka zbatuar një numër të madh projektesh bashkëpunimi për të zhvilluar kulturën e demokracisë dhe të të drejtave të njeriut në të gjithë Europën.

Në fillim të viteve 90', si rrjedhojë e proceseve demokratike në vendet e Eurpoës Lindore, Këshilli i Europës iu nënshtrua ndryshimeve të rëndësishme: numri i anëtarëve të organizatës u dyfishua në një periudhë 10 vjeçare. Këto kohë ndryshimi kishin nevojë për më shumë punë sistematike për të mësuarit e demokracisë. Në vitin 1997, Kryetarët e shteteve dhe të qeverive të Këshillit të Europës nisën një projekt të ri, Edukimi për Qytetarinë Demokratike (EQD). Që nga ajo kohë, ky projekt është rritur në përmasa të mëdha, duke fituar edhe një dimension të ri, atë të drejtave të njeriut. Sot projekti quhet "Projekti i Edukimit për Qytetari Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut (EQD/EDNJ)

Me anë të këtij projekti, qeveritë e shteteve Evropiane pranojnë se njerëzit nuk kanë lindur me aftësitë e qytetarit demokrat dhe për këtë arsye ata duhet të mësojnë si të bëhen të tillë. Në fund të shek. 20-të, shoqëritë evropiane filluan të përballen me probleme të tilla, si apatia politike, lëvizjet massive migratore që çuan në rritjen e diversitetit social, në rritjen e rreziqeve mjedisore dhe të dhunës. EQD/EDNJ u vlerësua i rëndësishëm për zgjidhjen e problemeve të tilla. Ai ka të bëjë me nxitjen e pjesëmarrjes konkrete në jetën publike gjatë gjithë jetës, me përgjegjësinë, solidaritetin, respektin e ndërsjellë dhe dialogun. Ekspertët më të mirë të fushës, nga e gjithë Europa, janë mbledhur rregullisht në 13 vitet e fundit për të punuar në këtë drejtim.

2. Rezultatet e projektit të EQD/EDNJ

Vitet e para të projektit iu kushtuan përcaktimit të koncepteve kryesore. Disa prej publikimeve të këtyre viteve trajtojnë çështjet e nevojës së një strategjie dhe të aftësive për ushtrimin e qytetarisë demokratike. Në vitin 2002, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës miratoi Rekomandimet për Edukimi për Qytetari Demokratike (Recommendation Rec(2002)12). Ky ishte dokumenti i parë që i kushtojë kësaj çështjeje në nivel evropian (Dokumenti i dytë madhor është Karta e Këshillit të Europës për Edukimi për Qytetari Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut,²⁶²⁷ shih më poshtë). Ai përcakton që EQD duhet të bëhet "objektiv parësor i politikë bërjes dhe i reformave në arsim".²⁸

Në vitin 2002 u ngrit rrjeti i koordinatorëve të EQD/EDNJ, i përbërë nga përfaqësues të shteteve anëtare, i cili kishte si qëllim të lehtësonte procesin e shkëmbimit dhe të bashkëpunimit ndërmjet shteteve anëtare në këtë fushë. Ky rrjet është shndërruar në një vlerë të pallogaritshme për nxitjen dhe zhvillimin e EQD/EDNJ. Në rajone të veçanta të Europës u zbatuan projekte rajonale, si për shembull, në Europën Juglindore. Viti 2005 u shpall Viti European i Qytetarisë përmes Arsimit me parullën "Të

26. Nga Olaf Olafsdottir, Drejtore ekzekutive e Drejtorisë së Edukimit dhe Gjuhëve, e KE

27. Karta e KE për EQD/EDNJ e miratuar në kuadrin e Rekomandimit (CM/Rec (2010)7 të Komitetit të Ministrave.

28. Rekomandimi Rec (2002)12, Komiteti i Ministrave i KE drejtuar shteteve anëtare për edukimi për qytetari.

mësojnë dhe të jetojnë Demokracinë”. Viti 2005 shërbeu si një ngjarje e veçantë për rritjen e vetëdijes në shtetet anëtare për EQD/EDNJ. Në një mënyrë ose në një tjetër, pothuajse të gjitha shtetet anëtare morën pjesë në “Vitin” e qytetarisë dhe vlerësimi i bërë nga partnerë të shumtë për të përbërë një përvojë shumë pozitive në këtë fushë.

Megjithatë, që në fillim ishte e qartë se ta bësh realisht edukimin për qytetari demokratike dhe edukimin për të drejtat e njeriut përparësinë më të lartë të politikave arsimore në shtetet anëtare nuk detyrë e thjeshtë, megjithë përvojat e ndryshme që ekzistojnë në secilin prej tyre në këtë drejtim.

Ta bësh EQD/EDNJ një objektiv themelor të sistemit arsimor kërkon një filozofi të re, si nga pikëpamja e metodologjisë, ashtu edhe nga pikëpamja e punës organizative. Studimet e kryera në kuadrin e këtij projekti, duke përfshirë këtu edhe “*Studimin mbarë Europian për politikën e EQD*”,²⁹ shtrojnë nevojën për përgatitjen e dokumenteve dhe instrumenteve praktikë, që do të shërbejnë për ngushtuar hendekun ndërmjet politikës dhe praktikës. Për këtë arsye, përgatitja e dokumenteve dhe e instrumenteve të tillë, shkëmbimi i praktikave të mira dhe rritja e bashkëpunimit, ndërmjet dhe brenda vetë shteteve anëtare, u bënë përparësi të projektit për vitet 2006-2009. Këto përparësi përcaktuan edhe tri fusha kryesore pune: zhvillimi i politikës, trajnimi i profesionistëve në arsim dhe qeverisja demokratike e institucioneve arsimore. Për të gjitha fushat, Këshilli i Europës zhvilloi instrumente praktike siç janë edhe këto manuale për mësuesit.

Puna e shumë viteve, kulmoi në maj të vitit 2010, me miratimin e Kartës së Këshillit të Europës për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe Edukimin për të Drejtat e Njeriut, në kuadrin e Rekomandimit (CM/Rec(2010)7 të Komitetit të Ministrave të të gjithë 47shteteve anëtare të Këshillit të Europës). Ky dokument kuadër politik do të jetë një pikë e rëndësishme referimi për të gjithë Europën dhe do të përdoret si bazë për punën e ardhshme të Këshillit të Europës në këtë fushë.

29. Birzea et al. (2004), Studimi mbarë europian për politikën e EQD, Botimi i KE, Strasbourg.

3. Instrumente praktikë

3.1 Paketa e EQD/EDNJ

Instrumentet e ndryshme të përgatitura nga Këshilli i Europës përmbajnë informacion të rëndësishëm për aspekte të ndryshme që lidhen me integrimin e EQD/EDNJ në sistemet arsimore. Ndër këto instrumente, më i rëndësishmi është ai që quhet “Paketa EQD/EDNJ”, e cila përmban:

- Instrumenti 1: Instrumenti Politik për EQD/EDNJ: mbështetje strategjike për vendimmarrësit;
- Instrumenti 2: Qeverisja demokratike e shkollës;
- Instrumenti 3: Si mund të mbështesin të gjithë mësuesit edukimin qytetar dhe edukimin e të drejtave të njeriut: kuadër për zhvillimin e kompetencave;
- Instrumenti 4: Sigurimi i cilësisë së edukimit për qytetari demokratike në shkollë;
- Instrumenti 5: Partneriteti komunitet shkollor-universitet, për një demokraci të qendrueshme: Edukimi për Qytetari Demokratike në Europë dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Këto instrumente janë zhvilluar nga ekspertë nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës, në bazë të vërejtjeve dhe komenteve të marra nga grupe të ndryshme, duke përfshirë këtu edhe koordinatoret kombëtarë të EQD/EDNJ. Materiale të tjera plotësuese, përveç kësaj pakete, mund të gjenden në uebsait-in e Këshillit të Europës (www.coe.int/edc).

Këto instrumente praktikë të përgatitura nga Këshilli i Europës në fushën e EQD/EDNJ janë instrumente të përgjithshme. Kjo do të thotë që ato mund të kenë nevojë për t'u përshtatur dhe për t'u përdorur në varësi të nevojave të çdo vendi.

3.2. Gjashtë vëllimet e EQD/EDNJ në projekte shkollore, njësi mësimore, koncepte, metoda dhe modele

Në shumë vende, mësuesit kanë nevojë për ndihmë në zbatimin e EQD/EDNJ. Kjo është arsyeja përse Këshilli i Europës vazhdimisht harton manuale për mësuesit për edukimit qytetar dhe të të drejtave të njeriut.

Vëllimi II:

Njësi mësimore për edukimin qytetar për arsimin bazë.

Vëllimi III:

*Jetojmë në demokraci
Mësime të EQD/EDNJ për ciklin e lartë të arsimit bazë*

Vëllimi V:

Të explorojmë të drejtat e fëmijëve. Nëntë projekte të shkurtër për arsimin bazë



Vëllimi I: Edukimi për demokraci: Materiale mbështetëse për edukimi për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut për edukimin e mësues

Vëllimi VI : **Mësimdhënia e demokracisë:** Përmbledhje modelesh për edukimi për demokraci dhe të drejtat e njeriut

Vëllimi IV : Të marrim pjesë në demokraci: Njësi mësimore për ciklin e lartë të arsimit të detyruar

*Vëllimet janë botuar në partneritet me Universitetin e Edukimit të Mësuesve të Zurich-ut, Projekte Ndërkombëtare në Arsim. Agjencia zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim mbështeti financiarisht së bashku me Këshillin e Europës botimin e manualeve. Ky libër, Vëllimi I, Edukimi për Demokraci – *Materiale mbështetëse për mësuesit*, është i pari në serinë e gjashtë vëllimeve. Në faqen parardhëse gjëndet një pamje e përgjithshme e të gjashtë vëllimeve dhe e grupeve për të cilat ato janë përgatitur. Manualët përmbajnë njësi mësimore për të gjitha nivelet e shkollimit dhe kanë si qëllim nxitjen dhe zhvillimin e qytetarisë aktive, të bazuar në të mësuarit që ka në bazë pjesëmarrjen dhe detyrën. Karakteristikë e këtyre manualeve është se ata janë produkt i një projekti Europian. Ideja dhe version i parë i tyre u zhvillua nga nga mësuesit e Bosnje- Herzegovinë, të cilët morën vetë pjesë në përgatitjen e manualeve. Autorët dhe redaktorët përgjegjës për variantin e fundit janë nga vende të ndryshme të Europës. Manualët janë testuar dhe rishikuar nga një numër i madh specialistësh me prejardhje të ndryshme kulturore. Në shpresojmë që ato të jenë të dobishëm për mësuesit dhe nxënësit në të gjithë Europën.*

Pjesa e dytë

Mësimdhënia e demokracisë

dhe e të drejtave të njeriut

Njësia 1

Kushtet e mësimdhënies dhe të mësuarit

Njësia 2

Vendosja e objektivave dhe përzgjedhja e materialeve mësimore .

Njësia 3

Të kuptojmë politikat

Njësia 4

Drejtimi i procesit të të mësuarit dhe përzgjedhja e formave të mësimdhënies

Njësia 5

Vlerësimi i nxënësve, mësuesve dhe shkollave

Njësia 1

Kushtet e mësimdhënies dhe të mësuarit

1. Hyrje

Gjatë planifikimit të mësimit, mësuesi duhet të ketë të qartë paraprakisht karakteristikat e të mësuarit dhe të mjedisit në të cilin ai zhvillohet, në klasë ose ndërmjet nxënësve si individë. Për mësuesin është e rëndësishme që nxënësit të kuptohen me të gjitha ndryshimet që i karakterizojnë: larmia e aftësive dhe e shkathtësive, pikat e forta dhe të dobëta, besimet, qëndrimet dhe interesat.

Nga njëra anë, mësuesi duhet të qartësojë kushtet e të mësuarit në klasë nga pikëpamja e objektivave të mësimdhënies që ai ka në mendje. Nga ana tjetër, gjatë përzgjedhjes së objektivave dhe temave, mësuesi duhet të bazohet në njohuritë e tij në lidhje me karakteristikat e nxënësve të veçantë dhe ato të klasës në tërësi.

Duke identifikuar kushtet e të mësuarit, mësuesi ka përmbushur pjesën e parë të qartësimeve paraprake. Në planifikimin e tij të mëtejshëm, mësuesi duhet të marrë parasysh kushtet e përgjithshme në të cilat do të zhvillohet procesi i mësimdhënies. Së fundi, ai nuk duhet të harrojë aftësitë e tij të mësimdhënies; kjo shërben për të siguruar përdorimin e tyre të efektshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm në mënyrë graduale, pa krijuar mbingarkesa në punën e tij të përditshme.

Në fillim të kësaj njësie, do të gjeni pyetjet kryesore, të shoqëruara nga fletët e punës, që ju mund t'i përdorni sa herë të keni nevojë.

2. Detyrat dhe pyetjet kryesore për kushtet e mësimdhënies dhe të nxënësve.

2.1 Detyra

Në fillim të kësaj njësie ndodhen pyetjet kryesore. Pyetjet në vijim shërbejnë për vetëkontroll dhe ofrojnë një pamje më të detajuar të aspekteve të ndryshme të kushteve të të mësuarit.

2.2 Pyetjet kryesore

- Cilat janë njohuritë dhe aftësitë paraprake të nxënësve?
- Cilat janë njohuritë dhe aftësitë e mia paraprake?
- Cilat janë kushtet e jashtme për të cilat unë duhet të kem dijeni?
- Cilat janë njohuritë e mia për nxënësit si individë?
- Cilat janë elementet e njohurive dhe të informacionit që duhet të zotërojnë nxënësit, që shërbejnë për t'i aftësuar ata për detyrat e ardhshme?
- Cilat janë informacionet, aftësitë dhe përvojat paraprake, në lidhje me lëndën e re mësimore, që zotërojnë nxënësit? Çfarë është e re për ta, çfarë është përsëritje, çfarë është thelbësore dhe çfarë është plotësuese?
- Cilat janë teknikat e punës dhe të mësuarit që unë pres të zotërohen nga nxënësit dhe cilat janë përvojat e tyre në fushën e metodave të ndryshme të mësimdhënies dhe të ndërveprimit social?
- Cilat janë qëndrimet, zakonet, paragjykimet ose bindjet pozitive ose negative që unë mund ose shpresoj t'i ndesh në punën me nxënësit?
- Si t'i kapërcej vështirësitë e të mësuarit, pengesat e të mësuarit dhe rezistencën ndaj të mësuarit?

- A i kam marrë parasysh si duhet vullnetin e nxënësve për të mësuar, gjendjen e tyre emocionale, gatishmërinë, nevojat e të nxënësve, shpresat e tyre, interesat e tyre, kohën e lirë dhe kushtet e jetesës?

Kushtet e mësimdhënies dhe të të mësuarit

Fletë pune 1: Si të marr parasysh aftësitë dhe njohuritë e nxënësve?

- Çfarë di unë për klasën?
- Cilat janë karakteristikat e klasës që duhet të marr parasysh dhe për të cilat duhet të veproj?
- Si dëshiroj ose duhet të drejtoj klasën (komunikimi, sjellja shoqërore, marrëdhëniet problematike etj.)?
- Cila është klima e klasës (zhvillimet në grup, lidhjet miqësore, të huajt etj.)?
- Cilat janë marrëveshjet që duhet të bëhen në klasë (gjuha, detyrat, vendosja, rregullat e bashkëveprimit shoqëror, rastet e veçanta, ceremonitë dhe festat etj.)?
- Cili është numri i nxënësve në klasë dhe cila është struktura e saj (gjinia, larmia kulturore etj.)?

Kushtet e mësimdhënies dhe të të mësuarit

Fletë pune 2: Si të shfrytëzohet njohuritë dhe aftësitë e mia të mësimdhënies

- Çfarë përvoja, njohuri dhe aftësi të përgjithshme zotëroj unë si mësues?
- Në çfarë shkalle njohuritë e mia kanë nevojë të plotësohen, krahasuar me nevojat e përmbajtjes dhe lëndës, objektivave, metodave e përshtatshme të mësimdhënies dhe proceset e të mësuarit?
- Në cilat fusha unë dëshiroj të mësoj e të plotësoj veten (në fushën e njohurive, e metodave të mësimdhënies, të aftësive profesionale, të cilësive personale etj.)?
- Cilin prej koncepteve të natyrës njerëzore unë kam zgjedhur si udhëzuesin tim të përgjithshëm?
- Cili është kuadri teorik ose një variant i thjeshtuar i një teorie që udhëheq punën time si mësues?
- Si mund ta përshkruaj dhe përkufizoj marrëdhënien time me nxënësit?
- Cilat janë kufijtë e mi në lidhje me orët e punës, stresin etj. Si i shfrytëzohet unë aftësitë e mia personale për punë?
- Si të pakësoj ngarkesën time të punës me anë të një planifikimi më të mirë të saj dhe të veprimtarive të tjera?
- Si të përdor me efektshmëri kohën dhe si të merrem me burimet e stresit tim?

Kushtet e mësimdhënies dhe të të mësuarit

Fletë pune 3: Marrja parasysh e kushteve të përgjithshme të mësimdhënies dhe të mësuarit

- Si e vlerësoj unë kohën ditore, vjetore dhe kohën e harxhuar?
- Si është projektuar shkolla?
- Si është pajisur shkolla: sasia dhe larmia e klasave, media në dispozicion, materialet etj.?
- Cila është kuadri i kulturës së shkollës (projekte të përbashkëta për grupe nxënësish të moshave të ndryshme, punë në grup dhe detyrimet në grup, bashkëpunimi me prindërit, autoritetet ose ekspertët për fëmijët me nevoja të veçanta etj.)?

Kushtet e mësimdhënies dhe të të mësuarit

Fletë pune 4: Cilat janë qëndrimet e mia ndaj nxënësve?

- Empatia, përkushtimi (ndjeshmëria ndaj ndjenjave, mendimeve, pikëpamjeve, nevojave), pranimi, zemërgjerësia (vlerësimi personal nuk varet nga kushtet), sinqeriteti, qëndrueshmëria, besueshmëria.
- Lidhshipi në frymën e vlerësimit dhe respektit (përkushtimi emocional, arsyetim i bazuar në fakte, kontroll bindës, i mbështetur në njohuri, mbështetje e integritit social dhe demokracia)

Marrëdhëniet dhe komunikimi në klasë

- Të kuptuarit e ndërsjellë
- Marrëdhënie të ndërsjella
- Bashkë edukim jo diskriminues nga pikëpamja seksuale
- I hapur për të takuar njerëz të tjerë
- Miqësia
 - Komunikimi verbal dhe jo verbal
 - Pranimi i këndvështrimeve dhe pikëpamjeve të tjerëve
 - Perceptimi ndaj vetes dhe perceptimi nga të tjerët

Klima e parandalimit të konflikteve

- Komunitet i paanshëm dhe i kujdesshëm, komunitet nxënësish, përgjegjësi të përbashkëta (mësues dhe nxënës, meshkuj dhe femra).
- Bashkëpunim, jo konkurrin
 - Të mësuarit shoqëror
 - Rregulla dhe marrëveshje
 - Meta komunikim dhe meta ndërveprim
 - Kufizim dhe përforcim

Masa edukative

- Biseda për zgjidhje konflikti
- “Tryezë e rrumbullakët”
- Lojëra
- Bashkëveprimet si udhëheqje për ndryshimin e sjelljes personale
- Vlerësim mbështetës
- Përgjegjësi individuale
- Ndëshkim
- Trajtimi i ngacmimeve dhe i dhunës në klasë dhe shkollë.

Kushtet e mësimdhënies dhe të të mësuarit

Fletë pune 5: Të rishikojmë disiplinën dhe rregullin nga një pikapamje demokratike

- Rregulli është i domosdoshëm në të gjitha rrethanat. Një grup pa rregull dhe pa rregulla bazë nuk mund të jetë demokratik.
- Kufizimet janë të nevojshme. Rregulla mund të jenë të gabuara ose jo të përshtatshme, por për sa kohë nuk janë zëvendësuar, ato duhen zbatuar. Megjithatë, duhet të ekzistojë mundësia që ato të ndryshohen.
- Që në fillim, fëmijët duhet të marrin pjesë në vendosjen e rregullave dhe në detyrimin për t'i zbatuar ato. Vetëm në këtë mënyrë, do të jetë e mundur të identifikojnë veten me to.
- Një komunitet klase nuk mund të funksionojë pa besimin dhe respektin e ndërsjellë. Në disa raste, mund të jetë e vështirë të krijohet një klimë e tillë.
- Shpirti i ekipit duhet të zëvendësojë atë të konkurrencës.
- Klima miqësore është jetësore për klasën.
- Shprehjet sociale të mësuesit janë ndihmesë e rëndësishme për klimën e klasës (lidhshipi demokratik, zhvillimi i ndjenjës së përkatësisë në grup, ndërtimi i marrëdhënieve etj.)
- Komunikimi në grup është realitet i përhershëm i një klase të drejtuar në mënyrë demokratike.
- Nxënësit, si djemtë dhe vajzat, duhet të nxiten të eksplorojnë diçka të re dhe të mësojnë nga gabimet.
- Në klasë e në shkollë, brenda disa kufijve, duhet të ekzistojë mundësia për të ushtruar liritë. Vetëm në këtë mënyrë, do të mund të zhvillohet edhe përgjegjësia individuale.
- Disiplina dhe rregulli do të pranohen dhe do të zbatohen me vullnetin më të mirë, nëse ato do të ndihmojnë individin të shprehet lirisht dhe nëse ato mbështetin grupin në zhvillimin e marrëdhënieve dhe të kushteve të kënaqshme të punës.

Kushtet e mësimdhënies dhe të të mësuarit

Fletë pune 6: Rishikimi i rolit të mësuesit nga pikëpamja demokratike

Mësuesit duhet të drejtojnë dhe të shoqërojnë klasën. Kjo është detyra e tyre. Ata duhet të marrin vendime dhe të kontrollojnë gjithçka. Ajo çfarë mësuesit nuk duhet të bëjnë, është të kontrollojnë edhe procesin e të menduarit dhe të zhvillimit personal të nxënësve të tyre. Në mënyrë të veçantë, në EQD/EDNJ, mësuesi bëhet model për nxënësit e tij. Si i trajton ai konfliktet? Cilat janë idetë që ai nxit dhe mbështet? Lista e mëposhtme ndihmon secilin për të përcaktuar pozicionin e vet në lidhje me pyetjet e mësipërme. Megjithatë, nuk duhet harruar që ky pozicionim varet edhe nga faktorë të tillë si: situata e të mësuarit, gjendja personale, prania e rrezikut, krijimi i grupeve të nxënësve etj., të cilët mund të justifikojnë të qenit e mësuesit më shumë autokratik ose më shumë demokrat. Në përgjithësi, duhet mbajtur parasysh fakti që: ideja ime si mësues për një person do të ndikojë në punën time të përditshme me nxënësit.

Situata e të nxënët						
Më shumë autokratik	Unë					Më shumë demokratik
Sundues						Lider
Zë i mprehtë						Zë miqësor
Rregull						Ftesë, kërkesë
Pushtet						Ndikim
Presion						Sugjerim
Kërkesë për zbatim						Fitore për bashkëpunim
Imponim detyrash						Dhënie idesh
Sundon kritikizmi						Nxitje e shpeshtë
Ndëshkim i shpeshtë						Mbështetje e shpeshtë
Dëgjo mua						Le të bisedojmë
Unë vendos, t'i bindu						Unë propozoj dhe të ndihmoj ty të...
Vetëm përgjegjësi e grupit						Përgjegjësi e përbashkët me dhe në grup

Kushtet e mësimdhënies dhe të të mësuarit
Fletë pune 7: Si të zhvilloj klimën demokratike në klasë?

Organizimi i klasës në mënyrë më demokratike lidhet me një qëllim të madh
 Tabela e mëposhtme tregon hapat që mund të ndërmerren për këtë qëllim:

1. Cili është pozicioni im në çdo aspekt?
2. Cilin prej aspekteve do të zgjedh për nesër, për pasnesër, për javën tjetër, për vitin tjetër?
3. Si duhet të veproj, si mësues, për të bërë të mundur që shkolla ime të përfitojë nga progresi në të mësuar?

Objektiva afatshkurtër	Objektiva afatmesëm	Objektiva afatgjatë
Mësuesi pakëson përdorimin e shprehjeve të skajshme autoritariste	Mësuesi zhvillon përdorimin e zakonshëm të shprehjeve të ndryshueshme	Mirëkuptim i ndërsjellë ndërmjet nxënësve dhe mësuesit
Mësuesi shpjegon përzgjedhjen e lëndës dhe të materialeve mësimore	Mësuesi ofron tema dhe material alternative	Planifikim në bashkëpunim i mësimit nga nxënësit dhe mësuesi
Mësuesi u shpjegon nxënësve objektivat e të mësuarit	Mësuesi paraqet objektiva alternativë të mësuarit	Përzgjedhje në bashkëpunim i objektivave të të mësuarit nga nxënësit dhe mësuesi
Mësuesi shpjegon arsyen e përzgjedhjes së metodave të mësimdhënies	Mësuesi paraqet metoda alternative të mësimdhënies	Vendimmarrje e përbashkët për metodat e mësimdhënies nga nxënësit dhe mësuesi
Mësuesi shpjegon arsyen e vendosjes së notave për arritjet e nxënësve	Mësuesi shpjegon problemet e vendosjes së notave	Vetëvlerësim nga nxënësit
Njohje me mënyrat demokratike të zgjidhjes së konflikteve	Mësuesi pushon së përdoruri në mënyrë autoritariste pushtetin për të zgjidhur konfliktet	Zgjidhje konflikti me anë të bashkëpunimit dhe komunikimit
Mësuesi shpjegon parimet e organizimit të punës në klasë	Sugjerimet e nxënësve për organizimin e punës në klasë merren parasysh	Nxënësit marrin pjesë në vendimet për organizimin e punës në klasë

Kushtet e mësimdhënies dhe të të mësuarit

Fletë pune 8: Si të zhvillojmë shkollën si një komunitet demokratik

EQD/EDNJ dhe rruga për krijimin e një klime demokratike nuk duhet të realizohet vetëm në klasë. Ajo duhet të jetë objektiv i të gjithë shkollës. Në këtë drejtim, roli qendror i takon drejtorit të saj. Në materialet e KE për EQD/EDNJ, instrumenti “Qeverisja demokratike e shkollës” sugjeron katër fusha kryesore për të punuar dhe për të ndërmarrë hapat për kthimin e shkollës si një komunitet demokratik (shih Njësia 5 në këtë vëllim, fletët e punës 15-17).

Këto fusha janë:

1. Qeverisja, lidhshipi, menaxhimi i llogaridhënies publike
2. Arsimi me në qendër vlerat
3. Bashkëpunimi, komunikimi dhe përfshirja: konkurrenca dhe vetëvendosja
4. Disiplina e nxënësve

Qeverisja, lidhshipi, menaxhimi i llogaridhënies publike

Vendimmarrës të ndryshëm si ligjvënës, borde të shkollave lokale, organizata sindikale, nxënës, prindër si dhe komunitete lokale shtrojnë kërkesa për lidhshipin e shkollës. Si përmbushen këto nga drejtuesi i shkollës? Ç’lloj menaxhimi zbatohet në shkollën e tij? A ngrihet lidhshipi mbi konsensus dhe besim, apo karakterizohet nga mosbesimi dhe rivaliteti? Si shpërndahen përgjegjësitë në shkollë? Si trajtohet diversiteti nga drejtuesi i shkollës? Si jep llogari shkolla përpara vendimmarrësve dhe të interesuarve të tjerë?

Arsimi me në qendër vlerat

Si shprehen vlera të tilla si demokracia, të drejtat e njeriut dhe respekti për diversitetin në kontestin formal dhe informal të shkollës? Si nxiten dhe zhvillohen vlerat dhe aftësitë shoqërore, si kusht i domosdoshëm për bashkekzistencën paqësore në një shoqëri moderne globale? Në ç’mënyrë mendon shkolla për këto vlera?

Bashkëpunimi, komunikimi dhe përfshirja: konkurrenca dhe vetëvendosja

Shkolla nuk është e shkëputur nga pjesa tjetër e shoqërisë ose nga bota reale. Si komunikon shkolla brenda dhe me mjedisin e jashtëm? Si bashkëpunon shkolla brenda saj dhe me botën e jashtme? A ngjan shkolla me një kompani të izoluar, apo ajo ngjan me një derë që të lidh me pjesën tjetër të shoqërisë me anë të rrugëve dhe mënyrave të komunikimit dhe të përfshirjes. Sa e vendosur është shkolla për të zbatuar në praktikë objektivat e saj, gjatë komunikimit dhe hapjes me pjesën tjetër të shoqërisë?

Disiplina e nxënësve

Në shkollë punojnë shumë njerëz. Cilat janë forcat që duhet të përdoren në mënyrë që disiplina dhe rregulli të ruhen edhe në një shkollë të qeverisur në mënyrë demokratike? Çfarë i bën nxënësit të ndjekin rregullat e vendosura në shkollë dhe përse ndodh që, disa herë ata i kundërshtojnë ato? A nënkupton shkolla demokratike kaosin dhe mungesën e rregullave?

Njësia 2

Vendosja e objektivave dhe përzgjedhja e materialeve

1. Hyrje

Mësuesit, në mënyrë të përsëritur, përballen me problemin e justifikimit: cilat janë arsyet e zgjedhjeve të mia për objektivat dhe temat e mundshme? Identifikimi i një objektivi mësimor dhe përzgjedhja e temave nënkupton marrjen e një vendimi themelor në lidhje me mësimin. Objektivat nuk duhen thjesht të kopjohen ose të përshtaten, e as nuk duhet thjesht të imponohen në mënyrë dogmatike. Përkundrazi, ato duhen të merren pas një shqyrtimi serioz, dhe përzgjedhja duhet të bazohet në arsyetim dhe me justifikim të shëndoshë. Pas kësaj ju mund të bëni - ndoshta së bashku me nxënësit - një përzgjedhje të qëllimshme të temave dhe objektivave të mësimdhënies, të pasqyroni në vendimin tuaj një gamë të gjerë kontekstesh mësimore dhe identifikoni, në zgjedhjen tuaj, vlerën e tyre arsimore. Kjo detyrë është e një rëndësie të veçantë, sepse numri i temave të mundshme mësimore është i pafund, ndërsa koha në dispozicion për planifikimin dhe mësimdhënien është e kufizuar.

Pikat kryesore të mëposhtme kanë për qëllim t'ju udhëzojnë dhe t'ju ndihmojnë në këtë detyrë të ndërlikuar të përzgjedhjes dhe përgatitjes së temave për mësimdhënie.

2. Detyrat dhe çështjet kryesore për vendosjen e objektivave dhe përzgjedhjen e materialeve

2.1 Detyra

Mësuesit e përgjegjshëm në punën e tyre përballen në mënyrë të përsëritur me problemin e justifikimit: cilat janë arsyet për përzgjedhjen e objektivave dhe temave të mundshme?

Të përcaktosh një objektivi të mësimdhënies do të thotë të ndërmarrësh një nga vendimet më themelore që lidhen me të. Objektivat nuk duhen thjesht të kopjohen ose përshtaten, e as nuk duhet thjesht të imponohen në mënyrë dogmatike. Përkundrazi, ato duhet të shqyrtohen seriozisht dhe përzgjedhja e tyre duhet të bazohet në arsyetim dhe justifikim të shëndoshë. Për një mësues është e rëndësishme të lidhë objektivat mësimore me kushtet e të mësuarit të nxënësve dhe t'i përshtatë ato në përputhje me rrethanat (shih Njësia 1, Kushtet e Mësimdhënies dhe të Mësuarit).

Sapo objektivat janë bërë më konkrete, në to duhet të përfshihen aspekte të përmbajtjes. Ju nuk do të mund të përcaktoni objektivat tuaja të mësimdhënies deri sa të keni vendosur edhe nivelin e dëshiruar të arritjeve që lidhen me përmbajtjen, domethënë, temat që do të përfshihen.

Në procesin e planifikimit, puna në aspektet e përmbajtjes së mësimdhënies është i vështirë dhe kërkon kohë. Në shikim të parë, mund të duket se nevojiten vetëm pak përpjekje, meqenëse kurrikula përcakton udhëzime të qarta dhe disa media mësimore ofrojnë sugjerime të detajuara. Megjithatë, detyra kryesore është në dorë të mësuesit: ju duhet të jeni të mirinformuar në të gjithë fushën e dijes ku dëshironi të jepni mësim, ju duhet ta strukturoni, të merrni një kuptim të plotë të saj, ta analizoni tërësisht, ta vlerësoni në mënyrë kritike, të bëni zgjedhje të qëllimshme të temave dhe objektivave të mësimdhënies, të reflektoni vendimin tuaj në një gamë kontekstesh më të gjera, të identifikoni, në temat e përzgjedhura vlerën e tyre arsimore etj. Kjo detyrë është e një rëndësie thelbësore, sepse numri i temave të mundshme të mësimdhënies është i pafund, ndërsa koha në dispozicion për planifikimin dhe mësimdhënien është e kufizuar.

Çështjet e mëposhtme kryesore dhe ato që vijojnë e shërbejnë për vetëkontroll synojnë t'ju udhëheqin dhe t'ju ndihmojnë në këtë detyrë të ndërlikuar të zgjedhjes dhe përgatitjes së temave për mësimdhënie. Ne ju sugjerojmë të bashkëpunoni me mësuesit e tjerë dhe ndoshta edhe me nxënësit.

2.2 Çështjet kryesore

Për vendosjen e objektivave:

- Çfarë objektivash dëshiroj të arrij?

- Çfarë kompetencash do të jenë më të rëndësishme për t'u fituar në fund të njesisë?
- Çfarë arsyes mund të jap për përzgjedhjen e objektivave?
- Cilat janë prioritetet që u mbajtën parasysh për vendosjen e objektivave (objektivat parësore dhe ato jo parësore)?
- Cilat nga objektivat janë të rëndësishme tani - për klasën në tërësi dhe për nxënësit si individë, mashkull dhe /apo femër?
- A jam unë i sigurt se objektivat e përzgjedhur prej meje do t'u shërbejnë interesave dhe nevojave kryesore të nxënësve të mi?
- A i përgjigjen mësimet e mia me të vërtetë interesave dhe shqetësimeve të nxënësve?
- A është e mundur që nxënësit të marrin pjesë në përkufizimin ose përzgjedhjen e objektivave të të mësuarit?
- Sa kohë (orë dhe javë) i është caktuar arritjes së objektivave?
- Cilat objektivat duhet të arrihen nga të gjithë nxënësit brenda kohës së mësimin në dispozicion (standardi i përgjithshëm i arritjeve)?
- A duhet të përcaktohen nivele të veçanta arritjesh për nxënës të veçantë (arsimi sipas aftësisë individuale)?
- A i kam mundësuar unë nxënësve që të përparojnë nga njohuritë në veprime, domethënë, a mundën ata të zbatojnë me vetëbesim njohuritë që kanë fituar?
- Ku përqendrohem unë në mësimdhënien time – në kompetencën njohëse, personale ose sociale?
- A kam unë një ide të qartë për objektivat afatshkurtra dhe afatgjata, të cilat janë të një rëndësie parësore për klasën time, për grupet e të mësuarit, për nxënësit e veçantë si meshkuj dhe femra?
- A i kam deklaruar unë qartësisht dhe në mënyrë eksplicite objektivat?

Për përzgjedhjen e temave dhe materialeve:

- Cilat tema kam përzgjedhur?
- Cilat janë arsyet për zgjedhjen time?
- Cila është struktura e temës sime?
- A përputhet zgjedhja e temës sime me planin mësimor?
- Cilat aspekte të temës sime janë interesante për nxënësit e mi?

Si është lidhur i mësuarit në shkollë me të mësuarit jashtë shkolle?


- A lidhet tema me jetën dhe mjedisin e nxënësve?
- A kam unë njohuri të përgjithshme për lëndën, e cila më mundëson përzgjedhjen e një temë të caktuar? Si mund të informohem më mirë? A duhet unë të kryej ndonjë studim ose eksperiment para se të zhvilloj lëndën në klasë?
- Cilat materiale mësimore janë në dispozicion për aspektet e veçanta të temës?
- A do të ndikohen nxënësit nga përvoja e tyre personale, njohuritë dhe aftësitë mësimore (për shembull, fëmijët me prejardhje të ndryshme kulturore ose gjuhësore)?
- A do të jetë tema njësoj e përshtatshme për nevojat e veçanta të dy gjinive?
- A më intereson mua tema e zgjedhur?

Vendosja e objektivave dhe përzgjedhja e materialeve

Fletë pune 1: Kompetencat e nxënësve për EQD/EDNJ

Tre fushat e kompetencës për të jetuar dhe mësuar demokracinë dhe të drejtat e njeriut

Qëllimi i Edukimit për Qytetari Demokratike është të mbështetë zhvillimin e kompetencave në tri fusha, të cilat janë gjithmonë e fuqimisht të ndërlidhura dhe për këtë arsye nuk duhet të trajtohen veç e veç.



Kompetenca në analizën dhe gjykimin politik

Qëllimi është zhvillimi i kompetencës për të analizuar ngjarjet, problemet dhe çështjet e diskutueshme politike dhe të qenit në gjendje për të shpjeguar arsyet për gjykimet personale. Shkolla mund të kontribuojë në këtë proces, duke nxitur nxënësit të përdorin analizën e strukturuar për të arritur një kuptim më të thellë të çështjeve.

Për të arritur këtë janë të domosdoshme aftësitë e mëposhtme:

- njohja e rëndësisë së vendimeve politike për jetën e dikujt;

- njohja dhe gjykimi i pasojave të vendimeve politike;
- njohja dhe paraqitja e këndvështrimit personal dhe e këndvështrimit të tjerëve;
- njohja dhe të kuptuarit e tre dimensioneve të politikës:
 - a) dimensionin institucional,
 - b) dimensionin i lidhur me përmbajtjen,
 - c) dimensionin i orientuar nga procesi.
- analiza dhe vlerësimi i fazave të ndryshme të proceseve politike në nivelin mikro (për shembull, jeta e shkollës), nivelin mesatar (për shembull, të komunitetit) dhe nivelin makro (atë kombëtar dhe të politikës ndërkombëtare);
- paraqitja e fakteve, problemeve dhe vendimeve me ndihmën e kategorive analitike, identifikimi i aspekteve kryesore dhe lidhja e tyre me vlerat themelore të të drejtave të njeriut dhe të sistemeve demokratike;
- identifikimi i kushteve, interesave dhe zhvillimeve sociale, ligjore, ekonomike, ekologjike dhe ndërkombëtare në diskutimin për çështjet e diskutueshme të aktualitetit;
- njohja e mënyrës sesi paraqitet politika nga media.

Kompetenca në përdorimin e metodave

Për të marrë pjesë në proceset e ndryshme politike nuk duhen vetëm njohuri bazë rreth përmbajtjes politike, por nevojiten edhe strukturat dhe proceset, madje edhe kompetenca të përgjithshme të cilat janë fituar në lëndë të tjera (të tilla, si: komunikimi, bashkëpunimi, trajtimi i informacioneve, të dhënave dhe statistikave). Në Edukimin për Qytetari Demokratike duhet të trajtohen dhe të promovohen aftësi dhe shkathtësi veçanta, si të qenit në gjendje për të argumentuar në favor ose kundër një çështje, aftësi e rëndësishme, veçanërisht për marrjen pjesë në ngjarjet politike. Qëllimi është që këto aftësi të përdoren në metodat e përhapura në diskursin politik (diskutime, debate).

- Për të qenë në gjendje për të bërë këtë, janë të domosdoshme aftësitë e mëposhtme:
 - aftësia për të gjetur, për të përzgjedhur, për të përpunuar dhe për të prezantuar në mënyrë të pavarur informacionin e dhënë nga masmedia dhe/ose mediat e lajmeve në mënyrë kritike dhe të fokusuar (për të grumbulluar, për të organizuar, për të vlerësuar statistika, harta, diagramet, grafikë dhe karikatura);
 - aftësia për të vëzhguar mediet me sy kritik dhe për të zhvilluar produktet e veta të pavarura mediatike;
 - aftësia për të zbatuar metodat empirike mediatike (për shembull, teknikat e studimit dhe intervistimit).

Kompetenca në vendimmarrjen dhe veprimin politik

Qëllimi është për të përftuar kompetencat për t'u shfaqur dhe për të vepruar në mënyrë të sigurt dhe të përshtatshme në kontekstin politik dhe në publik.

Për të bërë këtë, janë të domosdoshme aftësitë e mëposhtme:

- Aftësia për të shprehur mendimin politik në mënyrën e duhur dhe me vetëbesim dhe për të zotëruar format e ndryshme të dialogut.
- Aftësia për të marrë pjesë në jetën publike dhe për të vepruar politikisht (aftësi komunikuese me gojë të tilla, si: shpjegimi i pikëpamjeve, diskutimi, debati, drejtimi ose moderimi i një diskutimi, paraqitja me shkrim dhe teknikat e vizualizimit për postera, gazeta muri, procesverbale takimi, letra për redaktorin etj).
- Aftësia për të njohur mundësitë e veta për të ushtruar ndikim politik, duke formuar një ekip dhe duke punuar së bashku;
- Aftësia për t'u shprehur me vetëbesim, por edhe aftësia për të bërë kompromis; aftësia për të njohur mendimet dhe prirjet antidemokratike dhe për të reaguar ndaj tyre në mënyrë të përshtatshme;
- Aftësia për t'u sjellë natyrshëm në një mjedis shumëkulturore.

Vendosja e objektivave dhe përzgjedhja e materialeve

Fletë pune 2: Dy grupe materiale në EQD/EDNJ

Mësimdhënia dhe të nxënit pa materialet e duhura është e pamundur, sepse materialet janë media që jep lëndën, temat, informacionin dhe të dhënat. Nxënësit zhvillojnë kompetencat e tyre nëpërmjet aktiviteteve, që do të thotë ata "bëjnë diçka" me një objekt. Ajo që të vjen fillimisht në mendje në këtë drejtim është ndoshta teksti shkollor ose një manual dhe ato janë me të vërtetë të rëndësishëm në EQD/EDNJ.

Dy kategoritë e materialeve në EQD/EDNJ

Megjithatë, profili i veçantë i EQD/EDNJ pasqyrohet në larminë e madhe të materialeve dhe medieve. Teksti shkollor dhe manuali janë shembuj të mediave të shtypura. Në të mësuarit ndërveprues konstruktivist, një kategori tjetër e materialeve krijohet nga mësuesi dhe nxënësit. Ato janë autentike, pasi janë materiale të dorës së parë, të prodhuara në vend, në një situatë të veçantë, për njerëzit e pranishëm në atë kohë dhe atë vend. Në EQD/EDNJ, mësuesit dhe nxënësit nuk janë vetëm përdoruesit e materialeve, por edhe prodhuesit e tyre. Vëllimet nga II deri VI të këtij botimi të EQD/EDNJ japin shumë shembuj për këtë kategori materiale, shumë shpesh të krijuara nga nxënësit në kushtet e të nxënit të bazuar në detyra ose në projekte dhe njësitë mësimore dhe përshkrimi i mësimi eksplorojnë potencialet e tyre të pasura mësimore për nxënësit.

Një matricë e kërkesave dhe materialeve të mësimi

Matrica e mëposhtme lidh disa shembuj tipikë për këto dy kategori të materialeve – të dhëna nga media dhe të prodhuara në proceset e bashkëveprimit që përfshijnë mësuesit dhe nxënësit – me aspekte të ndryshme të zhvillimit të kompetencave në fushën e EQD. Ne nuk rekomandojmë asnjë lloj paragjykimi për ndonjë lloj materiali, por më tepër sugjerojmë një qasje të integruar. Megjithatë, mësimi përmes demokracisë dhe të drejtave të njeriut kërkon nga mësuesit që të marrin seriozisht produktet e krijuara nga nxënësit.

Aspekte të zhvillimit të kompetencës	Materiale të transmetuara përmes medias	Materiale të prodhuara në procesin e të mësuarit	
		Materiale të prodhuara nga mësuesit	Materiale të prodhuara nga nxënësit
Zhvillimi i mëparshëm i nxënësve	Materiale të tilla ekzistojnë edhe në media, për shembull, libra ose filma fëmijësh, por ato janë jashtë kuadrit të perceptimit të mësuesit		Njohuri paraprake, përvoja e mëparshme dhe procesi i socializimit në familje ose me bashkëmoshatarët, informacione të përftuara më parë, brenda dhe jashtë shkollës
Përcaktimi i një teme, planifikimi i mësimit ose temës			Ushtrime për nxehje truri dhe diskutim i të dhënave paraprake
Informacioni	Raportime aktuale të lajmeve (media e shkruar, TV, DVD, Internet) Tekste shkollore	Leksione Ofrimi i materialeve bazë (tabela me fleta, lapustila, letër me ngjyra)	Të dhëna të nxënësve (dekonstruksioni (zbërthimi) i mesazheve të transmetuara përmes medias, përmbledhje, detyra për t'u ndjekur, prezantime, argumente dhe debate në diskutim, komente, pyetje)
Analiza dhe gjykime	Çështje dhe keqkuptime në politikë dhe shkencë (fletë pune, tekste shkollore)	Udhëzime për konceptet kryesore Kritikat që kërkojnë dekonstruktivitet	
Trajnimi i aftësive	Fletë pune (udhëzime trajnimi)	Demonstrimi dhe stërvitja	Marrje e reagimeve
Pjesëmarrja dhe veprimi		Drejtimi i një sesiioni	Përvojë Pyetje, komente, thellim, interesa
Vlerësimi dhe pikëzimi	Fletë testimi Pyetësorët Plane mësimore	Vëzhgime	Vetëvlerësimi Reagimet Shprehja e nevojave të mësimit

Vendosja e objektivave dhe përzgjedhja e materialeve

Fletë pune 3: Përzgjedhja dhe përdorimi i materialeve mësimore në EQD/EDNJ

Përzgjedhja e materialeve të transmetuara përmes mediave

Koncepti më i gjerë i materialeve nënkupton se si i përzgjedhin materialet mësuesit dhe nxënësit. Nxënësit e bëjnë këtë në proceset e tyre të të mësuarit konstruktivist. Këtu, ne përqendrohemi në rolin e mësuesit në përzgjedhjen e materialeve që do të përdoren në orët e EQD/EDNJ.

Kriteret për përzgjedhjen e materialeve të prodhuara nga media:

- *Besueshmëria*: a janë autori, burimi, data e prodhimit etj. qartësisht të identifikueshme? A janë marrë teksti, të dhënat etj. nga versioni origjinal dhe a munden nxënësit (në nivelin e mesëm) të shohin nëse janë bërë ndryshime?
- *Përshtatshmëria*: a përshtaten materialet me nivelin e të kuptuarit dhe zhvillimit të kompetencës së nxënësve, duke përfshirë këtu edhe përvojën e tyre në zërbërthimin e mesazheve të transmetuara nga mediat? Materialet nuk duhet të jenë as shumë të lehta, as shumë të vështira; ato duhet të kërkojnë përpjekje që përmirësojnë aftësitë e nxënësve dhe iu shton atyre njohuritë, të kuptuarit dhe fuqinë e gjykimit.
- *Vlefshmëria*: a i përmbush materiali interesat e nxënësve? A trajton ai një temë ose problem të rëndësishëm për nxënësit? A munden ata të lidhin përmbajtjen me njohuritë ose përvojën e tyre papaprake?
- *Parimi i mos-indoktrinimit* ose i larmisë së këndvështrimeve: a tregojnë materialet këndvështrime të ndryshme? A e shmangin ato kurthin e indoktrinimit të nxënësve – në çfarëdo drejtimi të të menduarit, të gjykimit ose të interesave (shih dokumentin për etikën profesionale të mësuesve në EQD/EDNJ në këtë vëllim)?

Trajtimi i materialeve të prodhuara nga nxënësit

Materiale të shkruara, imazhe etj.: mësuesi mund t'i studiojë këto para ose pas mësimave dhe të vendosë se çfarë hapash të ndërmarra.

Të dhëna të nxënësve të shprehura me gojë e vënë mësuesin përpara detyrave gjithnjë e më të vështira, sepse ajo/ai duhet të reagojë në mënyrë spontane dhe shpesh edhe të improvizojë. Shih fletën e punës për drejtimin e diskutimeve plenare në këtë vëllim.

Njësia 3

Të kuptojmë politikat

1. Hyrje: Çfarë duhet të mësojnë nxënësit?

Objektivi i EQD/EDNJ është që t'u mundësojë nxënësve pjesëmarrjen në proceset vendimmarrëse që prekin interesat e tyre dhe të komunitetit në tërësi.

Unë si person mund të ndër marr veprime kur jam i bindur, që do të thotë, kur e di mirë atë që dua. Në terma disi më analitikë, unë duhet të kem identifikuar ose përcaktuar përparësitë e interesat e mia ose të kem gjykuar për një çështje, konflikt ose problem dhe të vendos për anën që do të mbështes me veprimet e mia. Gjykimi, nga ana tjetër, kërkon që të kuptoj dhe të kuptuarit kërkon informacion të bollshëm.

Prandaj nxënësit duhet të kuptojnë temat e rëndësishme politike - si për veten e tyre (të mësuarit "rreth" politikës), por edhe për të fituar kompetencat që mundësojnë punën në mënyrë të pavarur për ndërmarrjen e hapave të nevojshëm: marrjen e informacionit, analizën dhe të kuptuarit e një çështjeje ose problemi politik dhe gjykimin për të. Kjo do t'i mundësojë një qytetari të ri pjesëmarrjen dhe ndërmarrjen e veprimeve (të mësuarit "pro" pjesëmarrjes demokratike).


2. Detyra dhe çështje kryesore për të kuptuar politikat

2.1 Detyra për mësuesit në EQD/EDNJ

Në të gjitha fushat e mësimdhënies dhe të nxënimit, jo vetëm në EQD/EDNJ, nxënësit i kuptojnë çështjet komplekse të lëndës, duke studiuar përmes shembujve të zgjedhur paraprakisht. Manualët e mësuesit në këtë botim të EQD/EDNJ, për nivelin fillor, të ulët dhe të lartë të shkollës së mesme (vëllime II-V) e demonstrojnë këtë parim në çdo njësi mësimore dhe tregojnë mundësinë e qasjeve të ndryshme. Manualët tregojnë, gjithashtu, se këto shembuj mund të merren nga konteksti i qeverisjes së shkollës ose nga vendimmarrja politike e çdo niveli - në varësi të moshës së nxënësve, të materialit që është në dispozicion ose që mund të ofrohet nga nxënësit dhe nga rezultati që mësuesi dëshiron të arrijë në mësim.

Këta shembuj, në thelb, janë dy llojesh - analiza e një problemi ose e një çështjeje politike dhe analiza e një procesi të vendimmarrjes politike. Mësuesi duhet të vendosë se cilët shembuj janë të përshtatshëm dhe të sqarojë se çfarë materiali është në dispozicion ose është i nevojshëm për këtë qëllim.

Detyra e mësimdhënësit të EQD/EDNJ-së është të lidhë elementet e mëposhtëm në planifikimin e mësimave për politikën:



Asnjë planifikim mësimi nuk është i mundur pa marrë parasysh të gjithë elementet e mësimdhënies dhe të mësuarit dhe pa i lidhur ato së bashku. Ndryshimi i pozicionit të një elementi do të ndikonte tek të tjerët. Nga ana tjetër, lënda mësimore mund të ndryshohet për të arritur një objektiv të caktuar ose anasjelltas.

2.2 Çështjet kryesore

- Çfarë duhet të jenë nxënësit e mi në gjendje të bëjnë pas kësaj njësie mësimore? Çfarë duhet të kenë kuptuar dhe të jenë në gjendje t'ua shpjegojnë të tjerëve dhe çfarë kriteresh duhet të jenë në gjendje të përdorin në gjykimin e një çështje politike?
- Si mundem unë të vlerësoj zhvillimin e kompetencës së tyre?
- Si munden nxënësit të përdorin përvojën e tyre të jetës së përditshme ose atë në shkollë për të kuptuar politikën?
- Si e perceptojnë nxënësit vendimmarrjen politike?
- Deri në çfarë mase nxënësit janë të vetëdijshëm për interesat e tyre?
- Cilat çështje aktuale ndikojnë tek nxënësit?
- Cilat çështje aktuale janë në gjendje të kuptojnë nxënësit?
- A janë këto çështje të lidhura me qeverisjen e shkollës ose politikën në nivel lokal, rajonal, kombëtar ose ndërkombëtar?
- Si mund t'i nxis unë nxënësit e mi të marrin pjesë në zgjidhjen e një çështje?
- Çfarë lloj medie ose materiale do të përzgjedh për të paraqitur mendime të ndryshme për këtë çështje?
- Çfarë detyrash do t'u caktoj nxënësve për të punuar në mënyrë të pavarur?
- Çfarë materiale mund të më japin nxënësit e mi?
- Çfarë konceptesh kyç mund të zbatojnë ata për temën ose çështjen e caktuar?
- Çfarë opinionesh pres unë të shprehin nxënësit e mi për një çështje?
- Cili është mendimi im? Cilit kriter i kam dhënë unë përparësi në gjykimin tim?
- Si do sigurohem unë se nuk do të ndikoj te nxënësit, duke i bindur të pranojnë këndvështrimin tim?
- Në çfarë mënyre do mund të fillonin nxënësit e mi të vepronin?

Të kuptojmë politikat

Fletë pune 1: Si mund të trajtoj çështjet e politikës në orët e EQD/EDNJ?

Në EQD/EDNJ, nxënësit duhet të mësojnë si të kuptojnë politikën. Por, çfarë është politika? Çfarë e bën një temë politike? Shembulli i mëposhtëm mund të shërbejë si një hyrje.

Studim rasti

Një qytet i vogël në një zonë rurale ka një shkollë që u shërben, jo vetëm nxënësve që banojnë në qytet, por edhe atyre që ndodhen 20 km larg. Ata përdorin shërbimin e autobusit për të lëvizur nga shkolla në shtëpi. Qeverisja bashkiake mbështet familjet me të ardhura të ulëta, veçanërisht ato që kanë dy a më shumë nxënës në shkollë. Familjet përfitojnë zbritje në pagesën e autobusit, që ndryshon nga 25% në 75%.

Kriza ekonomike ka çuar ulur shumë të ardhurat nga taksimi. Përfaqësuesit e këshillit bashkiak diskutojnë si të ulin, sa më shumë që të jetë e mundur, shpenzimet duke shmangur financimet nëpërmjet kreditimeve. Disa politikanë dhe komentues me influencë kanë sugjeruar reduktimin e uljes për autobusët ose edhe ndërprerjen e plotë të saj. Ata argumentojnë se ulja e plotë e shpenzimeve është e konsiderueshme, por ato janë shpërndarë mes familjeve që zor se do ta “ndjejnë pickimin”. Shumë prindër nuk janë dakord me këtë zgjidhje dhe dëshirojnë që sistemi dhe përkrahja e familjeve të vazhdojë siç është.

Kjo histori është e sajuar, por ndoshta është mjaft tipike në diskutimet për uljen e shpenzimeve publike në kohët e recesionit ekonomik. Çfarë është politike në këtë histori?

Një model tre-dimensional i politikës

Për konceptin e politikës janë të mundshme përkufizime të ndryshme. Një njeri i zakonshëm, që është i aftë për mësimdhënie dhe për të mësuar zbaton një model tre-dimensional të politikës: *çështjet, vendimet dhe institucionet*.

Dimensioni i çështjeve politike: në politikë, njerëzit debatojnë për interesat e tyre ose në lidhje me çështjen se si mund të identifikohet dhe të zgjidhet një problem ose dilemë. Ndonjëherë ata organizohen në grupe me qëllim që të shprehin më mirë interesat e tyre kolektive. Debatë dhe polemika janë diçka normale në politikë; ato pasqyrojnë interesa dhe mendime të ndryshme në një shoqëri pluraliste dhe askush nuk duhet të frikësohet nga to, nëse zgjidhen në mënyrë paqësore.

Dimensioni i vendimmarrjes politike: në politikë, problemet janë urgjente – ato ndikojnë në interesat e komunitetit si një i tërë ose në ato të një grupi të madh njerëzish. Ata kërkojnë veprim dhe, për këtë arsye, diskutimi duhet të çojë deri në një vendimmarrje, që shoqërohet me një veprim të mëvonshëm.

Dimensioni institucional i politikës i referohet kuadrit në të cilën bëhet politika. Çfarë kompetencash i janë dhënë gjithkujt? Si mbahen zgjedhjet? Si bëhen ligjet? Çfarë të drejtash ka opozita parlamentare? Si ndikojnë individët dhe grupet e veçanta të interesit për këto procese politike? Ky dimension përfshin edhe Kushtetutën, rregullat dhe ligjet, të cilat përcaktojnë mënyrën se si trajtohen çështjet politike në mënyrë paqësore në proceset e vendimmarrjes demokratike. Një koncept më i gjerë përfshin edhe dimensionin kulturor, vlerat dhe qëndrimet që qeverisin sjelljen politike të qytetarëve.

Pyetjet kryesore në tri këndvështrime politike

Të tre dimensionet na lejojnë të shohim politikën nga këndvështrime të ndryshme. Kjo ndihmon për të sjellë rregull në kompleksitetin që shoqëron çështjet politike. Secila nga këto tri këndvështrime politike të çon në çështje interesante kyçe. Pyetja që shtrohet këtu shërben si shembull dhe duhet të përshtatet sipas kërkesave të rastit që po studiohet.

Dimensioni i çështjeve politike		Përgjigjet		
Cili është problemi që duhet të zgjidhet?	Rreziku i rritjes së borxhit publik në kohën e recensionit ekonomik.			
Cilët janë të përfshirë dhe çfarë objektivash ose interesash mbështesin ata?	Politikanët lokalë: shmangni kreditë duke pakësuar shpenzimet publike. Familjet me të ardhura të ulëta: vazhdon mbështetjen për familjet në nevojë.			
Cilat janë të drejtat njerëzore në rrezik?	Barazia dhe mos diskriminimi E drejta e arsimimit E drejta e sigurisë sociale.			
Çfarë sugjerimesh jepen ose diskutohen për zgjidhjen e problemeve?	Pakësimi ose shkurtimi i pagesës së autobusit për familjet.			
Dimensioni i vendimmarrjes politike				
Kush merr pjese në procesin e vendimmarrjes politike?	Politikanët	Komentatorët e medias	Familjet	
Kush është dakord dhe kush është kundër?	Bien dakord në sugjerimin e uljeve për përkrahjen e familjeve		Kundërshtojnë uljet	
Çfarë shansesh kanë lojtarë të ndryshëm për të ndikuar për vendimin përfundimtar?	Ndikim i drejtpërdrejtë të anëtarët e këshillit bashkiak.		Mund të gjejnë mbështetje mes qytetarëve ose në media.	
Kush ka më shume pushtet, kush ka më pak?	Varet. Rasti në studim nuk ofron informacion në këtë pikë.			
Kush ka shanse më të mëdha ose më të vogla për të siguruar një shumicë?	Politikanët mund të sigurojnë shumicën në këshill me shumë lehtësi; megjithatë, nëse vendimi është jopopullor, ata mund të humbasin mbështetjen në zgjedhjet e ardhshme dhe duhet, për këtë arsye, të jenë të kujdesshëm.			
Dimensioni institucional (kuadri)				
Cilat nga parimet kryesore të kushtetutës ose të mjedisit legjislativ janë të pranishme ose që po zbatohen?	Kontrolli dhe balancat, zbatimi i ligjit, siguria sociale, liria e shtypit, liria e shprehjes (prindërit).			
Cilat janë standardet e mundshme ndërkombëtare dhe/ose rajonale të të drejtave të njeriut?	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948) Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (1950) Konventa për të Drejtat e Fëmijës (1989)			
Cilët institucione politike janë të përfshirë, dhe cilat janë pushtetet e tyre të vendimmarrjes?	Këshilli Bashkiak si ligjvënës			
Çfarë ligjesh dhe parimesh ligjore duhet të zbatohen?	Rasti në studim nuk na jep informacion; domethënë, këtu kemi megjithatë, një pyetje standarde që duhet të përfshihet gjithmonë.			

Si e mbështet kjo analizë EQD/EDNJ?

Një analizë e strukturuar dhe sistematike e një teme politike ndihmon mësuesin në përgatitjen e mësimeve të EQD/EDNJ dhe nxënësit në të kuptuarit e politikës.

Mësuesi:

- mund të vendosë nëse do të përqendrohet vetëm në një dimension, duke përdorur një studim rasti, të tillë si ky, për të demonstruar se si punon sistemi i institucioneve politike, se si merret një vendim politik ose çfarë është një çështje politike dhe se si mund të zgjidhet ajo;
- mund ta kthejë këtë studim rasti në një lojë vendimmarrjeje: nxënësit veprojnë në role të ndryshme, dhe negociojnë për një zgjidhje;
- vëzhgon me kujdes median për të identifikuar materialet e përshtatshme për çështjen aktuale.

Nxënësit:

- ushtrojnë kompetencat e tyre për të kuptuar dhe për të zgjedhur informacione për çështjet politike, proceset e vendimmarrjes dhe institucionet politike;
- mësojnë të bëjnë pyetje që udhëheqin në analizat e tyre;
- mësojnë se si të merren me çështje komplekse, duke i shqyrtuar pjesët e tyre një nga një dhe duke i analizuar ato nga këndvështrime të ndryshme.

Të kuptojmë politikat

Fletë pune 2: Si mund të mbështes nxënësit në gjykimin e çështjeve politike?

Objektivi kryesor i EQD/EDNJ është t'u mundësojë nxënësve pjesëmarrjen në komunitetin e tyre dhe në politikë. Për të ndërmarrë veprime në këtë mënyrë, nxënësit duhet të dinë se çfarë duan të arrijnë; objektivat dhe strategjitë e pjesëmarrjes politike bazohen në analizën dhe gjykimin.

Si mundën mësuesit e EQD/EDNJ të mbështesin nxënësit e tyre në gjykimin e çështjeve politike? Nxënësit gjithmonë gjykojnë çështjet dhe vendimet, ndoshta emocionalisht, ndoshta intuitivisht. Nëse është kështu, si do të mundën nxënësit të zhvillojnë një qasje më reflektuese ndaj gjykimit politik?

Cilat kritere janë të përshtatshme për gjykimin politik?

I njëjti rast i përdorur tashmë në seksionin e mëparshëm të Fletëve të Punës është përdorur si shembull për të demonstruar se si kriteret në gjykimin politik mund të konkurrojnë dhe të baraspeshojnë njëri-tjetrin. Duke përdorur të njëjtin rast, dy dosjet e punës tregojnë se si një temë politike mund të analizohet nga këndvështrime të ndryshme. Gjykimi politik fokusohet në dimensionin e çështjeve politike (shih dosjen e mësipërme të punës), duke u futur edhe më në thellësi.

Studim rasti

Një qytet i vogël në një zonë rurale ka një shkollë që u shërben, jo vetëm nxënësve që banojnë në qytet, por edhe atyre që ndodhen 20 km larg. Ata përdorin shërbimin e autobusit për të lëvizur nga shkolla në shtëpi. Qeverisja bashkiake mbështet familjet me të ardhura të ulëta, veçanërisht ato që kanë dy a më shumë nxënës në shkollë. Familjet përfitojnë zbritje në pagesën e autobusit, që ndryshon nga 25% në 75%.

Kriza ekonomike ka çuar ulur shumë të ardhurat nga taksimi. Përfaqësuesit e këshillit bashkiak diskutojnë si të ulin, sa më shumë që të jetë e mundur, shpenzimet duke shmangur financimet nëpërmjet kreditimeve. Disa politikanë dhe komentues me influencë kanë sugjeruar reduktimin e uljes për autobusët ose edhe ndërprerjen e plotë të saj. Ata argumentojnë se ulja e plotë e shpenzimeve është e konsiderueshme, por ato janë shpërndarë mes familjeve që zor se do ta "ndjejnë pickimin". Shumë prindër nuk janë dakord me këtë zgjidhje dhe dëshirojnë që sistemi dhe përkrahja e familjeve të vazhdojë siç është.

Kjo histori rasti është e sajuar, por ndoshta mjaft tipike për diskutimet për reduktimin e shpenzimeve publike në kohë të recesionit ekonomik. Si duhet të gjykohet kjo çështje?

Qeverisja vendore duhet të bëjë të pamundurën për të arritur dy objektiva që janë të vështira për t'u arritur në të njëjtën kohë.

1. Familjet me të ardhura të ulëta kanë nevojë për mbështetje; kjo nënkupton se një sasi e caktuar e buxhetit është e rezervuar për përfitime familjare.
2. Qeveria duhet të shqyrtojë problemin e rënies së të ardhurave nga taksat në periudhë recesioni ekonomik; kjo ngre pyetjen deri në çfarë mase duhet të reduktohen shpenzimet, duke përfshirë edhe përfitimet familjare.

Objektivat janë në konflikt me njëri-tjetrin, sepse mënyra e arritjes së tyre përjashton reciprokisht njëri-tjetrin. Ndërsa i pari kërkon shpenzime, i dyti kërkon kursim. Mënyra për t'ia dalë – financimi nga borxhi – ka pasoja serioze të padëshiruara. Ajo siguron lehtësim afatshkurtër, por pagesat e interesit, plus pagesa mbrapsht e kreditimit, ka tendencë t'i marrë frymën financave publike. Për më tepër, financimi me kredite mund të shtojë inflacionin.

Dy kriteret bazë për gjykimin e vendimeve politike

Në një shtet demokratik, jo vetëm liderët politikë, por edhe qytetarët duhet të gjykojnë alternativat në një vendimarrje. Vetëm atëherë shtetasit do të jenë në gjendje të mbështetnin ose të kundërshtojnë

vendimet e marra nga qeveria.

Ne mund ta kuptojmë gjykimin politik si një proces të menduarit konstruktivist që i ngjan një debati të brendshëm. Folës të ndryshëm të brendshëm propozojnë vlerat ose parimet që çojnë në vendime të ndryshme. Individit është si një gjyqtar i cili i dëgjon të gjithë palët, i vë në baraspeshë ose vendos përparësinë e argumenteve të tyre dhe pastaj merr një vendim që hap një rrugë veprimi. Ne mund të imagjinojmë një debat ideal të tipit të brendshëm për çështjet politike rreth përkrahjeve familjare si kjo.

Folësi i parë

Komuniteti ynë është i përkushtuar për të drejtat e njeriut dhe ka integruar shumë prej tyre në kushtetutën tonë. Ato përfshijnë të drejtën e shkollimit³⁰ dhe të drejtën për një standard të përshtatshëm jetese³¹. Familjet gëzojnë në veçanti mbrojtjen e shtetit. Familjet i shërbejnë shoqërisë si një e tërë, duke marrë përgjegjësinë për edukimin e brezit të ri. Prandaj, ne jemi të detyruar që të kujdesemi, veçanërisht për familjet me të ardhura të ulëta. Për këtë arsye, unë kërkoj që pagesa për biletat e autobusit të shkollës të mbetet e paprekur, veçanërisht në këto kohë të vështira.

Folësi i dytë

Marrja e përgjegjësive për komunitetin do të thotë se ne duhet të identifikojmë problemet dhe rreziqet që na kërcënojnë dhe të sigurohemi se do t'i zgjidhim ato. Në periudhën afatmesme, ne nuk mund të shpenzojmë më shumë se sa kemi fituar. Nëse të ardhurat tona nga taksat ulen, po ashtu duhet të veprojmë edhe me shpenzimet tona. Ne jemi duke i bërë një nder familjeve nëse i financojmë përkrahjen nëpërmjet kredive. Të gjithë ata, dhe veçanërisht fëmijët e tyre, duhet të paguajnë pjesën e tyre, plus interesin. Një zgjidhje efikase e problemeve tona financiare do t'i shërbejë të gjithëve. Prandaj unë kërkoj që shpenzimet të reduktohen në masën që të mund të shmangen shpenzimet e kreditimeve, dhe i kërkoj familjeve që të kontribuojnë me pjesën e tyre.

Folës të tjerë mund të marrin "fjalën si të brendshëm", duke shprehur pika të mëtejshme themelore. Një folës i tretë, për shembull, merr në konsideratë ndikimin e dëshiruar dhe të padëshiruar afatgjatë të një vendimi, për shembull, në aspektin e qëndrueshmërisë. Cili është ndikimi për planet, interesat dhe kushtet e jetesës të brezit të ardhshëm, në rritjen ekonomike, ose në grupet shoqërore në fund të shkallës sociale?

Dy këndështrimet bazë të gjykimit politik

Dy folësit e parë argumentuan për kuptime të ndryshme të përgjegjësisë.

Përkufizimi i folësit të parë për përgjegjësinë ishte normativ, i bazuar në sistemin e vlerave të të drejtave të njeriut. Varfëria është një shkelje e rëndë e dinjitetit njerëzor dhe, për këtë arsye, shteti nuk duhet të zvogëlojë mbështetjen për familjet me të ardhura të ulëta.

Përkufizimi i folësit të dytë për përgjegjësinë nuk ishte i bazuar në vlerat, por i bazuar në qëllimin. Zgjidhja e efikasitetit të një problemi urgjent është i rëndësishëm dhe asnjë tabu nuk është e pranueshme për t'u shkëputur nga kjo përparësi.

Folësi i tretë trajtoi të dyja aspektet të lidhura me pasojat afatgjata të një vendimi.

E thënë me pak fjalë, njerëzit duan të trajtohen si njerëz nga autoritetet dhe të kenë të drejtën e fjalës për mënyrën se si po drejtohet vendi (folësi i parë) dhe duan të qeverisen mirë dhe me efikasitet (folësi i dytë).

Diskutimet mund të çojnë në një rrugë pa krye, në qoftë se folësit përdorin pika të ndryshme referimi, siç janë vlerat dhe qëllimet. Të dy pikat janë të justifikuar në mënyrën e tyre, por ato nuk janë të lidhura, po të mos i lidhim ne me anë të gjykimit.

Gjykimi politik në orët e EQD/EDNJ

Në shkollë, nxënësit ushtrojnë lirinë e tyre të mendimit dhe opinionit.³² Nxënësit që kanë dëgjuar debatin e tyre të brendshëm janë të lirë në vendimin e tyre. Mësuesi nuk duhet të ndërhyjë si folës tjetër në këtë proces të gjykimit dhe të japë mendimin e tij në lidhje me vendimin "e drejtë"³³; në politikën demokratike, askush nuk zotëron standardet absolute të gjykimit për të përcaktuar vendimin e duhur. Në veçanti, mësuesi nuk duhet të bëjë moral ose të nxisë nxënësit për të ndërmarrë veprime

30. Protokollin e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (20 Mars 1952), Neni 2.

31. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (10 Dhjetor 1948), neni 25

32. Konventa për të Drejtat e Fëmijës (20 Nentor 1989) Neni 13, 14. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (4 Nentor 1950) neni 9, 10

33. Shih fletën e punës për etikën profesionale të mësuesit në EQD/EDNJ, në këtë vëllim.

në një mënyrë të caktuar ose edhe për të ndërmarrë veprime konkrete. Kjo mbetet në dorë të nxënësve për të vendosur, jo të mësuesit.

Nxënësit janë të lirë në zgjedhjen e kriterëve të tyre. Duke reflektuar për gjykimin e tyre politik, ata duhet të bëhen të vetëdijshëm për to. Ky është një hap i madh përpara, në krahasim me gjykimet që bazohen në emocione ose në intuitë ("e mirë" dhe "e keqe"). Në një nivel edhe më të avancuar, ata mund të japin arsye për zgjedhjen e kriterëve të tyre.

Megjithatë, nxënësit duhet të kuptojnë se në politikë duhet të merren vendime dhe, në fakt, edhe mosgjykimi të çon në një vendim. Prandaj, nuk është e mjaftueshme vetëm të dëgjohet debati i tyre i brendshëm dhe largimi i folësve pa vendosur për vendimin që duhet marrë. Në thelb, kur merren në konsideratë objektiva kontradiktore, siç është rasti më sipër, nxënësit mund:

- t'u japim përparësi, domethënë, të vendosin për të vazhduar ndihmat familjare ose të miratojnë një politikë të shtrënguar të shkurtimeve të shpenzimeve;
- të arrijnë një kompromis: në këtë rast, kjo do të shkonte në shkurtime të buta për përkrahjen familjare dhe shpenzime të moderuara për kredi; duke menduar më me kujdes se si të shpenzohet një buxhet më i vogël, në mënyrë të tillë që ata që ndihmojnë më shumë edhe të kenë mundësi të marrin diçka, i jep detajeve teknike më shumë rëndësi nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut.

Metoda të ndryshme, por jo të gjitha, mbështetin nxënësit në të menduarit me kujdes për çështjet e gjykimin politik. Ato përfshijnë:

- seanca plenare – të menduarit kritik, debate dhe diskutime;
- punën me shkrim, e shoqëruar me përgjigjet nga mësuesi;
- të nxënit e bazuar në detyra të ndjekur nga një fazë e detajimit dhe e diskutimeve.

Temat e zgjedhura nga mësuesi duhet të lejojnë zgjedhje bindëse për pikëpamjet e diskutueshme dhe të jenë brenda mundësive të nxënësve, pra jo shumë të ndërlikuara. Çështjet aktuale ngjallin interes të nxënësve dhe mësuesit, por janë më të vështira për t'u trajtuar, sepse të dyja palët në këtë rast veprojnë si pionierë.

Njësia 4

Drejtimi i procesit të të nxënës dhe përzgjedhja e formave të mësimdhënies

1. Hyrje

Fillimi dhe mbështetja e proceseve të të mësuarit të nxënësve është një nga detyrat më mbresëlënëse që ofron profesioni ynë. Nëse nuk keni një ide të qartë për veçoritë e stileve të të mësuarit që nxënësit do të përdorin për të arritur objektivat që ju (ose edhe ata bashkë me ju) keni vendosur për ta, ju nuk do keni mundësi të planifikoni në mënyrë të përshtatshme mënyrat dhe mjedisin e të mësuarit, aktivitetet e të mësuarit, detyrat dhe metodat e punës. Në EQD/EDNJ këto mënyra mund të jenë shumë të ndryshme dhe kushdo që i kushton kohë dhe përpjekje problemit se si mësojnë individë të ndryshëm, do të arrijë diçka më të mirë dhe, me kalimin e kohës, do të bëhet ekspert i të mësuarit.

2. Detyra dhe çështje kryesore për drejtimin e proceseve të të mësuarit dhe përzgjedhjen e metodave të mësimdhënies

2.1 Detyra

Fillimi dhe mbështetja e proceseve të mësuarit të fëmijëve është një nga detyrat më mbresëlënëse që ofron profesioni i mësuesit – por edhe një nga më kërkuesit!

Mendimet dhe idetë tuaja për proceset e stileve të të mësuarit, janë si të thuash, shtylla kurrizore e përpjekjeve të planifikimit. Nëse nuk keni një ide mjaft të qartë se cilat procese të të mësuarit përdorin nxënësit tuaj si individë për të arritur objektivat e mësimin që ju (dhe/ose ata) keni vendosur të arrini, ju nuk do të keni mundësi të planifikoni, si duhet, mënyrat dhe mjedisin e të mësuarit, aktivitetet e të mësuarit, detyrat dhe metodat e punës.

Ballafaqimi me pyetjen, se si e mësojnë diçka më mirë nxënësit si individë, është një detyrë që konsumon shumë kohë dhe shpesh herë e vështirë. Por, kushdo që i kushton kohë dhe përpjekje kësaj çështje, që e diskuton me nxënësit, dhe më në fund e vlerëson dhe reflekton për përvojën e grumbulluar për të, me kalimin e kohës, do të zhvillohet e kthehet në ekspert të të mësuarit. Proceset e të mësuarit janë komplekse, dhe sukcesi dhe përsosja e tyre varet nga shumë faktorë.

2.2 Çështje kryesore


- Cilat procese të të mësuarit do t'i lejojnë nxënësve të arrijnë objektivat e vendosura?
- Si do t'i mundësoj unë nxënësit të mi të marrin (të fitojnë), të kuptojnë (proceset), të kujtojnë (të ruajnë) informacionin e ri?
- A i inkurajon stili i të mësuarit nxënësit që të zbatojnë njohuritë dhe aftësitë e fituara rishtas në detyra të reja?
- A fokusohet mësimi ose njësitë mësimore të planifikuara në thithjen, përpunimin dhe ruajtjen e informacionit ose në detyrat e ardhshme?
- A i kam marrë unë parasysh, në planifikimin e njësive mësimore, aspektet e rëndësishme (kushtet ideale të mësimin)?
- A është ndërtimi i strukturave të të kuptuarit dhe fitimi i aftësive ose zhvillimi i qëndrimeve objektivi kryesor i procesit mësimor për nxënësit dhe a i kam përzgjedhur unë format e përshtatshme për mësimdhënien dhe të mësuarit për arritjen e këtyre objektivave?
 - me veprime (duke qenë aktiv, duke prodhuar ose duke formuar diçka etj.)?
 - duke menduar (duke kryer eksperimentim mendor, duke "krijuar" ndijime të reja)?
 - nëpërmjet vëzhgimit?

Pjesa 2 - Teaching democracy and human rights


- nëpërmjet mësimdhënies me gojë (leksion, tregim-historie etj)?
- nëpërmjet udhëzimit, ndihmës dhe bashkëpunimit?
- nëpërmjet diskutimit dhe debateve?
- nëpërmjet krijimit të një dokumenti të shkruar (raport, ditar nxënësi etj)?
- nëpërmjet një mesatareje?
- nëpërmjet një ngjarje të veçantë në jetën dhe përvojën reale?
- nëpërmjet eksperimentit, provës dhe gabimit?

Drejtimi i procesit të nxënit dhe përzgjedhja e formave të mësimdhënies
Fletë pune 1: Tri fazat e procesit të nxënit

Në çdo proces të nxëni ne mund të dallojmë tre faza, ngushtësisht të lidhura, të cilat mbështesin njëra - tjetrën.



Përfitim i informacionit



Pyetje për përfitimin e informacionit nga nxënësit

Njohuri të mëparshme

Si mundën nxënësit të (ri) aktivizojnë njohuritë e tyre paraprake?

Duke drejtuar pyetje

A mundën nxënësit të merren me temën, në një mënyrë të tillë që të mund të mendojnë për pyetje?

Ndijimet

A mundën nxënësit të përdorin shqisat e tyre të ndryshme për të marrë informacion të ri?
A mësojnë nxënësit duke parë, duke kërkuar, duke menduar, duke dëgjuar, duke ndjerë dhe duke u emocionuar, duke prekur, duke provuar e duke mbajtur erë etj.?

Duke ilustruar

A janë përdorur ilustrimet, modelet ose kopjet?

Përpunimi dhe depozitimi i informacionit

Përpunimi dhe ruajtja

duke eksploruar, duke zgjidhur probleme,
duke kuptuar, duke kapur, duke përftuar,
duke memorizuar, duke kujtuar, duke
përsëritur, duke përjetuar

Struktura

A janë përmbajtjet e organizuara në mënyrë të tillë që hapat e mëparshëm të të nxënit të lehtësojnë ata pasardhës?

Pikat e referencës

A munden nxënësit të lidhin informacionin e ri me njohuritë e tyre të mëparshme?

Niveli i arritjeve

A janë detyrat e vendosura për nxënësit si individë – meshkuj dhe femra – me kërkesa dhe sfida, por, megjithatë, brenda mundësive të tyre të moshore?

Thellimi i të kuptuarit

A janë detyrat dhe mjedisi i përcaktuar të përshtatshëm për përfortimin dhe thellimin e asaj çka nxënësit kanë mësuar?

Regjistrimi

A krijojnë nxënësit një regjistër të rezultateve të tyre (raporte, postera, shënime, vizatime, diagrama, skica të papërpunuara, etj.)?

Praktika

A kanë nxënësit rast për të praktikuar aftësitë e tyre të përfutuara rishtazi në një shumëllojshmëri kontekstesh të mundshme?

Intensiteti

A u është ofruar nxënësve kohë dhe mundësi e mjaftueshme për të provuar plotësisht mënyrën e tyre të punës përmes informacionit dhe eksperiencës?

A kalojmë në kohë të mjaftueshme me një lëndë, për t'u dhënë nxënësve mundësinë të provojnë thellësinë e dijeve të tyre?

Transferimi i informacionit



Të mësuarit duhet të përfshijë gjithmonë transferimin e mundësive për nxënësit – të shmangen vlerësimet e tilla si “mësoi, por e ka harruar tashmë”, ose “e di, por nuk kupton ose reflekton”, “e realizoi dje, por gati e humbi sot”, ose “e mësoi, por nuk e përdor”.

Pyetje për transferimin e informacionit

Dobishmëria

A e vlerësojnë dhe e praktikojnë nxënësit dobishmërinë e asaj ç’ka kanë mësuar?

Përvoja e të qenit të efektshëm (motivimi).

A i kanë praktikuar nxënësit, në mënyrë të drejtpërdrejtë, lidhjet ndërmjet përpjekjeve të tyre dhe përparimit në mësim? A e kuptojnë nxënësit se janë ata vetë përgjegjës për zgjerimin e njohurive, të të kuptuarit dhe të aftësive, domethënë, ata mund të arrijnë diçka me anë të përpjekjeve të tyre për të mësuar dhe përmes aktiviteteve?

Kontrolli

A janë kontrolluar dhe rishqyrtuar konkluzionet?

Studime të mëtejshme dhe të avancuara

A e nxisin njësitë e zhvilluara mësimore interesin për t’u marrë me studime të mëtejshme dhe më të avancuara?

A mbeten nxënësit të përfshirë emocionalisht?

Zbatimi

A u janë ofruar nxënësve, si vajza dhe djem, një shumëllojshmëri e gjerë mundësish për të zbatuar atë çfarë kanë mësuar? A dinë nxënësit se në çfarë mënyrash mund të zbatohen njohuritë dhe aftësitë e tyre dhe nëse ka kufizime për to?

Drejtimi i procesit të të nxënës dhe përzgjedhja e formave të mësimdhënies
Fletë pune 2: Përse metoda tradicionale e mësimdhënies nuk është e mjaftueshme, çfarë të mëson mësuesi ndryshon nga ajo çfarë mësohet nga nxënësi dhe ajo që mësohet nga nxënësi ndryshon nga ajo që zbatohet në jetën reale.

Mësuesit që janë trajnuar përgjatë linjave tradicionale të mësimdhënies priren të mbivlerësojnë ndikimin e mësimit me anë të të folurit - "Ajo çfarë thuhet - mësohet". Kjo pikëpamje është veçanërisht e zakonshme ku mësuesit shpesh përballen me kurrikula të mbushura me dije të shumta e komplekse. Atëherë duket se joshesh dhe jep mësim në mënyrën që të duket më e shpejtë dhe më efikase - mësuesi jep leksione, nxënësi dëgjon dhe një mësues i historisë mund të mendojë, "Tani unë e mbarova shekullin e 20".

Por, a mësojnë nxënësit vetëm duke dëgjuar leksione? Dhe a i kanë mësuar ata të gjithë ato që mësuesi dëshiron të ata të mësonin?

"E thëna (nga mësuesi) përkundrejt të mësuarës (nga nxënësi)

Nën këndvështrimin konstruktivist, përgjigja për këto pyetje është jo. "Të mësuarit nga mësuesi përkundrejt asaj çka nxënësi mëson vetë." Të mësuarit është një proces individual. Nxënësit ndërtojnë, si të thuash, sistemet e tyre individuale të njohurive. Ata lidhin atë çka dinë dhe e kanë kuptuar me informacionin e ri, duke përdorur koncepte, duke krijuar ide, duke gjykuar nën dritën e përvojës së tyre etj. Ata kërkojnë kuptimin dhe logjikën në atë çka mësojnë, ata përcaktojnë çfarë është e rëndësishme dhe ia vlen të kujtohet, dhe çfarë nuk është e tillë dhe, rrjedhimisht, mund të harrohet.

Ata gjithashtu bëjnë edhe gabime.

Një mësues që jep mësim para një audience prej 30 nxënësish duhet të jetë i vetëdijshëm se në mendjet e nxënësve, prodhohen dhe integrohen rreth 30 versione të ligjëratës së mësuesit, në sistemet e të kuptuarit të nxënësve - në strukturat njohëse, siç i ka quajtur profesori i njohur i psikologjisë Jerome Bruner.

Por, të mësuarit nuk është vetëm ndërtimi i kuptimit, por edhe analiza e gabimeve. Nxënësit e rinj, për shembull, mund të besojnë se nata vjen sepse perëndon dielli, sepse kjo është ajo çka shohin ata. Sigurisht, mësuesit kanë të drejtë kur përpiqen të korrigjojnë këtë mënyrë të menduarit. Nga këndvështrimi i nxënësit, analizë dhe interpretimi prej tij janë të vështira dhe ndonjëherë edhe të pakëndshme. Për këtë arsye, leksioni i mësuesit, mund të jetë pjesë e një informacioni të ri për një nxënë, ndërkohë që një tjetër bëhet i vetëdijshëm për një gabim ose keqkuptim që ka nevojë të korrigjohet.

Nga një këndvështrim konstruktivist, ne duhet kësaj të presim që gabime të logjikës, të menduarit dhe të keqkuptimit të informacioneve të jenë rregull e jo përjashtimi - jo vetëm në mendjet e nxënësve tanë, por edhe në mendjet tona.

Për këtë arsye, rishikimi i strukturave tona njohëse është më i ndërlikuar sesa thjesht zëvendësimi i "njohurive të vjetra" me "njohuri të reja", të cilat mësuesi mund t'i ofrojë duke "ua treguar nxënësve". Përkundrazi, ai është një proces i vazhdueshëm, që shtrihet në një periudhë më të gjatë kohore, në të cilën grupe kontradiktore idesh dhe nocionesh konkurrojnë me njëri-tjetrin - dhe janë vetë nxënësit që ndërmarrin përpjekjen e analizës dhe të interpretimit e jo mësuesit.

"Të mësuarit përkundrejt zbatimit të tij në jetën reale"

Mësuesit që përpiqen të korrigjojnë gabimet e nxënësve, do të shohin se thjesht, "duke u treguar" atyre se çfarë është "e drejtë" shpesh nuk është e mjaftueshme. Ata përballen me problemet e mëposhtme:

- Nxënësit nuk duket se po "dëgjojnë": si të përballem unë me problemin se nxënësit, shpesh herë nuk i ndryshojnë idetë e tyre të gabuara, pasi atyre u janë mësuar faktet e koncepte e sakta etj?
- "Nxënësit mësojnë si papagaj": si mund të merrem unë me problemin se njohuritë e shkollës bashkëjetojnë së bashku me një lloj të menduarit naiv - me gabime në logjikë dhe në të menduar, mendime të bazuara në informacione të pasakta, në referenca të përvojës së përditshme, të cilat nxënësit nuk i lidhin së bashku? Ata i mësojnë njohuritë e tyre shkollë përmendësh, vetëm për testet dhe pastaj i harrojnë ato.

Çdo mësues i di këto probleme. Për t'i kapërcyer ato, edhe të mësuarit konstruktivist nuk është i mjaftueshëm. Nxënësit duhet të bëjnë diçka me atë që kanë mësuar. Ata duhet ta zbatojnë atë. Për një mësues kjo do të thotë, për shembull:

- asnjë leksion i pashoqëruar me një detyrë për t'u ndjekur;
- të dëgjohen nxënësit, për shembull, prezantimet, për të vlerësuar procesin e tyre të të mësuarit dhe arritjet;
- që t'i bëjë nxënësit përgjegjës për zhvillimin e tyre, për shembull, duke u caktuar mësimet nëpërmjet detyrave;
- që duhet të dëgjojnë reagimet e nxënësve : ajo çfarë unë vlerësoj të rëndësishme është ... Unë mësoj më mirë kur ...

Detyra e mësimit është që të ofrojë mundësi të përshtatshme për nxënësit për të mësuar dhe të diskutojë me ta për çfarë ecën mirë dhe çfarë jo. Të mësuarit konstruktivist, duke përfshirë edhe analizën dhe interpretimin nga nxënësit si dhe zbatimin e detyrave kërkojnë kohë. Prandaj mësuesi, ndoshta së bashku me nxënësit, duhet të bëjë zgjedhjen se cilat janë temat që meritojnë më shumë kohë për t'u trajtuar. "Bëj më pak, por bëj atë mirë."

Drejtimi i procesit të të nxënimit dhe përzgjedhja e formave të mësimdhënies

Fletë pune 3: Përzgjedhja e metodave të përshtatshme të mësimdhënies dhe të nxënimit

Në zgjedhjen e një forme të caktuar të mësimdhënies mësuesi merr vendime se si duhet të krijohej dhe të organizohen njësitë e mësimdhënies dhe mjedisit të të mësuarit. Kjo të çon në pyetjen se cilat forma të mësimdhënies, të mësuarit dhe të ndërveprimit shoqëror duhet të përfshihen dhe të harmonizohen me njëra-tjetrën, cila është koha e nevojshme për çdo hap mësimor dhe cilat janë materialet më të përshtatshme për këtë qëllim. Pyetjet në vijim ndihmojnë procesin e përzgjedhjes:

- Çfarë forma të mësimdhënies do të mbështesin proceset e synuara të të mësuarit?
- Cilat forma të ndërveprimit shoqëror do të përzgjedh?
- Çfarë strukturash dhe ritmi do të përzgjedh për kursin?
- Deri në çfarë shkalle, nxënësit mund të marrin pjesë në planifikimin e mësimit dhe në përzgjedhjen e formës së mësimdhënies?
- Duke pasur parasysh tablonë ekzistuese të kushteve të jashtme, cilat qasje të mësimdhënies janë të realizueshme?
- Në cilat metoda dhe stil mësimdhënieje unë jam më i efektshëm?
- Çfarë mund të bëj unë për krijimin e një atmosfere të mirë të mësuarit së bashku me nxënësit?
- A është stili i mësimdhënies sime i drejtë si për djemtë edhe vajzat?
- A inkurajojnë mësimet bashkëpunimin në klasë?
- A janë lënë hapësira të lira (zona, qoshe) ku nxënësit mund të tërhiqen të punojnë individualisht ose në grupe?
- A është klasa gjithmonë vendi më i mirë për të mësuar? A duhet të ndryshohet ose të ristrukturohet ajo? A ekzistojnë mjedise mësimore për qëllime të veçanta? A mund të jenë të dobishme ekskursionet ose eksplorimet?
- Sa liri mund t'u ofroj nxënësve të mi; si t'i vlerësoj aftësitë e tyre?
- A duhet të gjithë nxënësit të mësojnë në bazë të një rruge të paracaktuar? A është qasja ime e mësimit aq e individualizuar dhe aq fleksibile sa të përmbushë nevoja, ritme dhe aftësi të ndryshme të të mësuarit?
- A kanë nxënësit mundësi të zgjedhin procedura të ndryshme të mësuarit?
- Cilën pjesë të detyrave të shtëpisë kam në mendje?
- Cilat forma të ndërveprimit shoqëror janë të përshtatshme për zgjidhje në përputhje me veçoritë e kushteve, objektivave, përmbajtjes dhe proceseve të të mësuarit (punë individuale, punë në çifte, në grupe të vogla ose të mëdha)?

Drejtimi i procesit të të nxënës dhe përzgjedhja e formave të mësimdhënies

Fletë pune 4: Pesë format bazë të mësimdhënies dhe të mësuarit

Pesë qasjet metodike përshkruajnë, në një farë mnyre, pesë llojet ideale të mjediseve për të realizuar bashkëveprimin ndërmjet mësuesit dhe nxënësit.

Secila prej tyre lejon ose kërkon, që mësuesit dhe nxënësit të reagojnë dhe të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në mënyra të ndryshme.

Qasjet janë rregulluar në formë shkalle, që fillon me një formë klasike të punës që vë mësuesin në qendër (të mësimdhënies nëpërmjet prezantimit) dhe kalon, shkallë-shkallë, në format me në qendër nxënës.

Ne nuk propozojmë që format e mësimdhënies me në qendër mësuesin të zëvendësohen plotësisht nga format me në qendër nxënës. Përkundrazi, ne do të argumentonim vlefshmërinë e harmonizimit të këtyre formave, dhe që, në fund të fundit, duhet të shkojmë drejt një zhvendosje drejt formave me më shumë nxënës në qendër të mësimdhënies dhe të mësuarit.

Një vëzhgues sipërfaqësor mund të largohet me përshtypjen se puna me nxënës në qendër do të thotë rritje e përtacisë nga ana e mësuesit. Megjithatë, kjo nuk është aspak e vërtetë. Roli i mësuesit ndryshon, siç do të shpjegohet hollësisht më tej, por roli i tij ose i saj ndryshon nga veprimi i drejtpërdrejtë në klasë në atë të përgatitjes së kujdesshme, të ndihmës dhe mbikëqyrjes, të cilat në vend që të ulen vijnë duke u rritur në këtë proces.

Nxënësit të cilët duhet të mësohen se si të mësojnë dhe duhet, në rastin më ideal, të mbështeten nga të gjithë mësuesit e tyre në të gjitha lëndët. Një projekt i këtyre përmasave do të dështonte, nëse ai do të kufizohej në një ishull, le të themi, vetëm në punën e projektit në mes të një oqeani monotone metodike që përsëritet pafund "me mësimdhënien nëpërmjet prezantimit", duke i dënuar nxënësit që të mësojnë përmendësh.

Format themelore të mësimdhënies dhe të mësuarit të treguar këtu janë:

- mësim nëpërmjet prezantimit;
- të mësuarit eksplorues i drejtuar (diskutim në klasë);
- të mësuarit e hapur;
- mësimdhënia individuale;
- të mësuarit me projekte.

Forma e mësimdhënies dhe të mësuarit	Aktivitetet	Tiparet dalluese
Mësimdhënia përmes prezantimit	Tregimi, leksioni, leximi në klasë, raportime, ekspozita, shfaqje, paraqitje, mësimdhënia mes shembujve, demonstrimi	<ul style="list-style-type: none"> - Unë (mësuesi) mund të jap mësim për lëndën direkt, sipas situatave të dhëna në klasë, dhe reagimet e nxënësve janë direkt të dukshme. - Të gjithë nxënësit duhet të arrijnë të njëjtin objektiv – në të njëjtën periudhë kohe, në të njëjtën klasë dhe ambient, me të njëjtën metodë dhe me të njëjtat mjete. - Çështje të paracaktuara të lëndës u kalohen nxënësve.
Të mësuarit eksplorues i drejtuar (diskutim klase)	Dialogje, pyetje, nxitje, stimulim, drejtim, mbështetje	- Loja e brendshme e ekspozimit dhe stimulimit nga ana e mësuesit dhe kontributet e nxënësve.

Pjesa 2 - Teaching democracy and human rights

<p>Mësimi i hapur</p>	<p>Mësuesi: këshilla, meditim, mbështetje</p> <p>Nxënësit: përzgjedhje, planifikim, drejtimi i pyetjeve, zbulim, kërkim, projektim, dizenjim, analizë, të menduar, vëzhgim, kontroll</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësit mund të marrin pjesë në vendime. - Interesat, nevojat dhe iniciativat në emër të nxënësve kanë përparësi të lartë. - Mjedisi i të mësuarit inkurajon veprimtarinë në aktivitetet e nxënësve (fleksibilitet në caktimin e hapësirave dhe mjediseve, një shumëllojshmëri materialesh mësimore, një qoshe për eksperimentim, vizatim, etj.). - Marrëveshje të hapura për mjediset e të mësuarit. - Nxënësve iu jepet një shumëllojshmëri çështjesh dhe materialesh për përzgjedhjen e tyre personale. - Këtu përfshihen edhe mjedise të jashtme për mësimin. - Përzgjedhje e lire e aktiviteteve të të mësuarit. - Punë individuale, me partnerë ose me grupe.
<p>Të mësuarit individual</p>	<p>Mësuesi: diagnostifikon, drejton, instrukton, mbështet, këshillon, informon, kontrollon, supervizon, Motivon</p> <p>Nxënësit: përzgjedhin, modifikojnë dhe zhvillojnë programin e punës, lexojnë, analizojnë dhe vlerësojnë</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Mjedisi i mësimdhënies e të mësuarit është i specifikuar të plotësojë nevojat e nxënësit (sikundër janë përcaktuar nga njohuritë e mundësitë paraprake (aftësi dhe talente), formimi familjar etj.). - Përshtatja optimale e të gjithë elementëve në procesin e të Për nevojat dhe mundësitë e nxënësit si individ, domethënë, të kërkesave, objektivave, procedurave, metodave, kohës, medias dhe ndihmave (specifika multi-dimensionale). - Materialet didaktike, mbështetja nga media (kompjuterë, softe për të nxënëit, video klipe, fletë pune, modele, piktura për nxënësit, libra shkollor etj.). - Të nxënëit individual inkurajon efikasitetin, ekonomizimin e kohës dhe përpjekjeve, një trajtim sistematik, pavarësinë e mendjes dhe përgjegjshmërinë personale.

Pjesa 2 - Teaching democracy and human rights

<p>Të mësuarit në projekte</p>	<p>Mësuesi: ndërmjetësim, vëzhgim, këshillim, nxitje, mbështetje, organizim, koordinim</p> <p>Nxënësit: përcaktimi i objektivave, bashkëpunim, planifikim, diskutim, marrëveshje dypalëshe, grumbullim të dhënash dhe informacionesh, drejtim pyetjesh, zbatime, studime, eksperimente, teste, modifikime, dizenjime, krijueshmëri, prodhim, kontroll, vlerësim</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ndarja e interesave, shqetësimeve dhe objektivave të nxënësve janë vendimtare për përzgjedhjen e një çështjeje, trajtimit dhe detyrave. • Një problem i vërtetë (kompleks), i marrë nga jeta reale, ashtu si perceptohet nga nxënësi ose nxënësja shërben si pike fillimi. • Prioritet i jepet arritjes së rezultateve dhe trajtimit ndërlëndor (ndërkurrikular). • Nxënësit nxiten të hynë në përvojat e tyre personale; të nxënësit lidhet me praktikën në jetën reale. Ndërmarrjet afatgjata të cilat zhvillohen përmes një rendi të rregullt stadësh dhe fazash (iniciativa – vlerësimi i interesave dhe nevojave – vendimi për objektivat – përcaktimi i kufizimeve, domethënë, përjashtimi i objektivave të cilat nuk mund të arrihen – plan projekti; planifikimi – afatet finale; ekzekutimi; rishikimi dhe parashikimi për aktivitetet e ardhshme pas projektit, kontrolli dhe perfeksionimi, vlerësimi). • Ndarja dhe përcaktimi i detyrave: punë individuale, me partnerë, në grupe të vogla dhe të mëdha; bashkëveprim. • Nxënësit vizitojnë ambientet jashtë shkolle dhe konsultohen me prindërit e tyre ose ekspertët. • Puna në projekt inkurajon pavarësinë e mendjes dhe të nxënësit duke zbuluar përvojat dhe praktikat personale; bashkëveprimi social me të tjerët. • Mësimdhënia dhe të nxënësit nxisin nxënësit të veprojnë.
--------------------------------	---	---

Njësia 5

Vlerësimi i nxënësve, i mësuesve dhe i shkollave

1. Hyrje

Çfarë është e vërtetë për gjithë të mësuarit dhe mësimdhënien në kuadër të EQD/EDNJ? Si dhe pse duhet të vlerësohen nxënësit? A është vlerësimi i drejtë? A mbështet vlerësimi të mësuarit dhe procesin e të mësuarit? Në EQD/EDNJ këto pyetje duhet të trajtohen në detaje dhe për qëllime të ndryshme. Cilat kompetenca mund të vlerësohen? Cilat janë dijet thelbësore? A është më e rëndësishme të mësojmë përmendësh nenet e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut apo për ndërtimin e sistemit të drejtësisë në vend? Ne nuk mund japim ende një përgjigje përfundimtare për këto çështje që janë objekt edhe i një diskutimi ndërkombëtar.

Çdo lloj të mësuarit duhet të vlerësohet në bazë të suksesit të vet dhe ne do të dëshironim ta diskutonim këtë aspekt me kujdes. Një nga zgjidhjet për këtë pyetje është se cilën formë të vlerësimit do të zgjedhim! Nëse mësuesit dhe nxënësit e bëjnë vlerësimin e arritjeve gjatë dhe jo pas përfundimit të procesit të të mësuarit (vlerësimi formues), vlerësimi do të funksionojë si një lehtësues i të nxënësve dhe do të çojë në arritje më të mira. Ne duam të kontribuojmë për një kuptim më të gjerë të të mësuarit, duke paraqitur qasje të ndryshme dhe jo paragjykuese. Nuk është çështja nëse do të kemi vlerësim ose jo, por se cila do të jetë forma e vlerësimit në secilin moment të kohës dhe se cilat janë objektivat specifike të këtij vlerësimi. Prandaj, ne drejtojmë pyetje të tilla si ato për zgjedhjen e duhur të metodës së të nxënësve: nuk është e rëndësishme çështja e metodës së drejtë, por cila do të përdoret dhe kur.

EQD/EDNJ, siç e kemi përmendur shpesh herë, nuk ka të bëjë thjesht vetëm me një lëndë. Ato janë shumë më tepër. Ato janë koncepte, që në bashkëveprim, përcaktojnë atmosferën e mësimdhënies dhe të mësuarit. Kur vlerësojmë arritjet e nxënësve në EQD/EDNJ ne nuk kufizohemi vetëm në njohuritë e fituara, kompetencat e trajnuara dhe dijen brenda një pjese të lëndës që po testohet. Vlerësimi përfshin edhe veçori dinamike të tilla, si: qëndrimet, njohuritë, aftësitë ndërkurrikulare, si fleksibiliteti, komunikimi, aftësitë e ndërveprimit, argumentimit etj. Për këtë arsye, vlerësimi zhvillohet në dimensione të ndryshme. Kjo është e vlefshme për të gjitha lëndët. Ka edhe elemente të caktuara të EQD/EDNJ të cilat në nuk jemi në gjendje ose nuk dëshirojmë t'i vlerësojmë, si vlerat dhe qëndrimet, pavarësisht se ato mund t'i gjykojmë si pjesë të kompetencave që dëshirojmë t'i kalojmë te nxënësit.

2. Detyrat dhe çështjet kryesore për vlerësimin e nxënësve, mësuesve dhe shkollave

2.1 Detyra

Në procesin e planifikimit të mësimeve dhe të njësive mësimore, një aspekt që meriton vëmendje është problemi se si të kontrolloni dhe të siguroni përparimin e nxënësve në mësime, si të identifikoni përparimin që kanë bërë dhe si të vlerësohen rezultatet e të mësuarit të nxënësve dhe aktivitetet tuaja të mësimdhënies. Para se të zhvillohen mësime, ju duhet të planifikoni si të krijoni ose vlerësoni dhe të përmirësoni ndikimin dhe cilësinë e mësimdhënies tuaj dhe se si të regjistroni, analizoni, përmirësoni dhe gjykoni punën dhe aktivitetin mësimor të nxënësve tuaj. Duke vepruar kështu, ju do të merrni parasysh se me çfarë masash dhe instrumentash do të jeni në gjendje të identifikoni dhe të vlerësoni shkallën e realizimit të objektivave mësimore nga klasa ose nga nxënës të veçantë dhe, nëse është e nevojshme, të përcaktoni edhe kriteret ku do të bazoni sistemin e vendosjes së notave.

Në këtë kapitull ju do të gjeni më shumë informacion për vlerësimin e nxënësve, të mësuesve dhe të shkollës në tërësi.

2.2 Çështjet kryesore

Procesi i të nxënësve të nxënësve:

- Si identifikohet dhe vlerësohet mësimi i suksesshëm?
- Si aplikohet vetëvlerësimi dhe vlerësimi nga të tjerët?
- Si mund të sigurohem unë se nxënësit i kanë arritur objektivat?
- A e kanë përjetuar nxënësit, rregullisht, suksesin gjatë procesit të të mësuarit?
- A janë ata të vetëdijshëm për përparimin që kanë bërë?
- A i ofron mësimdhënia ime shans të barabartë për sukses si djemve edhe vajzave?
- A e bëjnë nxënësit në mënyrë të vetëdijshme vëzhgimin, kontrollin dhe përmirësimin e të nxënësve dhe të sjelljes së tyre në punë?
- A ju ishte ofruar nxënësve ndonjë udhëzime për t'i ndihmuar gjatë të mësuarit?
- A mundet nxënësit të kontrollojnë dhe vlerësojnë vetë sjelljen dhe rezultatet e tyre të të nxënësve?
- A mundet nxënësit të identifikojnë sjelljen e të mësuarit të kolegëve përmes vlerësimit mes tyre?
- Në vetëvlerësimin e tyre, a i referohen nxënësit edhe objektivave, standardeve, kritereve ose nevojat që kanë përcaktuar vetë?
- A e shoh unë përparimin e nxënësve si individë?
- Si i identifikoj unë problemet e mësimit të nxënësve si individë?
- Si i vëzhgoj unë ndërveprimet sociale në klasë?
- Si i mbaj unë të dhënat e vëzhgimeve dhe vlerësimeve për nxënësit si individë dhe për klasën në tërësi?

Procesi i të nxënësve të mësuesit:

- Si identifikohet dhe vlerësohet mësimi i suksesshëm?
- Në çfarë mënyre zbatohet vetë-vlerësimi dhe vlerësimi nga të tjerët?
- Si, kur dhe me kë mund reflektoj unë për mësimdhëniein time?
- Si i lejoj unë nxënësit e mi të marrin pjesë?
- Si e lidh unë suksesin ose dështimin e nxënësve të mi me mësimdhëniein time?
- Si e vëzhgoj unë përparimin tim në mësimdhënie, dhe si mund të mësoj unë si mësues?

Vlerësimi i nxënësve, i mësuesve dhe i shkollave


Fletë pune 1: Dimensione të ndryshme të vlerësimit

Dimensionet e ndryshme të vlerësimit të nxënësve përfshijnë tre nivele. Duke përdorur këtë model kubik, mund të shpjegohet ndërvarësia e tre dimensioneve.

Dimensioni 1 - këndvështrimi: nxënësit mund të vlerësojnë veten (vetëvlerësimi) ose ata mund të vlerësohen nga të tjerët (vlerësim nga të tjerët).

Dimensioni 2 - format: vlerësimi mund të ketë tre forma të ndryshme - vlerësimin e proceseve të të nxënësve, vlerësimin e arritjeve të të nxënësve dhe ai parashikues. Çdo formë ka avantazhet dhe disavantazhet e veta.

Dimensioni 3 - standardet si kriter: për vlerësimin një mësues mund të orientojë veten në një standard individual (nxënësi), në një standard objektiv (qëllimi të mësuarit) ose në një standard shoqëror (pozicioni i nxënësit në klasë). Kjo varet shumë nga standardi si kriter se çfarë ndikimi ka vlerësimi në të mësuarit e nxënësit në të ardhmen.



Para se të fillojmë të reflektojmë për dimensionet e ndryshme, ne duhet të pyesim veten se çfarë kompetencash po vlerësojmë. Në EQD/EDNJ kjo pyetje përgjigjet me tre kompetencat e diskutuara tashmë: kompetencën e analizave, kompetencën e arsyetimit politik dhe kompetencën e veprimit.

Në këtë drejtim, ne mund të ngremë pyetjet e mëposhtme, të cilat sillen rreth aspektit të përcaktimit të kriterëve dhe objektivëve të qarta për matjen dhe vlerësimin:

- A është e domosdoshmja që po testohet në vlerësimin e performancës së nxënësve (informacion i ruajtur përfundimisht, fakte të rëndësishme të veçantë, dhe përveç njohurive e fakteve të thjeshta, "mjetet e mendimit dhe të veprimit", shkathësitë dhe aftësitë)?
- Në shënimet në punët e nxënësve, a janë shënimet e qarta me kriterë që nuk keqkuptohen?
- A përputhen standardet e arritjeve në test me ato të programit mësimor?
- A janë përcaktuar paraprakisht të gjitha kërkesat që duhet të plotësohen për të arritur një notë të caktuar (nivelet e arritjeve)?

- A mundëson testi që nxënësit të kuptojnë se cilat pjesë të objektivave të të mësuarit janë arritur nga ata?
- A janë zhvilluar lloje të ndryshme të testimit për nxënësit me kushte të ndryshme fillestare?
- A munden nxënësit të kryejnë teste individualisht kur kjo duket e përshtatshme (për shembull, a mund të zgjedhin ata kohën e saktë të provimit)?


Vlerësimi i nxënësve, i mësuesve dhe i shkollave

Fletë pune 2: Qëndrimet për vlerësimin

Vlerësimet e brendshme dhe të jashtme e ndihmojnë një person të krijojë një tablo të përgjithshme për pozicionin e tij në lidhje me të mësuarit dhe të planifikojë hapat për të ardhmen. Të dy llojet e vlerësimit ndihmojnë gjithashtu për përcaktimin e qëllimeve të reja. Të gjithë njerëzit janë mësuar me vlerësimin nga të tjerët. Duke u vlerësuar nga njerëzit e tjerë, personi merr informacion nga nxënësit, mësuesit ose prindërit.

Vetëvlerësimi përshkruan aftësinë për të vlerësuar veten dhe për të nxjerrë pasojat e saj. Ai është një instrument thelbësor për të mbështetur nxënësit në autonominë e tyre dhe në largimin nga varësia e asaj çfarë mendojnë mësuesit për ta. Nxënësit që janë në gjendje të vlerësojnë realisht veten zhvillojnë edhe një pamje më të mirë të saj dhe do të jenë më pak të rrezikuar nga ndjenja e pasigurisë. Ata do të jenë më pak të varur nga reagimet e lavdërimit dhe mund të interpretojnë reagimet e mësuesve në mënyrë më të përshtatshme për ta.

Vetëvlerësimi dhe vlerësimi nga të tjerët nuk duhet të jenë domosdoshmërisht në harmoni të plotë, por duhet të dëgjohen në takime të përbashkëta, të mendohen gjatë dhe të diskutohen. Një nxënës nuk e sheh veten automatikisht në të njëjtën mënyrë si mësuesi. Këndvështrimet e ndryshme duhet të parashtrihen dhe të diskutohen. Në këtë mënyrë, mund të korrigjohen pika të paqarta, këndvështrime të ngushta ose ide fikse. Nxënësit duhet të mësojnë hap pas hapi si të vlerësojnë kompetencat dhe aftësitë e tyre si edhe si të ofrojnë reagime për nxënësit e tjerë, si të pranojnë reagimet e tyre dhe si të diskutojnë për to. Nëpërmjet këtij trajtimi hap-pas-hapi, vetëvlerësimi dhe vlerësimi nga të tjerët bëhen më të harmonizuar.



Vlerësimi i nxënësve, i mësuesve dhe i shkollave

Fletë pune 3: Qëndrimet dhe format e vlerësimit

Vlerësimi i proceseve të të mësuarit (formues)

Ky vlerësim i shërben përmirësimit, kontrollit dhe i verifikimit në procesin e të nxënësve nga ana e nxënësve ose të aktiviteteve të mësuesit dhe nxënësve për të arritur një objektiv të caktuar.

Vlerësimi i arritjeve të të nxënësve (përmbledhës)

Një vlerësim përfundimtar përmbledh njohurive dhe aftësive që ka fituar nxënësi në fund të një procesi të mësuarit. Qëllimi i tij kryesor është të informojë, për shembull, nxënësit ose prindërit në lidhje me nivelin e arritjeve të nxënësve.

Vlerësimi parashikues

Ky lloj vlerësimi synon zhvillimin e ardhshëm të nxënësve. Në faza të ndryshme gjatë karrierës shkollore të nxënësve, njerëzit e përfshirë në procesin e arsimimit të tyre (nxënësit, mësuesit, prindërit, në disa raste psikologët dhe autoritetet e shkollave) rekomandojnë si një nxënësi duhet të vazhdojë karrierën e tij.

Vlerësimi i proceseve të të mësuarit

Qëllimi kryesor në vlerësimin e proceseve të të mësuarit (ose vlerësimi formues) është të mbështetë nxënësit individualisht. Kështu, përmirësohet efikasiteti i mësimdhënies. Në vend që të luftohet me simptomat, shqyrtohen arsyet e fshehta të vështirësive të të mësuarit dhe trajtohen ato (këto arsye mund të jenë të karakterit njohës ose emocional). Gabimet nuk analizohen por korrigjohen. Në këtë mënyrë, idetë dhe mentaliteti i një nxënësi mund të kuptohet dhe mbështetet në një mënyrë të qëllimshme e të orientuar. Vështirësitë duhet të diskutohen së bashku me nxënësin dhe mund të trajtohen duke përdorur masa ose detyra të veçanta mbështetëse. Duke analizuar burimin e gabimeve, nxënësit nuk duhet të përshtaten sipërfaqësisht, as të ndihen në mëshirë të vështirësive të tyre. Në vend të saj, ata mësojnë se si të zhvillojnë strategji individuale për t'u përballur me problemet e tyre.

Nga ky këndvështrim, i mësuar i suksesshëm do të thotë një drejtim të vazhdueshëm i procesit të të mësuarit dhe i veprimit ndaj gabimeve nga të dy palët – si nga mësuesi edhe nga nxënësi - dhe jo thjesht kërkim për metodat më të mira.

Mundësitë e vlerësimit të proceseve të të mësuarit:

- vëzhgimet;
- teste të vogla të përditshme;
- testet pas një faze të gjatë pune.

Testet që vlerësojnë proceset e të mësuarit veprojnë si një tregues për procesin e mësimdhënies dhe të mësuarit. Ato i mundësojnë nxënësit dhe mësuesit të kontrollojnë nivelin e arritjeve. Mangësitë dhe pasiguritë mund të mbushen e plotësohen me detyra shtesë.

Mundësitë e testimit:

- vëzhgimi i nxënësve, ndërsa ata zgjidhin një detyrë;
- shikim dhe analizim i kujdesshëm i detyrave të përfunduara;
- biseda individuale rreth detyrave të përfunduara;
- drejtimi i pyetjeve rreth mënyrës së zgjidhjes së problemit;
- teste të shkurtra.

Përveç vëzhgimeve dhe bashkëbisedimeve për mënyrën e punës në detyra dhe rreth burimeve të gabimeve lindin edhe synime individuale që nxënësit i vënë vetes. Këto synime mund të vendosen nga mësuesi ose në bashkëpunim me të.

Pasoja që shoqëron këtë lloj vlerësimi është zhvendosja drejt:

- mësimit të orientuar drejt një qëllimi, në vend të të mësuarit e thjeshtë sipas përmbajtjes;
- mësimit të individualizuar në vend të mësimit ku të gjithë punojnë për të njëjtën detyrë.

Vlerësimi i arritjeve të të nxënësve

E thënë shkurt, vlerësimi i arritjeve të të mësuarit (ose vlerësimit përmbledhës) ofron një vlerësim të arritjeve të nxënësit. Ai përmbledh të gjitha njohuritë dhe kompetencat e fituara. Ai vepron si një instrument reagimesh për prindërit, nxënësit dhe mësuesit. Ajo mund të jetë baza e një mbështetje të orientuar drejt një qëllimi.

Këto lloje vlerësimi përdoren pas zhvillimit për një kohë të gjatë të njësive mësimore përmes vëzhgimeve dhe testeve. Ato informojnë përmes trajtimeve të ndryshme për shkallën në të cilën nxënësit kanë realizuar objektivat e ndryshëm. Shembuj të vlerësimit të arritjeve të të mësuarit janë të gjitha llojet e testeve, të cilat kontrollojnë njohuritë e akumuluar të nxënësve ose kompetencat në një pjesë të caktuar të lëndës për një periudhë të caktuar kohore (për shembull, kuice për demokracinë, teste matematike, teste fjalori, teste studimesh sociale). Vlerësimi i arritjeve të të mësuarit përdoret në shkollë, në të gjitha lëndët. Edhe pse ata janë të nevojshëm për notat e nxënësve dhe i japin mësuesit informacione të veçanta në lidhje me ecurinë e përgjithshme të nxënësve, ata bartin edhe probleme të ndryshme.

Si mjet informativ përdoren notat. Në lidhje me notat ka disa probleme ende të pazgjidhura:

- Mësues të ndryshëm e vlerësojnë të njëjtin arritje në mënyra të ndryshme. Vlerësimi nuk është objektiv. Në këtë këndvështrim, nuk ka rëndësi lënda në të cilën vlerësohet nxënësi. Një test matematike do të vlerësohej po aq ndryshe nga mësues të ndryshëm sa edhe një tregim me shkrim. Kështu, vlerësimi ndikohet fuqimisht nga mësuesi që i vlerëson. Kjo mund të jetë një çështje besimi për një nxënës dhe karrierën e tij individuale në shkollën e ardhme, në cilën klasë dhe me cilin mësues ai ose ajo e kalon kohën në shkollë. *Mund të thuhet se objektiviteti i vlerësimit nuk është i plotësuar si kriter.*
- Një mësues ka prirje të vlerësojë të njëjtën punë të një nxënësi në mënyra të ndryshme, në kohë të ndryshme. Vlerësimi nuk është i besueshëm. Pa marrë parasysh se cila lëndë është objekt i vlerësimit, një mësues do të vlerësojë në mënyra të ndryshme në kohë të ndryshme. *Mund të thuhet se kriteri i besueshmërisë nuk është përmbushur.*
- Nuk është e përcaktuar qartë se çfarë është e shprehur përmes një note (aftësitë, kompetencat, njohuritë, qëndrimet?). Kur mësuesit përdorin notat në vlerësimin e arritjeve të tyre ata integrojnë aspekte të ndryshme në notën e dhënë, të tilla, si: arritjet efektive në semestrin e kaluar, aftësinë e vlerësuar të arritjeve, përparimin në të mësuar ose përkeqësimin në krahasim me mesataren e motivimin e klasës, si dhe aspekte disiplinore. Është shumë e vështirë për nxënësin të zbulojë se çfarë nënkupton nota e marrë. Zakonisht, nxënësit nuk dinë për strategjitë e ndryshme të vlerësimit të mësuesve të tyre. Përmbajtja mund të jetë shumë dimensionale dhe hapësira për interpretim mund të jetë e madhe. Duke pasur parasysh funksionet e ndryshme të notave në shoqërinë tonë të tilla, si: kualifikimi, përzgjedhja dhe shpërndarja, interpretimi i notave bëhet edhe më i ndërlikuar. *Mund të thuhet se kriteri i vlefshmërisë nuk është përmbushur.* Për shumicën e funksioneve të mësipërme, notat sipas një vlerësimi të arritjeve të të nxënësve nuk janë tregues të dobishëm për shkollën e ardhshme ose suksesin në studimet profesionale.
- Praktika e zakonshme e notave sipas një vlerësimi të arritjeve të të nxënësve ka pasoja të rëndësishme e të pa dëshiruara: dhënia e notave brenda një klasë, sipas një shpërndarje normale, të çon edhe më shumë drejt përvojave të dështimit për shkollë me nxënës më të dobët nga ana akademike. Për shkak të vendeve të pakta, pas një shpërndarjeje normale, vendet e mira dhe shumë të mira janë të rezervuara për të njëjtët nxënës; të njëjtët nxënës do të mbeten gjithmonë në anën tjetër të vijës. Edhe në qoftë se përmirësojnë arritjet e tyre akademike ata përsëri do të vazhdojnë të mbeten po prapa liste. Prandaj, duke i renditur nxënësit sipas nivelit të arritjeve të tyre, të vlerësuar në kuadër të klasës, do të çojë vetëm në demotivim dhe humbje të interesit, sepse situata mbetet e pandryshueshme, veçanërisht për ata më të dobët.

- Notat nuk janë të zbatueshme në situata ose për dukuri të caktuara: mund të jetë e thjeshtë në lëndë si matematika për të arritur në një përgjigje të saktë ose të gabuar, por kjo bëhet e vështirë në lëndët e artit ose në ndonjë fushë tjetër krijuese të të mësuarit si dhe ato të gjuhës. Kjo është për shkak të mungesës ose të paqartësisë së kriterëve për vlerësim dhe për shkak të faktit se lëndë të ndryshme kërkojnë aftësi ose kompetenca të ndryshme. Në EQD/EDNJ diskutimi i formave të ndryshme të zgjidhjes së një problemi mund të çojë në ide shumë krijuese ose inovative, ndërsa në lëndët e tjera vetëm një përgjigje mund të merret si e saktë. Pra, ekziston rreziku që notat dhe dëshira për të qenë në gjendje për të vendosur nota për gjithçka për të vlerësuar të nxënëit me metodën e arritjeve, mund të çojë në uniformitet. Një kërkim krijues për mënyra të reja për zgjidhjen e kësaj detyre nuk mund të bëhet.
- Notat për aritmetikën matematikisht janë të pavlefshme: në mënyrë ideale, notat nuk mund të jetë më shumë se vlerësime të përafërta për një numër të përafërt nxënësish brenda klasës. Në këtë drejtim, madje edhe metoda shumë të sakta matematikore nuk mund të shërbejnë si një mjet për përmirësimin e kësaj situatë. Llogaritja e mesatares së një note, duke shtuar nota të ndryshme dhe duke e pjesëtuar përsëri me numrin e notave të dhëna, në mënyrë sipërfaqësore mund të shërbejë vetëm si një burim shtesë i sigurisë në vlerësim. Ajo mund të varet gjithashtu edhe nga koha kur është vënë ajo notë. Një nxënës i cili e fillon semestrin me një notë mjaft të ulët dhe përmirësohet gjatë kohës duhet të vlerësohet ndryshe nga një nxënës tjetër, notat e të cilit përkeqësohen gjatë semestrit. Edhe pse mesatarja e përllogaritur mund të jetë e njëjtë, statusi i arritjeve dhe progresit të të mësuarit të këtyre dy nxënësve nuk janë të barabartë.

Pas problemeve të lartpërmendura, vlerësimi i arritjeve të të mësuarit nuk duhet të jetë e vetmja mënyrë për grumbullimin e informacionit në lidhje me arritjet e nxënësve në EQD/EDNJ. Edhe kompetencat dhe aftësitë e fituara nga nxënësit duhet të maten duke zbatuar metodat e vlerësimit formues.

Vlerësimi parashikues

Vlerësimi parashikues vepron si një mjet për vlerësimin dhe parashikimin e karrierës së ardhshme. Vlerësimi parashikues kombinon aspektet themelore të marra nga një vlerësim i proceseve dhe i arritjeve të të mësuarit dhe përpiket të formulojë një diagnozë për të ardhmen e nxënësit. Kjo të çon në pyetje të tilla si: a mundemi ne të mbështesim zhvillimin individual dhe proceset pozitive të të mësuarit? Vlerësimi parashikues bëhet shumë i rëndësishëm në faza të ndryshme të jetës akademike të nxënësit:

- regjistrimi në shkollë;
- përsëritja e një viti;
- ndryshimi i klasës/shkollës;
- transferimi në lloje shkollash të ndryshme (për shembull, në një shkollë të arsimit special);
- transferimi në një nivel më të lartë shkollimi.

Në këtë aspekt, gjatë dekadave të fundit, diskutimet kanë vazhduar për çështje të tilla si a mundet të përshkruhet vlerësimi parashikues si një formë e vlerësimit apo është mirë të vlerësohet si një ndër funksionet e tij.

Vlerësimi i nxënësve, i mësuesve dhe i shkollave**Fletë pune 4: Standardet për vlerësimin**

Ekzistojnë tre standarde të ndryshme themelore si kritere për vlerësimin dhe vënien e notave për arritjet e nxënësve:

1. Kriteri individual: arritjet aktuale të nxënësit krahasohen me punën e tij të mëparshme.
2. Kriteri objektiv: arritjet e nxënësit krahasohen me objektivat e përcaktuara.
3. Kriteri social: arritjet e nxënësit krahasohen me atë të nxënësve brenda të njëjtës klasë ose të njëjtit grup moshe.

Tipi i kriterit	Kriteri individual	Kriteri objektiv	Kriteri social
Referenca	Përparimi i të mësuarit	Objektivat e të mësuarit	Kurba normale e shpërndarjes, e mesmja aritmetike, deviacioni
Informacioni	Sa është mësuar ndërmjet kohës 1 dhe kohës 2?	Deri në ç'shikallë është përballur nxënësi me objektivat e të nxënësit?	Sa i madh është deviacioni i përparimit individual nga ai mesatar?
Tipi i vlerësimit	Testet, vlerësimet me gojë, raporti i përparimi të nxënësit, forma e vëzhgimit të strukturuar	Testet me synime të orientuara, raport i përparimit të nxënësit, forma e vëzhgimit të strukturuar	Teste që përfshijnë një orientim me nota për mesataren e klasës
Pasojat pedagogjike	Shumë të larta	Shumë të larta	Shpesh përdoret për përzgjedhje; nuk është i rëndësishëm për orientimin drejt mbështetjes për nxënësit

Vlerësimi i nxënësve, i mësuesve dhe i shkollave**Fletë pune 5: Vlerësimi i nxënësve – ndikimi i vlerësimit në qëndrimin ndaj vetes**

Vlerësimi në shkollë është një fushë e gjerë. Ai jo vetëm që ka ndikim në gjërat e qarta e të vëzhgueshme, si: kualifikimet e nxënësve, pozicionimi i tyre në shoqëri për shkak të notave dhe në karrierën e tyre akademike. Vlerësimi në shkollë ka ndikim edhe në aspekte të tjera që lidhen me individin të tilla, si: imazhi për veten, vetëvlerësimi dhe koncepti i përgjithshëm që dikush ka për kompetencat dhe aftësitë e veta. Roli i shkollës në vetvlerësimin e kompetencave është rritur. Ndikimi i saj i drejtpërdrejtë varet nga mënyra e vlerësimit që është zgjedhur dhe që kryhet në shkollë.

Kriteri social

Për shkak të kontekstit shoqëror në të cilin zhvillohet të mësuarit në shkollë, përdorimi i kriterit social si masë, mund të japë informacion thelbësor rreth kompetencave, përmes krahasimit të nxënësve me njëri-tjetrin. Në të njëjtën kohë, vlerësimet rreth kompetencave në këndvështrimin social të krahasimit ndikon fuqishëm në krijimin e imazhit për veten dhe vetëvlerësimin e nxënësve.

Kriteri individual

Përdorimi i kriterit individual për vlerësimin nënkupton krahasimin e dallimeve ndërmjet individëve. Cili është dallimi mes arritjeve të nxënësve në EQD/EDNJ, përmes krahasimit të krahasuar me muajin e kaluar? Këtu kemi përdorur një krahasim të përkohshëm. Nxënësit e rinj priren veçanërisht të përdorin këtë kriter si instrument vlerësimi. Shuma e "vlerës së shtuar" regjistrohet për një sasi të caktuar të kohës. Kjo krijon mundësinë t'u ofrohen nxënësve informacione në lidhje me gamën e arritjeve të tyre, si dhe priren në ulje ose në ngritje të saj. Arritjet nuk krahasohen me arritjet e nxënësve të tjerë. Kriteri i krahasimit është përparimi i arritur. Kjo mënyrë e vlerësimit korrespondon gjithashtu me proceset e të nxënësve informal që ndodhin jashtë shkollës, ku nxënësit vlerësojnë kompetencat e tyre në mënyrë autonome.

Kriteri objektiv

Arritjet akademike krahasohen me objektivin e të mësuarit. Një përparim i arritur në mënyrë individuale në të mësuarit krahasohet me një objektiv realisht të arritshëm. Kjo mënyrë vlerësimit është një normë bazuar në objektiva dhe informon për qasjen ndaj një synimi të përcaktuar si arritja e përsosur. Krahasimi i arritjeve të nxënësve me përparimin e të mësuarit të nxënësve të tjerë nuk është me rëndësi. Testet e bazuar për kritere janë të orientuara drejt qëllimeve të mirë përcaktuara. Ato matin arritjen me referencë ndaj një karakteristike të caktuar të vendosur nga mësuesi. Kjo gjithashtu do të thotë se mësuesi duhet të ndërtojë dhe të paraqesë objektivat që nxënësit duhet të arrijnë në rezultatet e tyre. Kështu, arritjet e nxënësve nuk do të krahasohen me ato të nxënësve të tjerë. Sipas studimeve të ndryshme në këtë fushë, proceset shoqërore të krahasimeve mes nxënësve fillojnë vetëm kur nuk ka asnjë kriter objektiv të përdorur në vlerësim.

Cilat janë rezultatet e këtij diskutimi? Nëse një mësues dëshiron të forcojë imazhin e vetes dhe vetëvlerësimin e nxënësve të vet, duhet që vlerësimi të ndjekë kritere me një objektiv të caktuar. Synimet e përcaktuara nga mësuesi duhet të jenë të qarta dhe duhet t'i komunikohen nxënësve.

Vlerësimi i nxënësve, i mësuesve dhe i shkollave

Fletë pune 6: Listë kontrolli: "Si i vlerësoj unë nxënësit e mi?"

Kur vlerësojnë nxënësit, mësuesit duhet të kenë parasysh parimet të tilla të rëndësishme si:

- Vlerësimi duhet të jetë një mjet mbështetje: të ndihmojë për përcaktimin e pozicionit individual, të nxjerrë pika për punën e mëtejshme, të forcojë konceptin ndaj vetes dhe vetë imazhin e nxënësve.
- Vlerësimi duhet të ndihmojë nxënësit të vlerësojnë veten e tyre dhe t'ua garantojë atyre këtë mundësi.
- Vlerësimi duhet të jetë transparent: nxënësit duhet të dinë bazat e vlerësimit, kriteret e vlerësimit, si dhe normat e përdorura.
- Vlerësimi duhet të jetë i përshtatshëm me përmbajtjen dhe qëllimet. Njohuritë duhet të vlerësohen ndryshe nga aftësitë.
- Mësuesit duhet të kenë parasysh funksionin e përzgjedhjes që ata përmbushin kur vendosin notat. Në vend të vetëm vlerësimit përmbledhës, bisedat dhe raportet duhet të shndërrohen në metodat dhe mjetet e ardhshme të vlerësimit. Vetëm duke vepruar kështu ne mund të përmirësojmë transparencën brenda sistemit shkollor.
- Testet duhet të jenë të ndërtuara në atë mënyrë që të testojnë qasjen kundrejt qëllimeve të caktuara. (Testet ofrojnë gjithashtu informacion në lidhje me cilësinë e mësimdhënies që është përdorur për arritjen e këtyre objektivave: rezultatet e testimit, japin jo vetëm informacion në lidhje me arritjen e nxënësve, por edhe për cilësinë e mësimdhënies nga mësuesit.)

Pyetje për vetëvlerësim

- Procesi i të mësuarit të nxënësve:
- Si mund të sigurohem unë se nxënësit i kanë arritur objektivat?
- A kanë përjetuar nxënësit rregullisht suksesin e të mësuarit?
- A janë ata të vetëdijshëm për përparimin që kanë bërë?
- A u ofron mësimi im shanse të barabarta për sukses si djemve edhe vajzave?
- A e kryejnë nxënësit me vetëdije vëzhgimin, kontrollin dhe përmirësimin e të nxënësit të tyre dhe sjelljen e punës?
- A u është ofruar nxënësve ndonjë udhëzim për t'i ndihmuar ata në të mësuar?
- A mundën nxënësit të kontrollojnë dhe vlerësojnë vetë sjelljen dhe rezultatet e tyre të të mësuarit?
- A u referohen nxënësit, në vetëvlerësimin e tyre edhe objektivave, standardeve, kriterëve ose nevojave të tyre?
- A jam unë i ndërgjegjshëm për përparimin individual të nxënësve?
- Si mund të identifikoj problemet e mësimit të nxënësve si individë?
- Si mund të vëzhgoj ndërveprimin social në klasë?
- Si mund të mbaj një regjistër të vëzhgimeve dhe vlerësimeve për çdo nxënësi dhe për klasën në tërësi?

Disa pyetje në lidhje me procesin e të mësuarit të mësuesit:

- Si, kur dhe me kë diskutoj unë rreth mësimdhënies sime?
- Si mund t'i lejoj nxënësit e mi të marrin pjesë?
- Si mund ta lidh unë suksesin ose dështimin e nxënësve të mi me mësimdhënien time?
- Si mund të dalloj unë përparimin tim në mësimdhënie dhe si mund të mësoj unë si mësues?

Vlerësimi i nxënësve, i mësuesve dhe i shkollave

Fletë pune 7: Vlerësimi i mësuesve

Marrja e informacioneve në lidhje me arritjen e nxënësve është një nga parimet qendrore të shkollës³⁴. Marrja e informacioneve në lidhje me cilësinë e mësimdhënies është pjesë e trajnimeve profesionale. Në të njëjtën mënyrë, sikundër ne vlerësojmë procesin e të mësuarit dhe fitimin e kompetencave, aftësive dhe njohurive të nxënësve tanë, është po me aq me rëndësi që t'i bëjmë mësuesit të vlerësojnë mësimdhënien e tyre në EQD/EDNJ.

Pa një bazë solide të të kuptuarit të situatës aktuale të mësimdhënies nuk do të jetë e mundur që të bëjmë ndonjë rekomandim për përmirësim në të ardhmen ose ndonjë hap në zhvillimin e mëtejshëm të aftësive, metodave dhe praktikave të mësuesve. Por, sa të mirë janë mësuesit në vlerësimin e mësimdhënies së tyre? Në fakt, shumica e mësuesve priren të nënvlerësojnë arritjen e ardhshme të nxënësve të tyre. Për më tepër, ata shpesh nuk janë në gjendje të ndryshojnë metodat dhe stilin e tyre të mësimdhënies në një drejtim tjetër, nëse lind nevoja. Situata bëhet edhe më interesante kur merren parasysh këndvështrime të ndryshme të vlerësimit: në krahasim me të gjitha grupet e tjera të vlerësimit shkollor (nxënësit, prindërit, administratorët e shkollave etj.) vlerësimi i mësimdhënies së vetë mësuesve ndryshon në masë të madhe nga të gjitha formulimet e opinioneve të tjera³⁵. A duhet që t'i forcojmë mësuesit në besimet e tyre? A duhet që ata të fitojnë ndonjë kompetencë të re për të bërë një hap prapa dhe të vlerësojnë mësimdhënien e tyre në mënyrë kritike, por edhe realisht?

34. Helmke A. (2003), "Unterrichtsevaluation: Verfahren und Instrumente", *Schulmanagement*, 1, 8-11.

35. Clausen M. and Schnabel K. U. (2002), "Konstrukte der Unterrichtsqualität im Expertenurteil", *Unterrichtswissenschaft*, 30 (3), 246-60.

Vlerësimi i nxënësve, i mësuesve dhe i shkollave

Fletë pune 8: Vetëvlerësimi i mësuesve

Për praktikën e përditshme të shkollës, vetëvlerësimi i mësimdhënies është metoda më pragmatike dhe më e lehtë e vlerësimit. Zakonisht, këto lloj vlerësimesh kryhen automatikisht ndërmjet mësuesve, megjithëse jo në mënyrë sistematike. Në shumicën e rasteve, mësuesit reflektojnë për mësimdhënien e tyre sa herë që mendojnë se është e nevojshme ose sipas intuitës, kryesisht në rastet kur ata nuk janë të kënaqur me rezultatet. Për të lehtësuar këto procese reflektimi mund të ndihmojnë pyetjet e mëposhtme:

- Si e kam nxitur unë procesin e të mësuarit?
- Si mund të mbaj lart interesin e nxënësve për përmbajtjen e lëndës?
- A janë drejtuar nxënësit drejt problemeve dhe detyrave kryesore?
- A është i dukshëm thelbi i problemit në mësimin e dhënë?
- Sa pyetje drejtova unë?
- Çfarë lloj pyetjesh drejtova unë?
- Çfarë lloj pyetjesh drejtuan nxënësit?
- A ishin pyetjet të lidhura me problemet ose detyrat?
- Cili problem i shkaktoi pyetjet e bëra?
- A i kam dëgjuar sa duhet nxënësit e mi?
- A u respektuan rregullat e komunikimit të miratuara në klasë?
- Si u jam përgjigjur unë kontributeve të nxënësve?
- A po i përsëris kontributet e nxënësve fjalë për fjalë?
- A kam përdorur forma stereotipe të përforcimeve?
- A është nxitur bashkëveprimi ndërmjet nxënësve?
- Cila ishte përqindja e përafërt e kontributeve të mia?
- Cila ishte përqindja e përafërt e kontributeve të nxënësve?
- A ka pasur nxënës me përqindje jashtëzakonisht të lartë të kontributeve?
- Cila ishte pjesëmarrja e vajzave në krahasim me djemtë?
- Çfarë lloj kontributesh kanë ofruar të ashtuquajturit nxënës "të vështirë"?
- A jam përqendruar unë vetëm në disa nxënës?
- Si lindi situata e konfliktit?
- Cila ishte ecuria e konflikteve?
- Si u trajtua konflikti?
- A janë kuptuar nga nxënësit detyrat e dhëna?
- Si u integruan detyrat në proces?
- Çfarë lloj mjetesh mbështetjeje kam siguruar?
- Si u prezantuan rezultatet?
- Si ishin njohuritë, si janë regjistruar njohuritë ose gjetjet?
- Pyetje të tjera.

Kur përdoren lista kontrolli si kjo, duhet të theksohet se përdorimi i tyre ka kuptim vetëm nëse bëhet në bazë të njohurive solide, me baza shkencore dhe empirikisht të sigurta, rreth mësimdhënies dhe efekteve të saj. Në të gjitha rastet e tjera, përgjigjet e thjeshta për pyetjet do të çojnë në një akt të detyrueshëm dhe asgjë tjetër. Së dyti, shumica e listave të kontrollit të përdorura janë përzierjeje e aspekteve të ndryshme, por nuk paraqesin një tablo të plotë të të gjitha aspekteve që mund të lindin në një mësim të dhënë. Prandaj, kur përdoren listat e kontrollit është me rëndësi të veçantë që gjithmonë ato të lihen të paplotësuara ose të rezervohet një hapësirë për aspekte që nuk mund të parashihen paraprakisht.³⁶

36. Becker G. E. (1998), *Unterricht auswerten und beurteilen*, Beltz, Weinheim.

Vlerësimi i nxënësve, i mësuesve dhe i shkollave

Fletë pune 9: Puna me ditaret, shënimet, dosjet³⁷

Reflektimi për mësimdhënie përmes përdorimit të ditarëve të shkollës, shënimeve ose portofoleve mund të jetë një metodë ideale për vetëvlerësimin dhe një bazë e mirë për të filluar diskutimet didaktike dhe pedagogjike.

Ditaret e shkollës

Zakonisht, një ditar ndërtohet në një mënyrë të tillë që lejon një lloj dialogu (me një koleg, mësues shkollë ose nga një shkollë tjetër etj). Në një ditar shkollë, mësuesi shkruan për përvojat e tij ose të saj, në një farë mënyrë si ditaret personale, duke shprehur edhe interpretimet personale dhe ndjenjat për një mësim ose sjellje të caktuar ose mënyrat e bashkëveprimit që ka ndërmarrë. Një ditar lë hapësirë për vërejtjet personale dhe është i hapur për vërejtjet e një personi tjetër. Akti i futjes në dialog me dikë tjetër dhe leximi i vërejtjeve, interpretimeve dhe mendimeve për diçka që dikush e ka menduar më parë, krijon një nivel të lartë të reflektimit rreth proceseve të mësimdhënies dhe të mësuarit dhe ofron hapësirë të mtejshme për diskutim. Për reflektimin për mësimet e EQD/EDNJ është e rekomandueshme që mësuesit e kolegët e shkollës të jenë të familjarizuar me EQD/EDNJ.

Shënimet

Një libër shënimesh është një përshkrim i një procesi pa ndonjë koment ose vërejtje personale. Në një bllok shënimesh paraqiten fakte të pastra të cilat mund të lexohet përsëri nga mësuesi dhe të mundën të krijojnë kështu një shkallë reflektimi. Nga ky këndvështrim, një bllok shënimesh mund të krahasohet me një ditar ose liber ditari shkollë pa elementet e interpretimit dialogut personal. Përdorimi i shënimeve bën sens kur mësuesi i kthehet atyre relativisht brenda një kohe të shkurtër. Meqenëse një bllok shënimesh nuk përfshin ndonjë lloj vërejtjeje ose interpretimi të bëhet paksa i vështirë për të rikujtuar element të veçantë të mësimin që kanë ndodhur para një kohe të gjatë.

Dosjet

Një dosje për mësuesin është një koleksion i materialeve që janë krijuar dhe vendosur së bashku nga mësuesi. Ato kanë për qëllim të tregojnë pikat e forta të mësimin në EQD/EDNJ, si dhe fusha e identifikuar për zhvillimin e mtejshëm. Një dosje është menduar të jetë një instrument që tregon kompetencat e një mësuesi në një fushë të caktuar. Në trajnimin modern të mësimdhënësve, portofolet e trajnimit janë bërë një instrument i përbashkët për kualifikim. Në një kuptim të dytë, një portofol është edhe një instrument reflektimi. Ai ofron hapësirë për kritika dhe për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimit të mësimin, metodave, ndërveprimit me nxënësit etj. Elementet që mund të përfshihen në një dosje janë:

- biografi e shkurtër e mësuesit;
- përshkrim i klasës;
- mësimet e përzgjedhura (fletë pune, materialet e nxënësve);
- vlerësimet e produkteve të nxënësve;
- rezultatet e testimit (nëse ka ndonjë);
- deklaratë personale për filozofinë e mësuesit në mësimdhënien e EQD/EDNJ;
- produkte të tilla, si video ose fotografi nga mësimet të veçanta të EQD/EDNJ;
- mendime nga bashkëkolegë të cilët kanë vëzhguar mësimet në orët e EQD/EDNJ;
- dokumentacioni i projektit, nëse mësuesi ka kryer ndonjë në lidhje me EQD/EDNJ.

37. Metodave të sugjeruara në këtë fletë pune mund të përdoret edhe për nxënësit dhe janë instrumente të zakonshme të kulturës së mësimdhënies dhe të mësuarit në vende të ndryshme të Evropës.

Vlerësimi i nxënësve, i mësuesve dhe i shkollave**Fletë pune 10: Mësimdhënia në bashkëpunim dhe vlerësimi i kolegëve**

Pa dyshim, planifikimi i mësimëve në bashkëpunim për orët e EQD/EDNJ, së bashku me një mësues tjetër koleg mund të jetë një instrument i dobishëm për informacion të ndërsjellë dhe koordinim, si dhe për zhvillimin e orës së mësimi duke përfshirë vlerësimin e efektivitetit të proceseve të tilla³⁸

Planifikimi i përbashkët mund të kufizohet vetëm në përgatitjen e thjeshtë të një mësimi (si është bërë në shumicën e vendeve) ose në mësimdhënien e përbashkët të mësimi (së bashku, përmes mësimdhënies në ekip). Masat fillestare të bashkëpunimit për planifikimin dhe mësimdhënien kanë ende një përparësi të vogël në institucionet e trajnimit të mësuesve në shumë vende evropiane. Kultura e lënies së deryve të hapura për njëri-tjetrin është një proces që kërkon kohë të gjatë për t'u zhvilluar.

Mbetet një fenomen interesant që një numër mësuesish janë në mëdyshje për të punuar ngushtësisht me një koleg tjetër.³⁹ A mos ndodh kështu, sepse mungojnë modelet e praktikës së mirë? A mos kjo ndodh për shkak se mësuesit kanë frikë se do të duhet të shpenzojnë edhe më shumë kohë në shkollë? Apo mësuesit kanë frikë nga mundësia e vlerësimit nga kolegët?

Si një formë e planifikimit të mësimdhënies në bashkëpunim, për të kursyer kohën e çmuar, shërbejnë grupet kolegjiale dhe uljet e përbashkëta për EQD/EDNJ. Sugjerimet e mëposhtme mund të shërbejnë si udhëzues:⁴⁰

Madhësia e grupit:	Tre mësuesit vizitojnë njëri-tjetrin dy herë çdo mes viti (secili pret dy vizita dhe kryen katër vizita - ata gjithmonë shkojnë në dyshe).
Organizimi:	Tre mësuesit planifikojnë vizitat së bashku sipas planifikimit aktual në mënyrë të decentralizuar.
Aktualiteti i lëndës:	Mësuesit ndjekin mësimet e njëri-tjetrit në EQD/EDNJ. Cilat janë temat e tyre kryesore (ose lëndën që kanë dhënë më parë) e cilat nuk janë aktuale.
Ngritja e grupit:	Bashkimi në grup mund të ndodhë për shkak të simpatisë. Kjo siguron një nivel minimal të besimit
Detyra e drejtuesit:	Roli i drejtorit është që të mbajë shënimet e numrit minimal të vizitave mes tyre. Drejtori nuk duhet të përfshihet në pyetjet rreth përmbajtjes së çështjeve të mësimdhënies
Fokusi tematik:	Pyetjet që mund të jenë pikat e fokusit të këtyre takimeve mes kolegëve mund të lindin nga interesa ose marrëdhënie të ndryshme: a) një mësues dëshiron të marrë reagime për një pyetje të caktuar, b) një metodë/aktivitet i ri që është vendosur ose prezantuar duhet të vlerësohet tani ose c) duhet të vlerësohen parimet pedagogjike (për shembull, të formuluar në programin ose në profilin e shkollës).

Ka disa arsye për të shtuar elementin e mendimeve të bashkëmoshatarëve, të vëzhgimit dhe analizave të orës së përbashkët të planifikimit të mësimdhënies. Vëzhgimi i kolegëve gjatë mësimdhënies së EQD/EDNJ do të jetë vlerë shtesë pozitive për të fituar më shumë njohuri për mësimdhënien e lëndës. Ajo shërben jo vetëm si një instrument diagnostifikues, por edhe si një instrument për përmirësimin e stileve dhe metodave të mësimdhënies.

38. Helmke A. (2003), "Unterrichtsevaluation: Verfahren und Instrumente", *Schulmanagement*, 1, 8-11.

39. Po aty.

40. Klippert H. (2000), *Pädagogische Schulentwicklung. Planungs- und Arbeitshilfen zur Förderung einer neuen Lernkultur*, Beltz, Weinheim.

Arsyet për këtë janë në vijim⁴¹

- Të mësuarit si të japësh mësim është më efikas në një orë reale, sesa në një reflektim të përbashkët ose në një situatë hipotetike.
- Kur shqyrtohet një orë mësimore, shumë prej detajeve që e përbëjnë atë nuk mund të shpjegohen lehtë si: rutinat e veprimit, gjuha trupore, mimika, sjelljet e komunikimit etj.
- Ndryshimi i këndvështrimit dhe vendosja e një distance të caktuar gjatë vëzhgimit të një orë mësimi na ndihmon të vlerësojmë edhe cilësinë e mësimdhënies sonë.
- Vëzhgimi i një ore mësimi na shkarkon nga ndërmarrja e veprimeve. Ai krijon mundësi për të identifikuar më shumë detaje dhe për të fituar më shumë hapësirë për reflektim.
- Ekziston mundësia që të merren një numër sugjerimesh për çdo mësim të vëzhguar, që vlejnë për mësimdhënien tënde. Ndryshimet e personaliteteve dhe të stileve të mësimdhënies mund të jenë një burim interesant për shtysa pozitive, të cilat një mësues nuk mund t'i marrë në hapat e para të punës së tij si mësues.
- Ndjekja e orëve dhe të gjithë elementëve të planifikimit dhe të reflektimit përfshijnë diskutimin e çështjeve didaktike dhe metodike dhe janë pjesë e zhvillimit të shkollës, e cila si pikë fillestare ka pikërisht nivelin e mësuesit.

41. Leuders T. (2001), *Qualität im Mathematikunterricht der Sekundarstufe I und II*, Cornelsen, Berlin.

Vlerësimi i nxënësve, i mësuesve dhe i shkollave

Fletë pune 11: Vlerësimi i EQD/EDNJ në shkollë

Demokracia nuk është një mekanizëm automatik. Në njërin anë, demokracia është një arritje në historinë e demokracive të vjetra dhe, në anën tjetër, është rezultat i një procesi të gjatë e të qëndrueshëm i cili varet nga situata specifike në një vend. Qëndrimet demokratike nuk janë të dhënë nga natyra, por duhet të fitohen nga çdo individ me anë të përvojave në kontekstet shoqërore, në familje dhe në shkollë. Demokracia nuk mund të mësohet vetëm në mësimet e EQD/EDNJ. Demokracia duhet të shpalosë veten në strukturat e ndryshme joformale dhe formale të një shkolle. Prandaj, shkolla ka një rol kyç për një shoqëri të qëndrueshme demokratike. Për më tepër, "një shkollë e strukturuar dhe që funksionon në mënyrë demokratike jo vetëm promovon EQD/EDNJ dhe përgatit nxënësit e saj të zënë vendin e tyre në shoqëri si qytetarë të angazhuar demokratë: por ajo bëhet edhe një institucion më i lumtur, më krijues dhe më efektiv".⁴²

Shkollat mund të vlerësohen duke përdorur kritere të caktuara për identifikimin e cilësisë së mësimdhënies së EQD/EDNJ si edhe të shkallës së vlerave të jetuarit dhe ushtrimit të të drejtave të njeriut dhe demokracisë në shkollë. Kjo mund të bëhet duke përdorur praktikën e vetëvlerësimit.

Për vlerësimin e EQD/EDNJ në shkolla nevojiten tregues që pasqyrojnë fusha të ndryshme të shprehjes. Tri janë fushat kryesore:⁴³

1. kurrikula, mësimdhënia dhe të nxënit;
2. klima në shkollë dhe etika;
3. menaxhimi dhe zhvillimi.

Për më tepër, këta tregues e shpalosin EQD/EDNJ si një parim i politikës dhe të organizimit të shkollës dhe si një proces pedagogjik.

Në këtë vëllim ne sugjerojmë instrumentet dhe mjetet për vetëvlerësimin e një shkolle, që përfshijnë të gjithë pjesëmarrësit e saj e jo vetëm vlerësues të jashtëm. Vetëvlerësimi, në këtë kontekst, kërkon që vlerësimi të shihet si pikënisje e një procesi përmirësimi, jo si fundi i diçkaje që ka ndodhur.

Për një përshkrim më të hollësishëm të vlerësimit të një shkolle në drejtim të qeverisjes demokratike, ju lutem shihni fletët e punës nga 12 deri në 18.

42. Këshilli i Europës (2007), Qeverisja Demokratike e Shkollës, Strasbourg, fq. 6

43. Këshilli i Europës (2007), Qeverisja Demokratike e Shkollës, Strasbourg,

Vlerësimi i nxënësve, i mësuesve dhe i shkollave**Fletë pune 12: Treguesit e cilësisë së EQD/EDNJ në një shkollë**

Dokumenti i Këshillit të Evropës "Sigurimi i Cilësisë së Edukimit për Qytetari Demokratike në Shkollë" përfshin një grup treguesish të ndarë në nëntema dhe përshkrues, të cilët pasqyrojnë një cilësi të dëshiruar të EQD/EDNJ në një shkollë. Këto kritere mund të përdoren për gjykim dhe vlerësim. Zbatimi i tyre do të ofrojë një krahasim ndërmjet gjëndjes së një shkolle në lidhje me EQD/EDNJ dhe synimeve të dëshiruara.

Tabela më poshtë, pjesë e dokumentit të sipërpërmendur, mund të përdoret për vlerësimin e gjëndjes së EQD/EDNJ në një shkollë në bazë të treguesve të cilësisë.⁴⁴

Fushat	Treguesit e cilësisë	Nëntemat
Kurrikula, mësimdhënia dhe të nxënësve	Treguesi 1 A ka të dhëna për vendin e duhur të EQD/EDNJ në objektivat e shkollës, politikave dhe planit kurrikular?	<ul style="list-style-type: none"> Politikat e shkollës Planifikimi zhvillimit të shkollës në EQD/EDNJ EQD/EDNJ dhe kurrikula e shkollës Koordinimi i EQD/EDNJ
	Treguesi 2 A ka të dhëna të kuptimit të EQD/EDNJ nga nxënësit dhe mësuesit dhe të zbatimit të këtyre parimeve në praktikën e tyre të përditshme në shkollë dhe klasë?	<ul style="list-style-type: none"> Rezultatet e të nxënësve EQD/EDNJ Metodat dhe proceset e mësimdhënies dhe të nxënësve Monitorimi i EQD/EDNJ
	Treguesi 3 A janë planifikimi dhe praktikave të vlerësimit brenda shkollës në harmoni me EQD?	<ul style="list-style-type: none"> Transparenca Drejtësia Përmirësimi
Etika dhe klima në shkollë	Treguesi 4 A i reflekton si duhet etika e shkollës parimet e EQD/EDNJ?	<ul style="list-style-type: none"> Aplikimi i parimeve dhe vlerave të EQD/EDNJ në jetën e përditshme Lidhjet dhe modelet e autoritetit Mundësitë e pjesëmarrjes dhe vetshprehjes Procedurat për zgjidhjen e konflikteve dhe trajtimin e dhunës, ngacmimit dhe diskriminimit, përfshirë politikave të disiplinës
Menaxhimi dhe zhvillimi	Treguesi 5 A ka të dhëna të udhëheqjes efikase të shkollës bazuar në parimet e EQD/EDNJ?	<ul style="list-style-type: none"> Stili i udhëheqjes Vendim marrja Ndarja e përgjegjësisë, bashkëpunimi dhe puna në grup Përgjigjja
	Treguesi 6 A ka shkollë një plan të mirë zhvillimi që reflekton parimet e EDC/HRE?	<ul style="list-style-type: none"> Pjesëmarrja dhe përfshirja Zhvillimi profesional dhe organizues Menaxhimi i burimeve Vetë vlerësimi, monitorimi dhe llogaridhënia

(Këshilli i Europës, Qeverisja Demokratike e Shkollave, 2005, fq 58)

44. Kur u zhvillua ky instrument në vitin 2005, treguesit në tabelën e mësipërme u përshkruan si tregues të EQD. Shtesa EQD/EDNJ është bërë në këtë tabelë për këtë vëllim

Vlerësimi i nxënësve, i mësuesve dhe i shkollave

Fletë pune 13: Parime të përgjithshme për vlerësimin e EQD/EDNJ

"EQD/EDNJ është një koncept dinamik, gjithëpërfshirës dhe orientues për ecje përpara. Ai promovon idenë e shkollës si një bashkësi e të mësuarit dhe mësimdhënies për jetën në një demokraci, e cila shkon përtej çdo lënde shkollore të veçantë, mësimdhënies në klasë ose marrëdhënies tradicionale mësues-nxënës "(Këshilli i Evropës, Qeverisja Demokratike e Shkollave, 2005, fq. 80).

Vlerat, qëndrimet dhe sjelljet

Siç u vu në dukje në Pjesën 1 të këtij vëllimi, EQD/EDNJ ka të bëjë kryesisht me ndryshimin e vlerave, qëndrimeve dhe sjelljes. Si në të gjitha vlerësimet, qofshin këto nxënës, mësues ose shkolla, vlerësimi i dimensioneve si vlerat dhe qëndrimet është jashtëzakonisht e vështirë, sepse ajo mbart rrezikun e një interpretimi shumë subjektiv. Për më tepër, vlerat dhe qëndrimet jo vetëm shprehin veten në mënyrë të qartë përmes sjelljes direkte, por janë të përfshira qartë në mënyrën se si punon, komunikon dhe është e organizuar kjo shkollë.

Si të mblidhen të dhënat

Vlerësimi i EQD/EDNJ në një shkollë mund të bëhet në mënyra të ndryshme. Treguesit e EQD/EDNJ sigurojnë vetëm kuadrin e përgjithshëm të zhvillimit të mënyrave të ndryshme të grumbullimit të të dhënave ose për përcaktimin e metodave të ndryshme që do të përdoren për marrjen e informacionit.

Për këtë, pyetjet e mëposhtme mund të jenë të dobishme (po aty, fq 81):

Çfarë: Çfarë informacioni dhe provash duhen kërkuar?

- organizimi i shkollës
- vlerat dominuese në klasë
- të kuptuarit e koncepteve kyçe
- marrëdhëniet e autoritetit etj.

Ku: Cilit mjedis të mësuarit të EQD/EDNJ i referohen treguesit/nëntemat e dobishme dhe ku mund të gjenden dëshmi për të?

- mësimi në klasë
- takimi i mëngjesi
- puna në grupe brenda orës së EQD/EDNJ
- festime në shkollë
- java e projektit etj.

Materiali: Cilat dokumenta do sigurojnë informacionet e nevojshme?

- dokumenti i politikave shkollore
- kurrikula e shkollës
- statuti i shkollës
- karta e nxënësit

→ kodi i etikës i mësuesit etj.

Kush: Cilët persona/grupe të aktorëve do sigurojnë informacionin e nevojshëm?

→ nxënësit

→ mësuesit

→ prindërit

→ administrata vendore, OJQ-të, etj.

Si: Si duhet të grumbullohen të dhënat, cila metodë do të përdoret?

→ pyetësor

→ grupe fokusimi

→ diskutime

→ intervista individuale

→ vëzhgim etj.

Vlerësimi i nxënësve, i mësuesve dhe i shkollave

Fletë pune 14: Udhëzime për vet-vlerësimin e shkollave

Kur një shkollë vendos për t'iu nënshtruar vetëvlerësimit nëpërmjet EQD/EDNJ, ajo duhet të jetë e vetëdijshme për faktin se kjo mund të marrë një kohë të gjatë, ndoshta edhe një vit shkollor. Kjo mund të jetë gjithashtu edhe një periudhë sfide që përfshin shumë hapa dhe aktivitete të ndryshme.

Lista e mëposhtme, e marrë nga dokumenti "Sigurimi i Cilësisë së Arsimit për Qytetari Demokratike në Shkollë" (Këshilli i Evropës, Qeverisja Demokratike e Shkollave, 2005, fq. 73) mund të jetë ndihmë në mënyrë që të mbani mend udhëzimet kryesore:⁴⁵

- të ndërgjegjësohen të gjithë aktorët në lidhje me nevojën për dhe procesin e vetëvlerësimit të EQD/EDNJ, si një mjet për përmirësimin personal, profesional dhe shkollor;
- të sigurohet informimi i të gjitha palëve të interesuara për kornizën vlerësuese në EQD/EDNJ dhe qëllimin e saj;
- të përzgjidhet qasja më e përshtatshme për vetëvlerësim, duke u konsultuar me një gamë të gjerë të palëve të interesuara dhe ekspertëve;
- të hartohen mjete të vlefshme dhe të besueshme të vlerësimit (si pyetësorët, pyetjet e intervistës) me ndihmën e ekspertëve nga institutet kërkimore arsimore ose mjete të trainimit të mësuesve;
- të përgatitet stafi i shkollës dhe aktorët e tjerë për vlerësimin, duke përfshirë trajnimin e tyre në përdorimin e mjeteve të vlerësimit;
- të krijohet një klimë vërtetësisë, reflektimi të ndershëm, besimi, përfshirjeje, llogaridhënieje dhe përgjegjësie për rezultatet.



- Njih dhe zvogëlo kërcënimin e emrit të keq të vlerësimit
- Kupto sfidën e vetëvlerësimit si proces të mësuarit
- Zhvillo njohuritë dhe aftësitë e vlerësimit
- Forco angazhimin e gjithë përmirësimit të shkollës

45. Kur u zhvillua ky instrument në vitin 2005, treguesit në tabelën e mësipërme u përshkruan si tregues të EQD. Shtesa EQD/EDNJ është bërë në këtë tabelë për këtë vëllim

Vlerësimi i nxënësve, i mësuesve dhe i shkollave

Fletë pune 15: Përfshirja e aktorëve të ndryshëm në procesin e vlerësimit të EQD/EDNJ në shkollë

Kur një shkollë vendos t'i nënshtrohet një vetëvlerësimi, nevojitet një organizim i mirë. Në mënyrë ideale, duhet të ketë një person përgjegjës për drejtimin dhe mbajtjen e dokumentacionit të të gjithë procesit. Në shumicën e rasteve, ky do të jetë drejtori i shkollës ose një person tjetër i caktuar posaçërisht për këtë detyrë. Personi përgjegjës duhet të jetë i vetëdijshëm se drejtimi i këtij procesi kërkon shkallë të lartë koordinimi dhe lehtësimit, e jo thjesht një udhëheqje nga lart-poshtë. Siç është vënë në dukje në udhëzimet e vetë-vlerësimit të shkollave (Flete Pune 14), një proces i vetëvlerësimit nuk duhet të pengohet duke kërcënuar mësuesit ose nxënësit me aspekte të pushtetit ose kontrollit.

Për këtë arsye është e nevojshme qasja pjesëmarrëse dhe bashkëpunuese (Këshilli i Evropës, Qeverisja Demokratike e Shkollës, 2005, fq. 74).

Rekomandimet e mëposhtme përmbledhin faktet më të rëndësishme që lidhen me përfshirjen e aktorëve të ndryshëm.

Ngritja e një ekipi vlerësimi

Ekipi i vlerësimit mund të përbëhet nga shtatë deri në nëntë persona. Ky ekip mund të përfshijë drejtorin e shkollës, një ose dy mësues, një ose dy përfaqësues të nxënësve, këshilltarin shkollor (këtë rol mund ta luajë psikologu shkollor), një prind, një përfaqësues i bashkësisë lokale (ose përfaqësuesi i OJQ-së) dhe një përfaqësues nga një institut kërkimor ose institucion trajnimi mësuesish.


Detyrat e ekipit të vlerësimit janë si më poshtë (po aty, fq. 75f):

- të përgatisë mjetet e vlerësimit;
- të sigurojë trajnimin e stafit të shkollës në teknikat e vlerësimit dhe përdorimin e instrumenteve të vlerësimit në EQD/EDNJ;
- të sigurojë informacion dhe këshillim për vlerësuesit dhe palët e interesuara gjatë gjithë procesit;
- të monitorojë zbatimin e mjeteve të vlerësimit;
- të analizojnë dhe të interpretojnë gjetjet në bashkëpunim dhe konsultim me një gamë të gjerë të grupeve të interesit dhe ekspertëve të jashtëm;
- të përgatisë formularë të ndryshëm të raporteve për grupet e ndryshme të palëve të interesuara;
- të marrë dhe të analizojë komentet dhe sugjerimet e palëve të interesuara pas shqyrtimit të raporteve të tyre.

Shënim i rëndësishëm: në përgjithësi, mendimet e aktorëve të ndryshëm duhet të kërkohen dhe të krahasohen (për shembull, përmes pyetësorëve paralelë). Kryesore në këtë kontekst janë pikëpamjet e nxënësve në drejtim të përvetësimit të kompetencave të EQD/EDNJ, të tilla si: reflektimi, të menduarit kritik, përgjegjësia për përmirësimin dhe ndryshimin (po aty, fq. 77). Ajo që duhet të shqyrtohet nga ekipi i vlerësimit është dukuria e përgjigjeve "politikisht korrekte", të dhëna nga nxënësit në kontekstin e mësimdhënies dhe shkollës. Nëpërmjet përcaktimit të qartë të metodave të përdorura, kjo mund të reduktohet deri diku (intervista për bashkëmoshatarët, pyetësorë shumë të hapur, emrat e fshehur etj.).

Vlerësimi i nxënësve, mësuesve dhe shkollave
Fletë pune 16: Qeverisja dhe menaxhimi në shkollë⁴⁶

Një shkollë mundet të vlerësohet duke parë edhe mënyrën sesi janë reflektuar proceset e EQD/EDNJ në mënyrën se si është qeverisur shkolla. Në këtë drejtim, është përdorur termi "qeverisje demokratike e shkollës". Në këtë kontekst, janë të pranishme dy lloje procesesh që duhet të dallohen nga njëra-tjetra:



Kësisoj, menaxhimi përshkruan aspektet organizative dhe dimensionin teknik dhe operativ në një shkollë ose në sistemin arsimor. Nëpërmjet prezantimit të proceseve gjithnjë e më të hapura në shkollë, të cilat karakterizohen nga nevoja dhe interesa të ndryshme, është përdorur termi "qeverisje" (Këshilli i Evropës, Qeverisja Demokratike e Shkollave, 2007, fq. 9).

Përfitimet e qeverisjes demokratike të shkollës mund të përmbliken në këto pika (po aty, fq. 9):

- për të përmirësuar disiplinën;
- për të reduktuar konfliktin;
- për të bërë shkollën më konkurruese;
- për të siguruar ekzistencën e ardhshme të demokracive të qëndrueshme.

45. Për vlerësimin e shkollës nga pikëpamja e EQD/EDNJ ne kemi përgatitur tregues në fletën e punës 11.

Vlerësimi i nxënësve, i mësuesve dhe i shkollave**Fletë pune 17: Të përqendrohemi në qeverisjen demokratike të shkollës**

Për vlerësimin e gjëndjes së shkollës në lidhje me praktikën e EQD/EDNJ dhe lidhjeve në të mes të teorisë dhe praktikës ose mes politikës dhe demokracisë së jetuar, ne sugjerojmë matricën e mëposhtme (Këshilli i Evropës, *Qeverisja Demokratike e Shkollave*, 2007).

Çdo shkollë përfshin tre parime kryesore në lidhje me EQD/EDNJ. Këto janë:

- E drejta dhe përgjegjësitë;
- Pjesëmarrja aktive;
- Vlerësimi i diversitetit.

Në çdo shkollë ka gjithashtu fusha kyç ku shpalosen këto parime. Këto janë:

- qeverisja, lidhshipi dhe llogaridhënia publike;
- edukimi me në qendër vlerat;
- bashkëpunim, komunikimi dhe përfshirja: konkurrueshmëria;
- disiplina e nxënësit.

Matrica e mëposhtme tregon nivele të ndryshme të shprehjes së parimeve në të gjitha fushat.


	Të drejtat dhe përgjegjësitë	Pjesëmarrja aktive	Vlerësimi i diversitetit
--	------------------------------	--------------------	--------------------------

Qeverisja, lidhshipi,
menaxhimi dhe
llogaridhënia
publike

Arsimimi me
në qendër
vlerën

Bashkëpunimi,
komunikimi dhe
përfshirja

Disiplina e
nxënësit



Informacione më të detajuara për të kuptuar dhe përdorur këtë matricë ofron dokumenti "Qeverisja Demokratike e Shkollës" (www.coe.int/edc).


Vlerësimi i nxënësve, i mësuesve dhe i shkollave

Fletë pune 18: Si të analizojmë dhe interpretojmë rezultatet e vlerësimit të EQD/EDNJ

Ekzistojnë shumë mënyra për të analizuar, kategorizuar dhe interpretuar rezultatet e vlerësimit. Kur përdoret seti i treguesve të cilësisë për EQD/EDNJ, të sugjeruar në Fletën e Punës 12, një nga mënyrat më të efektshme dhe të lehta është që të fillohet me identifikimin e përparësive dhe dobësive në EQD/EDNJ. Këshilli i Evropës sugjeron përdorimin e një shkalle me katër nivele për këtë qëllim dhe në këtë mënyrë të bazohet çdo tregues sipas kësaj shkalle (Këshilli i Evropës, Qeverisja Demokratike e Shkollës, 2005, faqe 88.):

- Niveli 1 – dobësi të dukshme në shumicën ose të gjitha fushat;
- Niveli 2 – më shumë dobësi se pika të forta;
- Niveli 3 – shumë pika të forta se të dobëta;
- Niveli 4 – pika të forta në shumicën ose të gjitha fushat dhe nuk ka dobësi të rëndësishme.

Një mënyrë e mundshme për të paraqitur rezultatet nga një analizë e tillë është përdorimi i diagrameve, të cilat tregojnë arritjet e përgjithshme në EQD/EDNJ, duke renditur edhe treguesit e ndryshëm. Shembulli i mëposhtëm i një shkolle imagjinare tregon këtë



Kur përpiqeni të dilni në një përfundim, bëni kujdes që ai të mbulojë të katër fushat themelore (po aty, fq. 91):

- arritjet e shkollës në EQD/EDNJ në përgjithësi;
- gjëndja e shkollës për secilin tregues të cilësisë;
- aspektet më të suksesshme dhe më të dobëta të EQD/EDNJ në shkollë;
- pikat më kritike që mund të kërcënojnë zhvillimin e mëtejshëm të EQD/EDNJ në një shkollë.

Pjesa 3

**Instrumente për mësimdhënien dhe
të mësuarit e demokracisë dhe të
drejtave të njeriut**

**Njësia 1
Instrumente për mësuesit**

**Njësia 2
Instrumente për nxënësit**

Në EQD/EDNJ, dhe në mësimdhënien në përgjithësi, për mësuesin është e rëndësishme të reflektojë për objektivat dhe të sqarojë arsyet për zgjedhjet dhe prioritetet që duhet të realizohen në mënyrë të pashmangshme. Ai dëshiron të dijë se çfarë duhet të mësojnë nxënësit në EQD/EDNJ. Nëse nxënësve u duhet të mësojnë si të marrin pjesë si qytetarë në komunitetin e tyre demokratik, ata duhet të zhvillojnë kompetencat e analizës politike dhe gjykimit, kur këto kanë të bëjnë me problemet dhe çështjet politike, kompetencat e pjesëmarrjes në proceset vendimmarrëse politike, si dhe një përmbledhje të aftësive metodike. Kjo është e mundur vetëm në qoftë se ata do të mund të mësojnë në mënyra të ndryshme dhe të pavarur. Për ta bërë këtë, ata kanë nevojë për mbështetje. E njëjta gjë është e vërtetë për profesionin e mësimdhënies. Çdo specialist përdor mjetet e tij të veçantë. Ne paraqesim disa për mësuesit dhe disa për nxënësit që mbështesin, veçanërisht, EQD/EDNJ. Ato e bëjnë individin të pavarur. Pavarësia, për çdo qenie njerëzore, është edhe një qëllim në vetvete.

Njësia 1

Instrumente për mësuesit

1. Hyrje

EQD/EDNJ është një formë e veçantë e aktivitetit arsimor që ka qëllim të pajisë të rinjtë me aftësi që të marrin pjesë si qytetarë aktivë. Si e tillë ai shfrytëzon forma të veçanta të të mësuarit. Mësuesit duhet të jenë të rrjedhshëm në këto forma të të mësuarit dhe të jenë në gjendje për t'i vënë ato në praktikë në mjedise të ndryshme. Ato përfshijnë forma të ndryshme:

- të mësuarit induktiv – në vend që të fillohet nga koncepte abstrakte, nxënësit njihen me probleme konkrete për t'u zgjidhur ose për të cilët duhet marrë një vendim dhe inkurajimi i tyre për t'i përgjithësuar e përdorur në situata të tjera ;
- të mësuarit aktiv – nxënësit duhet të nxiten që të mësojnë duke bërë, në vend që thjesht t'u thuhet ose predikohet për të;
- të mësuarit e kontekstualizuar – hartimi i aktiviteteve rreth situatave reale në jetën e shkollës, të komunitetit ose të botës më të gjerë;
- të mësuarit bashkëpunues – futja e punës në grupe dhe të mësuarit bashkëpunues;
- të mësuarit ndërveprues – mësim përmes diskutimit dhe debatit;
- të mësuarit kritik – nxënësit nxiten të mendojnë për veten duke u kërkuar opinionet dhe pikëpamjet e tyre dhe duke i ndihmuar ata të zhvillojnë aftësitë e argumentimit;
- të mësuarit pjesëmarrës – nxënësve u jepet mundësia të kontribuojnë në mësuarit e tyre, për shembull, duke iu sugjeruar tema për diskutime ose hulumtime ose duke vlerësuar të mësuarit e tyre ose të atë të bashkëmoshatarëve.

Për të përmbushur këto plane, mësuesit kanë nevojë për mjete që të mbështetin nxënësit . Disa prej tyre janë veçanërisht të rëndësishme për EQD/EDNJ. Prandaj ato do të përshkruhen këtu në një formë shumë praktike.

Instrumente për mësuesit

Instrumenti 1: Të mësuarit e bazuar në projekte

Si të mbështetim të mësuarit me anë të përcaktimit të detyrave

Mësimdhënia dhe të mësuarit ndërveprues luan një rol kyç në shumicën e aktiviteteve të mësimdhënies të sugjeruara në këtë manual. Objektivat e mësimdhënies ndërvepruese janë njohja (që do të thotë, të menduarit dhe të kuptuarit), të mësuarit dhe veprimi. Çdo fazë e planifikimit të mësimi, monitorimit të detyrave, vlerësimit të rezultateve dhe pasqyrimit të gjithë procesit fsheh një potencial mjaft të pasur të të mësuarit për nxënësit .

Qasja themelore e integritit të të menduarit dhe të bërjes ka implikime për të gjithë procesin e të mësuarit. Kjo nuk do të thotë se, trajtimi aktiv i objekteve të të mësuarit është i kufizuar në fazat paraprake të mësimi "të vërtetë", e cila mendohet se përfshin vetëm mendjet e nxënësve. Përkundrazi, integrimi i të mësuarit dhe të bërit mund t'i japë të gjithë nxënësve një ide të qartë se pse ata mësojnë nëpërmjet të bërit të gjërave: ata kanë një detyrë për të bërë dhe kjo kërkon shumë aftësi dhe shkathtësi. Në këtë lloj të mësuarit, nxënësi duhet të përcaktojë nevojat e tij të mësuarit në çdo situatë të re që lind. Më tej ata do të kërkojnë udhëzime nga ana e mësuesit, që do të thotë se nxënësit përcaktojnë detyrat e mësuesve të tyre dhe jo anasjelltas. Të mësuarit e bazuar në detyra ofrojnë kombinimet më ideale të të mësuarit konstruktivist dhe të mësuarit sipas udhëzimeve.

Në të mësuarit e bazuar në detyra, nxënësit përballen me probleme që ata dëshirojnë të zgjidhin. Mësimi nuk është një qëllim në vetvete, por të çon në diçka të dobishme dhe kuptimplote. Nxënësit mësojnë të eksplorojnë mënyrat e zgjidhjes së një problemi, duke i caktuar vetes dhe mësuesit të tyre detyrat që hapin rrugën për zgjidhjen e problemit. Shkolla është jeta - ky lajtmotiv i EQD/EDNJ vlen edhe në të mësuarit e bazuar në detyra. Shumë situata të vërteta jetësore përbëhen nga gjetja e zgjidhjeve për problemet. Të mësuarit e bazuar në detyra përgatitin nxënësit për jetën, duke krijuar situata të jetës reale si mjedis për të mësuarit.

Të mësuarit e bazuar në detyra ndjekin një model që mund të përshkruhet në terma të përgjithshme. Nëse mësuesi qendron në këtë model, potencialet e të mësuarit duke bërë, që do të thotë, të mësuarit aktiv, do të shpaloset pothuajse vetë:

Elemente e të mësuarit të bazuar në detyra

Nxënësit përballen me detyrën që nevojitet të zgjidhet (paraqitur ose nga mësuesi ose nga libri).

Nxënësit planifikojnë veprimet e tyre.

Nxënësit zbatojnë planin e tyre të veprimit.

Nxënësit reflektojnë për procesin e tyre të të mësuarit dhe paraqesin rezultatet.

Është e rëndësishme që nxënësit të zbatojnë parimet e të mësuarit me bazë detyrat sa me shpesh në kontekste të ndryshme. Një detyrë e mirë, që i jep shkas problemeve që kanë nevojë të zgjidhen, është mjeti më i mirë për të krijuar një mjedis produktiv dhe interesant të të mësuarit.

Instrumente për mësuesit

Instrumenti 2: Të mësuarit në bashkëpunim

Kjo formë e mësimit nuk ka të bëjë thjesht me mundësinë e nxënësve për të punuar në grupe me shpresën se puna, deri diku, do të kryhet. Ajo çka nënkuptohet me këtë është një proces të mësuarit i zhvilluar sipas një modeli ose forme të caktuar, që është “transferuar” në fushën e të mësuarit social për shkak të mungesës së evidentimit të suksesit të njohjes. Megjithatë, shprehja “të mësuarit bashkëpunues”, është i përqendruar në arritjen e nxënësve.

Shpërndarja e qartë e roleve ndërmjet anëtarëve të grupit është një parakusht për mësimin e suksesshëm sipas modelit bashkëpunues. Në këtë pikë, detyra formale që sigurojnë statuse të barabarta shpërndahen dhe praktikohen mes anëtarëve dhe kjo çon në një të mësuar të suksesshëm. Kjo, megjithatë, e bën të qartë se, jo çdo detyrë është e përshtatshme për këtë lloj të mësimdhënieje dhe, për këtë arsye, këtu nuk nënkuptohet një marrëdhënie e polarizuar midis formave të mësuarit në bashkëpunim dhe mësimdhënies me mësuesin në qendër. Në këtë model të mësimdhënies, mësuesi luan një rol të qartë dhe kuptimplotë. Suksesi i të mësuarit bashkëpunues, si e kanë treguar shumë krahasime të orëve, është i varur nga elementet themelore. Procedurat e mëposhtme duket se janë provuar dhe testuar nga shumë mësues:

Mësimi bashkëpunues: Si të ecet në organizimin e një grupi

1. Emrat e anëtarëve të grupit vihen në listë sipas alfabetit
2. Çdo personi në grup i caktohet një prej roleve të mëposhtme

Moderatori: Ky person siguron që të gjithë anëtarët e grupit e kuptojnë detyrën dhe është edhe zëdhënësi i grupit.

Raportuesi: Ky person organizon paraqitjen e produktit përfundimtar

Menaxheri i materialeve: Ky person siguron që të gjithë materialet e domosdoshme janë në dispozicion dhe sigurohet që gjithshka është pastruar në fund të punës

Planifikuesi: Ky person siguron që grupi e menaxhon kohën e tij mire dhe kontrollon që grupi t'i qëndrojë besnik afateve të vendosura. Ky sigurohet që grupi të planifikojë veprimtarinë e tij në një mënyrë të arsyeshme në fillim të caktimit të detyrës dhe ta adoptojë atë sipas situatave.

Ndërmjetësi: Ky person zgjidh çdo problem brenda grupit

3. Rregullat

- a) Disa anëtarë të grupit kanë detyra/role të veçanta, por çdo person i veçantë është përgjegjës për të gjithë procesin dhe rezultatet e grupit.
- b) Nëse një pyetje duhet t'i drejtohet mësuesit ose drejtuesit të nxënësve, atëherë i gjithë grupi duhet të vendosë se cila pyetje duhet të drejtohet. Në këtë mënyrë, grupi vendos për pyetjen në mënyrë kolektive. Drejtuesi nuk i përgjigjet ndonjë pyetjeje individuale gjatë procesit të grupit.
- c) Çdo grup është përgjegjës për prezantimin. Çdo anëtar i grupit është përgjegjës për përgjigjet e çdo pyetjeje

Mësuesit të cilët punojnë me metodat e grupit deklarojnë se shpesh merr kuptim mbajtja e roleve nga nxënësit për një periudhë më të gjatë kohe. Kjo i ofron atij një lloj sigurie, shpejton të mësuarit, dhe përmirëson rezultatet në grup.

Instrumente për mësuesit

Instrumenti 3: Drejtimi i seancave plenare në orët e EQD/EDNJ (diskutim dhe mendim kritik)

Hyrje

Nxënësit ndajnë mendimet dhe idetë e tyre, të udhëhequr nga mësuesi. Kjo është e gjitha. Ambienti është i thjeshtë, kërkohet vetëm një dërrasë të zezë ose tabelë për të shkruar, ndërkohë që kërkesat për mësuesin janë të larta. "Dialogjet Sokratike" të Platonit shënojnë traditën e gjatë të kësaj mënyre të mësimdhënies dhe Sokrati fokusohej në problemizimin dhe analizën e pikëpamjeve të rreme ose dogmatike të partnerit të tij. Ne sugjerojmë një rol më të përshtatshëm për mësuesin në EQD/EDNJ - një më mbështetës, të tillë si ai i një trajneri. Aspekti i zhvillimit të kompetencave - nxënësit mësojnë se si të mendojnë dhe të ndajnë mendimet e tyre - është një objektiv po aq i rëndësishëm sa përmbajtja.

Nxënësit janë të angazhuar në një proces të menduari dhe të mësuarit konstruktivist ndërveprues. Mësuesi i mbështet ata. Në përgjithësi, të menduarit është përpjekje për të lidhur konkretën me abstrakten. Seancat plenare e trajtojnë aftësinë e nxënësve për të menduar. Të menduarit merr kohë. Nxënësit e kujdesshëm janë shpesh mendimtarë të ngadalshëm.

Vetëm shkolla mund t'i ofrojë seancat e drejtuara plenare si një format i të mësuarit. Ashtu si leksioni i mësuesit, ajo mund të përshtatet saktësisht me nevojat e nxënësit, shumë më tepër se çdo tekst ose video mësimore. Kritikët kanë vënë me të drejtë në dukje abuzimin me këtë format: ai është zbatuar shpesh dhe për një kohë shumë të gjatë; mësuesit drejtojnë pyetje për të cilat nxënësit nuk janë të interesuar dhe as nuk janë në gjendje t'u përgjigjen; mësuesit luajnë keq rolin e Sokratit, duke i trajtuar nxënësit si inferiorë dhe të gatshëm të ofrojnë atë që mësuesi dëshiron të dëgjojë. Por, nëse përdoren me mend dhe të gërshëtuar me praktikëm, seancat plenare janë një format i fuqishëm dhe fleksibël të mësuarit, për rrjedhojë edhe të domosdoshme në EQD/EDNJ. Lista e plotë e mëposhtme përshkruan potencialet mësimore dhe i jep mësuesit këshilla se çfarë të bëjë dhe çfarë të shmangë. Vëllimet II-V në këtë botim të EQD/EDNJ ofrojnë përshkrime të shumta të seancave plenare me nxënësit, nga niveli fillor deri në nivelin e mesëm të lartë. Pë këtë arsye, nuk janë përfshirë shembuj në këtë instrument.

Roli i nxënësve

Nxënësit:

- hyjnë në seancë me përvojën e tyre paraprake - në nivele të ndryshme dhe ata janë të interesuar në temën që po diskutohet;
- e dinë se kontributi i tyre është i mirëpritur dhe nuk ka nota për ide ose sugjerime "të gabuara";
- kanë pjesën e luanit në kohën që flitet;
- kanë nevoja të ndryshme të të mësuarit (për shembull: "mendimtarët e ngadaltë" - "folës të shpejtë").

Roli i mësuesve

Mësuesi:

- komunikon me klasën dhe është në gjendje dhe i gatshëm që të improvizojë, duke reaguar ndaj gjithçkaje që thonë nxënësit;
- kupton plotësisht temën dhe ka një ide të qartë për rezultatin e seancës;
- kontrollon, por nuk e dominon seancën plenare, duke marrë një pjesë të vogël të kohës që flitet;

- u jep nxënësve kohë të mjaftueshme për të menduar;
- dëgjon pa marrë shënime;
- dëgjon në mënyrë aktive, nxit shprehjen e ideve të cilat nxënësit i nënkuptojnë;
- nxit pjesëmarrjen e nxënësive dhe u drejtohet atyre që kanë prirje për të qëndruar të heshtur;
- vepron si mbajtës i kohës, menaxher grupi, menaxher procesi;
- i jep strukturë diskutimit, duke përdorur dërrasën e zezë (më e preferueshme se tabela), duke ofruar imazhe, simbole, shembuj, informacion, koncepte dhe korniza;
- identifikon nevojat e të mësuarit të nxënësve dhe reagon në përputhje me rrethanat. Ai udhëzon nxënësit për çështje që ata nuk i dinë dhe siguron që argumentet dhe linjat e mendimit që janë të gabuara ose jo të plota të kritikohen dhe shqyrtohen nga një nxënës ose mësuesi.

Tema të përshtatshme dhe kontekstet në EQD/EDNJ

Temat e përshtatshme përfshijnë:

- të punuarit me të dhëna të nxënësve (pyetje, komente, prezantime, detyra shtëpie, përvojën dhe ndjenjat);
- të punuarit me të dhëna të mësuesve (pyetje, të dhëna, foto, leksione);
- prezantimi i një koncepti të ri;
- ndjekja e një leximi ose detyre kërkimore;
- ndjekja e një faze të mësuarit me detyra - ose probleme (zbërthimi, reflektimi);
- vlerësim;
- zhvillimi i një hipoteze për hulumtime të mëtejshme.

Potenciali i të mësuarit

Nxënësit:

- krijojnë kontekstin për një koncept të ri që mësuesi e sjell me anë të udhëzimeve (të mësuarit konstruktivist);
- ushtrojnë zhvillimin e të menduarit – bërja e pyetjeve, vlerësimi i kujdesshëm i përgjigjeve që lidhin konkretën me abstrakten dhe anasjelltas (zhvillimi i kompetencës përmes demonstrimit të të menduarit analitik dhe gjykimit kritik);
- nxënësit ndajnë kriteret e tyre për gjykimin dhe pasqyrojnë arsyet për zgjedhjen e tyre të kriterëve (kompetencë e gjykimit ose e të mësuarit konstruktivist ndërveprues);
- përjetojnë klasën si një mikro bashkësi për të mësuar, në të cilën ata nxiten të marrin pjesë (të mësuarit përmes demokracisë dhe të drejtave të njeriut);
- trajtohen si ekspertë (forcimin e respektit për veten);
- vendosin pas shqyrtimit të mendimeve kundërshtuese për një çështje politike (simulimi i një vendimmarrjeje politike).

Përgatitja

Kriteret për zgjedhjen e një teme:

- Nxënësit duhet të jenë të informuar për këtë çështje (lidhjet me përvojën e nxënësve).
- Nxënësit kuptojnë rëndësinë dhe vlerën e temës për t'u diskutuar (lidhja me realitetin, interesi personal).
- Kundërshtitë: tema paraqet një problem dhe i lejon nxënësit të marrin qëndrime të ndryshme; mësuesi ka një këndvështrim personal, por ai nuk vlerësohet ose imponohet si "zgjidhja e duhur".

- Mësuesi ka në mendje një matricë që i lejon atij të parashikojë shumicën e asaj që nxënësit kanë gjasa të thonë dhe të integrojë idetë e tyre në një kuadër konceptual (për shembull, pro dhe kundër, kriteret e drejtësisë dhe efikasitetit, konkrete dhe abstrakte, interesa dhe kompromise).
- Nëse diskutimi nuk fillon me një të kontribut nga nxënësit, mësuesi mendon për fillimin e tij (për shembull, një pyetje ose një e dhënë).
- Mësuesi harton një përmbledhje të orës së mësimit, për shembull, një diagramë me një koncept të ri, një tezë ose një sërë fjalësh kyçe, që nxënësit e zhvillojnë në një tekst si vazhdim i detyrave të shtëpisë.

Gjëra "që duhen bërë"

- Kur jepni një të dhënë ose drejtoni një pyetje, jepuni nxënësve tuaj kohë për të menduar. Prisni për disa sekonda, pastaj u jepni fjalën disa nxënësve, njëri pas tjetrit.
- Variante (ato kërkojnë më shumë kohë, por përmirësojnë në masë të madhe cilësinë e të dhënave të nxënësve dhe të mësimdhënësve): kur ju ofroni një të dhënë ose drejtoni një pyetje:
 - jepuni nxënësve kohë që të shkruajnë idetë e tyre dhe i lejoni të marrin fjalën; nxënësit lexojnë deklaratat ose grumbullojnë idetë e tyre me shkrim në tabelë ose në një poster në formën e një klasteri;
 - lejojini nxënësit të ndajnë idetë e tyre në çifte dhe pastaj të prezantojnë rezultatet e tyre.
- Regulli themelor: "Një pyetje (ose ndërhyrje) e mësuesit - shumë përgjigje të nxënësve." Në aspektin e menaxhimit të kohës, kjo mund të jetë një seancë e plotë plenare, të cilën mësuesi e mbyll me përfundimet e tij.
- Sigurohuni që nxënësit të jenë ulur në një katror ose rreth, çka u lejon atyre t'i drejtohen dhe të shohin njëri-tjetrin.
- Sigurohuni që nxënësit të kuptojnë njëri-tjetrin. Nxitini ata të shpjegojnë idetë e tyre dhe çdo terminologji që nxënësit e tjerë nuk e dinë.

Gjëra "që s'duhen bërë"

Shmangni:

- drejtimin e pyetjeve të tipit po/jo. Nëse nuk e bëni këtë, do t'u duhet të bëni të tjera pyetje për të sqaruar të parën. Parapëlqehen pyetje të hapura ose të shpejta. Pyetjet vijuese mund të jenë më të forta dhe më specifike;
- tërheqjen në një diskutim me një ose dy nxënës. Përkundrazi, kalojeni pyetjen për klasën; - lënien mënjane ose shpërfilljen e pohimeve të nxënësve që ju kapin të papërgatitur. Ato mund të jenë më interesante! Këtu përsëri, përfshini klasën;
- komentin për çdo pohim të vetëm nga nxënësit me të cilat ju pajtoheni ose jo. Më mirë, ndihmoni nxënësit të identifikojnë pikat e forta ose dobësitë në argumentet e njëri-tjetrit;
- kufizimin e rolit tuaj për t'u kërkuar nxënësve të ngrenë duart. Shumë shpesh, nxënësit do të trajtojnë aspekte të ndryshme dhe nëntema dhe diskutimi mund të shkasë në konfuzion ose kaos. Prandaj, merrni iniciativën dhe vendosni ose sugjeroni se cila temë do të trajtohet e para. Nëse nxënësit vënë në dyshim përparësinë e temës së zgjedhur nga ju për t'u trajtuar, përdor argumentin se koha dhe përqendrimi janë të pamjaftueshëm për të diskutuar çdo gjë.

Mësuesi si improvizues - nxënësit ndezin një diskutim

Deri tani, ne kemi marrë në shqyrtim seancat plenare të cilat mësuesi i ka përfshirë në planifikimin e një mësimi të EQD/EDNJ.

Megjithatë, nxënësit mund të nxisin një diskutim në çdo kohë, shpesh përmes ndonjë vërejtjeje ose komenti që i jep jetë një çështjeje kundërshtuese ose polemike. Nëse koha e lejon, mësuesi duhet të japë nxënësve mundësinë për të vazhduar. Nevojat e tyre mësimore janë të dukshme. Ata, ose të paktën disa prej tyre, janë të interesuar në një çështje.

Shembuj:

- "Në fund, ju mund të mbështeteni vetëm në familjen tuaj."
- "Unë mendoj se për disa njerëz dënimi me vdekje do të ishte një ide e mirë."
- "Çfarë ndodh me politikanët që i thyejnë premtimet e tyre elektorale?"
- Një nxënës i referohet një çështjeje aktuale nga lajmet e përditshme.

Në një situatë të tillë, nxënësit i vendosin një detyrë mësuesit të tyre. Ai duhet të drejtojë një diskutim pa përgatitje paraprake, vetëm duke improvizuar. Mësuesit nuk duhet të tremben nga një situatë e tillë. Zakonisht mësuesi duhet të ketë në zotërim temën, ndërkohë që mënyrat e bashkëveprimit janë të njëjta si në çdo seancë plenare të përfshirë në një plan mësimor. Një situatë e ngjashme lind kur nxënësit i kërkojnë mësuesit të japë një shpjegim të papërgatitur ("çfarë do të thotë demokracia?").

Këtu janë disa këshilla si të reagoni në diskutime spontane:

- Kërkojini nxënësit që filloi diskutimin ta shpjegojë çështjen në klasë. Kjo u jep të gjithëve mundësinë për të marrë pjesë, kurse juve, kohë për të menduar.
- Qartësoni sa kohë doni të lini mënjane. Vendosni si do të vazhdoni me temën dhe mësimin pas diskutimit.
- Kur dëgjoni nxënësit tuaj, bëni kujdes të kuptoni atë që ata dinë dhe kanë ose nuk kanë kuptuar.
- Merrni iniciativën të bëni një përmbledhje të diskutimit ose konkluzionet e tij. Kjo mund të mos jetë e së njëjtës cilësi si ajo për të cilën ju keni pasur kohë ta mendoni më parë, por për nxënësit është më mirë se të mbyllin diskutimin pa, të paktën, një deklaratë paraprake, e cila do të justifikonte arsyen përse diskutimi u zhvillua dhe përfundoi në atë mënyrë.
- Ju mund ta caktoni këtë edhe si një detyrë për t'u vazhduar nga nxënësit tuaj, por vetëm nëse keni një zgjidhje në mendje.

Instrumente për mësuesit

Instrumenti 4: Intervistë me një ekspert – Si të mbledhim informacion

Në EQD/EDNJ ka shumë situata kur nxënësve u nevojitet të grumbullojnë informacione, duke intervistuar njerëzit jashtë klasës.

Këto intervista mund të bëhen brenda klasës ose një grup i nxënësve të klasës mund t'i vizitojë ata jashtë ambienteve të saj.

Të intervistuarit mund të jenë ekspertë, në kuptimin e ngushtë të fjalës, të tillë si: anëtar i një parlamenti kombëtar ose vendor, përfaqësues i një bordi administrativ ose një shkencëtar. Por ata mund të jenë edhe persona që kanë përvojë sociale ose profesionale, të tillë si: punonjës me turne, nënë e vetme, migrant, i papunë etj.

Këtu ne do të lëmë mënjane çështjen se cili i fton ekspertët. Në shumicën e rasteve, ky do të jetë mësuesi, por kjo detyrë mund t'u delegohet edhe nxënësve, veçanërisht atyre të arsimit të mesëm. Përkundrazi, ne do të përqendrohemi në çështjen e përgatitjes dhe kryerjes së intervistës.

Sigurisht duhet të shmanget skenari në të cilin mësuesi ose një numër i vogël nxënësish të intervistojnë një ekspert, ndërkohë që pjesa tjetër e klasës i vëzhgon, pa kuptuar arsyen pse drejtohen disa pyetje të caktuara. Një intervistë përfshin kompetenca që janë të dobishme në çdo lloj pune me projekte, studime të fushës ose punë më të avancuara në shkencë ose media.

Një procedurë standarde model për përgatitjen e një intervistë me një ekspert përfshin hapat e mëposhtëm:

1. Nxënësit identifikojnë një çështje të rëndësishme që meriton një studim më të hollësishëm.
2. Mësuesi sugjeron që nxënësit të intervistojnë një ekspert. Ai kontakton ekspertin dhe përcakton një datë për intervistë, qoftë në klasë ose në një vend jashtë shkolle.
3. Mësuesi u shpjegon nxënësve se cila është detyra e tyre: në kohën në dispozicion për intervistë (45-90 minuta), nxënësit mund të drejtojnë një numër pyetjesh të rëndësishme. Meqenëse për secilën nga këto pyetje kyç do të duhet pak kohë për t'u përgjigjur dhe përgjigjet do të shkaktojnë disa pyetje shoqëruese, nxënësit do të duhet të vendosin se në cilat pyetje dhe çështje duhet të përqendrohen. Nxënësit do të formojnë grupe, në të cilat secili do të jetë përgjegjës për një pyetje kyçe. Secilit grup do t'i caktohet një periudhë e caktuar kohore (10-15 minuta) për të intervistuar ekspertët. Është e rëndësishme që nxënësit të kuptojnë këtë strukturë dhe qëllimin e saj, pra mësuesi duhet t'i përgjigjet çdo pyetjeje me durim dhe me kujdes.
4. Në seancën plenare, nxënësit angazhohen për të përgatitur pyetjet ose idetë e tyre. Ata shkruajnë të gjitha pyetjet që dëshirojnë, në karta ose rip letre, duke përdorur një kartë të re për çdo pyetje. Për të kursyer kohë, mësuesi mund të kufizojë numrin e kartave për çdo nxënësi në dy ose tre. Pas 5-8 minutash, këto pyetje grumbullohen në dërrasën e zezë ose në tabelë, kurse nxënësit dalin përpara dhe paraqitin idetë e tyre.
5. Pyetjet ndahen sipas temave ose sipas çështjeve kryesore me të cilat lidhen. Nxënësit më pas vendosin për pyetjen kyç që do të përdoret në intervistë dhe për radhën e paraqitjes. Në një seancë 60 minuta, nuk duhet të drejtohen më shumë se katër pyetje të rëndësishme. Si rregull, e para duhet të jetë rreth vetë personit, në mënyrë që nxënësit të kenë një ide se me cilin janë duke folur. Dhjetë minutat e fundit duhet të lihen për një diskutim të hapur ose për pyetje shtesë nga ana e nxënësve të veçantë.
6. Nxënësit hyjnë në grupe. Ata marrin kartat me sugjerimet e nxënësve nga bordi ose tabela dhe vendosin nëse duhet të përfshihen në intervistë ose jo.
7. Nëse nxënësit nuk kanë përvojë në intervistime, mësuesi duhet të ofrojë një udhëzim të shkurtër për teknikën themelore të intervistimit. Pyetja e hapjes duhet të jetë e gjerë në shtrirje, duke lejuar të intervistuarin të ofrojë një gamë të gjerë informacioni dhe fjalësh kyç. Nxënësit mund

të bëjnë pyetje të tjera më të orientuara drejt qëllimit. Në përgjithësi, duhet të shmangen pyetjet, përgjigja e të cilave është po ose jo, sepse një pyetje e re është e nevojshme më pas. Nxënësit duhet gjithashtu të sigurohen që të mos përziejnë diskutimin me intervistën ("A nuk jeni ju dakord me mua se ...?").

8. Në fund, nxënësit duhet të kenë një listë prej katër deri në gjashtë pyetje të cilat ata i kanë renditur dhe përgatitur. Për të ndërtuar besimin, klasa mund të parapërgatisë intervistën në një aktrim dramatik, me mësuesin që vepron si ekspert.
9. Është e rëndësishme që, gjatë intervistës, të qartësohen rolet e anëtarëve të ekipit. Kush do të pyesë dhe cilat pyetje do të bëjë? Kush do t'i regjistrojë përgjigjet? Kush zëvendëson një anëtar të grupit që mungon në ditën e intervistës? Intervistuesit duhet të jenë në gjendje të mbajnë kontakte me sy me të intervistuarin, kështu që ata do të mbështeten nga një ose dy mbajtës shënimesh (shih modelin e pyetësorit më poshtë). Nuk është e këshillueshme të përdoret një regjistruer me kasetë, sepse shkrimi i tekstit të regjistruar kërkon shumë kohë. Përkundrazi, ata duhet të përqendrohen në pikat e domosdoshme dhe të zbardhin shënimet e tyre në një tekst të plotë nga kujtesa menjëherë pas intervistës.
10. Pas intervistës, ekipet raportojnë në klasë, me gojë dhe/ose me shkrim. Në varësi nga mediet në dispozicion, kjo mund të jetë me fletë projektimi, gazetë muri ose dokument elektronik. Tani është koha për t'ju referuar kontekstit që e bëri të mundur intervistën. A e morëm ne informacionin që na nevojitej? Çfarë kemi mësuar? Çfarë pyetje të reja na kanë lindur?
11. Nxënësit duhet të analizojnë procesin dhe aftësitë që kanë fituar si dhe problemet që kanë hasur. Kjo do t'i japë mësuesit informacion të rëndësishëm për planifikimin e detyrave të ardhshme.

Fletë planifikimi për një ekip interviste

Intervistë me _____

Data: _____ Vendi: _____

Koha në dispozicion për ekipin: _____ minuta.

Ekipi Nr. _____ Çështja: _____

Anëtarët e ekipit:

Nr.	Çështjet kryesore	Intervistuesi	Mbajtësi i shënimeve

Instrumente për mësuesit

Instrumenti 5. Si të përcaktojmë objektivat e mësimdhënies që bazohen në kompetencat ⁴⁷

1. Standardi i Kurrikulës (vetëm një):		
2. Ju lutem përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme: Çfarë është në gjendje të bëjë një nxënës kur ka përfutuar kompetencën e synuar?		
Përshkrim:		
3. Ju lutem përshkruani çfarë duhet jetë i aftë të bëjë një nxënës dhe pastaj mendoni për nivelet më të përparuara të arritjeve.		
Pasi nxënësit e mi të kenë marrë pjesë në disa mësimë të EQD/EDNJ ...		
... më e pakta që unë do të shpresoja nga çdo nxënës është që ai të jetë i aftë të ajo që unë dëshiroj që nxënësit e mi të jenë të aftë të bëjnë është aktualisht unë shpresoj se nxënësit e mi do të jenë në gjendje të ...
“Standardi minimal” (pranueshëm)	“Standardi i rregullt” (i kënaqshëm)	“Standardi ekspert” (mirë)

47. Shih kapitullin e këtij volumni për kompetencat në EQD/EDNJ. Ky Instrument është bazuar në Ziener G (2008), *Bildungsstandards in der Praxis. Kompetenzorientiert unterrichten* (2nd edn), Seelze-Velber, p. 56.

4. Hapat e parë të planifikimit të mësimit të EQD/EDNJ		
Objektivat	Fjala e mësuesit	Veprimtaritë dhe detyrat e nxënësve

Njësia 2

Instrumente për nxënësit

1. Hyrje

Mësuesit e EQD/EDNJ mund të jenë të përsosur në planifikimin dhe përgatitjen e mësimit. Por, pavarësisht përgatitjes së mirë të një ore mësimi, ajo mund të shkojnë edhe keq në qoftë se mësuesit harrojnë të marrin në parasysh aftësitë e nxënësve në disa teknika të caktuara. Kjo mund t'i ndodhë edhe mësuesit më të mirë dhe me përvojë. Një orë mësimi mund të ecë mirë vetëm nëse edhe nxënësit kanë një repertor të caktuar të metodave dhe dinë se si t'i përdorin ato.

Nga përvoja e fituar në programet e ndryshme për mësuesit e EQD/EDNJ në të gjithë Evropën, ne kemi vendosur të përfshijmë në këtë vëllim këtë Instrument. Ky grup udhëzimesh, fletësh pune, instrumentesh dhe listash kontrolli mund të veprojnë si një bazë të dhënash në rstat kur nxënësit nuk janë të familjarizuar me një metodë ose teknikë të caktuar.

Është detyrë e mësuesit që të shpjegojë kur dhe si do të përdoret secili mjet. Është po detyrë e mësuesit të vendosë se kur dhe cilin instrument do të paraqesë për nxënësit, nëse instrumenti është diçka fikse, që shfaqet në klasë, lehtësisht e arritshme në çdo kohë ose mund të përdoret edhe për detyrat e shtëpisë.

Seti i mëposhtëm i mjeteve mund t'i ndihmojnë nxënësit në kryerjen e disa detyrave si:

- të mbledhë dhe të kërkojë për informacion;
- të përzgjedhë informacionin tuaj;
- të prodhojë punë krijuese;
- të paraqesë punën tuaj;
- të punojë me nxënësit e tjerë.

Çdo instrument fillon në një faqe të veçantë. Ai mund të lexohet individualisht nga nxënësit ose së bashku, në çifte ose në grupe të vogla.

Instrumente për nxënësit

Instrumenti 1: Fletë pune për nxënësit për të planifikuar të nxënit e tyre

- Unë do t'i vë vetes objektivat e mëposhtme - për kapitullin e ardhshëm / njësinë / sot etj:
...
- Sot unë do të trajtoj detyrat e mëposhtme: ...
- Unë jam veçanërisht i interesuar në:...
- Unë kam vështirësi, veçanërisht, në: ...
- Unë kam ndërtuar planin e mëposhtëm: (Çfarë do të bëj fillimisht? Çfarë do të bëj më pas?
Ku do të mësoj? Kur do të bëj pushim? Kur do të përfundojë punën time?)
- Unë do të diskutoj planin tim me: ...
- Unë do të jem i kënaqur me mësimin tim në qoftë se do të kem sukses në pikat në vijim: ...
- Unë do të siguroj materialet e mëposhtme mësimore...
- Për të punuar i pa shqetësuar, unë do të marrë masat e mëposhtme: ...
- Për të përmirësuar mësimin tim, unë do t'u kërkoj mbështetje fëmijëve të mëposhtëm: ...
- Kur të ndihem i lodhur, do të marr energji të reja nga ...
- Në qoftë se unë nuk e shijoj më të mësuarit, do të ...

Instrumente për nxënësit

Instrumenti 2: Fletë pune për nxënësit, për të reflektuar për të mësuarit e tyre

- Cilat ishin veprimtaritë e para të të mësuarit?
- Cilat ishin hapat e mëtejshëm?
- Kur i lejova vetes një pushim?
- Sa kohë kam mësuar vetë?
- Sa kohë kam mësuar së bashku me një tjetër?
- Kur kam mësuar në një grup?
- A munda të mësoj në grup?
- A i kam kryer aktivitetet e mia sipas planit tim?
- A kam mundur të përqendrohem në punën time pa u shqetësuar? A kam pasur raste të mungesës së përqendrimit? A duhet të përmirësohet përqendrimi im?
- A jam i sigurt se kam mësuar mirë?
- A më ka mërzhitur të mësuarit ?
- A ndjej kënaqësi nga të mësuarit?
- Kur e kam shijuar të mësuarit?
- A kam qenë i sigurt në suksesin e të mësuarit tim? (Të mësuarit me vetëbesim)
- Si më lindi interesi për lëndën dhe si fillova të shijoj të mësuarit?
- Cilat strategji dhe teknika përdora për të mësuarit?
- A kam mësuar mirë? Çfarë kam bërë mirë, çfarë kam bërë keq?
- Çfarë ishte e vështirë për mua? Si i kam kapërcyer këto vështirësi?
- A duhet të punoj më shpejt apo më ngadalë?
- A ka ndonjë gjë që unë duhet ta ndryshoj? Si mund ta përmirësoj jetën time?
- Kjo është ajo që unë do përpiqem të arrij në detyrën time të ardhshme të të mësuarit: ...

Instrumente për nxënësit

Instrumenti 3: Fletë pune për nxënësit për reflektim për arritjet e tyre

- Çfarë kam mësuar?
- A kam bërë me të vërtetë progres?
- A e kam kuptuar me të vërtetë atë çfarë kam mësuar?
- A jam në gjendje të zbatoj aftësitë e fituara rishtazi në situata të ndryshme?
- Ku dhe kur do të mundem unë të përdor ato çka kam mësuar?
- A jam unë i kënaqur me sukseset e arritura?
- A do të dëshiroja unë të kuptoja ose të isha në gjendje të zbatoja ndonjë gjë edhe më mirë?
- A kam arritur objektivin tim të të mësuarit?
- Çfarë duhet të mësoj ende?
- A do t'i caktoj unë vetes objektiva të reja për mësimet në të ardhmen?

Instrumente për nxënësit

Instrumenti 4: Kërkimi në bibliotekë

Në biblioteka, ju mund të gjeni shumë informacione që ju nevojiten për studimin e një teme. Për ta përdorur këtë informacion, ju duhet të jeni në gjendje të merrni pjesët më të rëndësishme. Lista e mëposhtme mund t'ju ndihmojë për të gjetur informacione e duhur (hulumtim).

1. Cili është qëllimi im?

- Çfarë jam duke krijuar? Si duhet të jetë produkti përfundimtar? A duhet të jetë ai një prezantim? Një raportim? Një poster?
- Ju duhet të kërkoni për lloje të ndryshme informacioni, në varësi të qëllimit të punës tuaj. Për të krijuar një poster, ju duhet të gjeni foto të cilat mund t'i prisni; për një raport ju duhet të gjeni informacionin e saktë në lidhje me temën.

2. Çfarë informacioni më nevojitet?

- Shkruani çdo gjë që dini në lidhje me temën (një hartë mendore mund t'ju ndihmojë për këtë).
- Shkruani çdo gjë që dëshironi të dini rreth temës (pikat e nënvizuara në hartën tuaj të mendjes). Përcaktoni saktësisht se çfarë aspekti të temës do të dëshironit të mësonit. Në varësi të produktit tuaj përfundimtar, ju mund të keni nevojë të përcaktoni një numër aspektesh ose vetëm disa.

3. Si mund të gjej informacion dhe si mund ta organizoj atë?

- Shikoni në librat, revistat, filmat etj., që keni gjetur në bibliotekë dhe vendosni nëse ata mund t'i përgjigjen pyetjeve që ju keni shtruar. Kërkimi përmes indeksit ose tabelave të përmbajtjes mund t'ju ndihmojë.
- Në një fletë të veçantë, shënoni titullin e librit dhe numrin e faqes ku keni gjetur informacionin. Ju gjithashtu mund të shënoni një faqe me një letër shënjuese me ngjytës.
- Shpesh mund të jetë e dobishme fotokopjimi i faqeve të librit. Megjithatë, mos harroni të shënoni titullin e librit në kopjet e bëra.
- Shikoni fotografitë në revista. Fotokopjojeni ato ose shënoni faqet me një letër shënjuese.
- Nëse po përdorni një film, shikojeni filmin dhe ndaleni atë, sa herë që diçka interesante për çështjen tuaj shfaqet në të.
- Mblidhni materialet dhe vendosini ato të gjitha së bashku në një dosje plastike.
- Nënvizoni informacionet më të rëndësishme.
- Me fjalët tuaja, shkruani, në një fletë letre, informacionin më të rëndësishëm në lidhje me temën.

4. Si mund të paraqes informacionin?

Për shembull, Ju mund:

- të bëni një poster;
- të organizoni një ekspozitë;
- të mbani një fjalim;
- të krijoni një shfaqje me projektor ;
- të shkruani një artikull gazete;
- të shfaqni video klipe.

5. Si mund t'i vlerësoj hulumtimet e mia?

- A mësuat ndonjë gjë të re?
- A gjetët informacion mjaftueshëm e të dobishëm?
- Cilat hapa në kërkimin tuaj shkuan mirë? Çfarë ishte e vështirë?
- Çfarë do të bëni ndryshe herën tjetër?

Instrumente për nxënësit

Instrumenti 5: Kërkimi në Internet

Ju mund të gjeni informacion për çdo temë të imagjinueshme në Internet. Ju duhet të merrni parasysh si të kërkoni informacionin më thelbësor dhe më të saktë për temën tuaj.

Gjetja e informacionit

Në një copë letër, shënoni fjalët kyç në lidhje me temën tuaj të dhënë ose të zgjedhur nga ju. Përpiquni të mendoni se çfarë dëshironi saktësisht të dini në lidhje me të. Shembuj:

- EQD/EDNJ;
- Këshilli i Evropës;
Pakicat;
- Demokracia.

Kombinoni termat e kërkimit, për shembull, "tregjet e qytetit mesjetar", duke përdorur thonjëzat.

- Cilat kombinime fjalësh ju ndihmojnë për të gjetur informacionin më bashkëkohor për temën tuaj? Shënoni këto kritere në një copë letër.

Kontrolli i informacionit tuaj

Kushdo mund të hyj në Internet dhe të krijojë informacion. Për këtë arsye, është e rëndësishme që ai të kontrollohet me kujdes përpara se ta përdorni.

Për këtë qëllim, përpiquni të sqaroni problemet e mëposhtme:

- A mund të gjendet ky informacion në faqet e tjera në ueb?
- Kush e vuri këtë informacion në shërbim të publikut?
- Cili mund të jetë interesi i personit ose i organizatës që e publikoi këtë informacion.
- A është personi ose organizata e besueshme?

Krahaso informacionin nga interneti me informacione të marra nga burime të tjera:

- A mund të gjeni të njëjtat informacione në një libër, përmes një interviste ose përmes përvojave tuaja?
- A është informacioni në internet i përditësuar, i kuptueshëm, më i plotë se ai që mund ta gjeni në një libër, përmes një interviste ose përmes vëzhgimeve tuaja?
- Cili informacion i përshtatet më mirë qëllimit tuaj?

Ruajtja e informacionit

Pasi të keni gjetur një adresë të mirë në internet ku ju mund të dëshironi të ktheheni përsëri më vonë ose që dëshironi ta përdorni si burim të dhënash për punën tuaj, bëni listën tuaj personale të adresave të tilla:

- Hapni një dokument të veçantë.
- Nënvizoni URL (adresën).
- Kopjoni URL duke shtypur CTRL (kontrolli) dhe C në të njëjtën kohë.
- Paste URL në dokumentin tuaj, duke shtypur CTRL (kontrolli) dhe V në të njëjtën kohë.
- Ruaj dokumentin nën "weblast_topic", për shembull, "weblast_democracy".

Instrumente për nxënësit

Instrumenti 6: Organizimi i intervistave dhe anketave

Informacionin për një temë ju mund ta siguron kur pyesni njerëzit për njohuritë e tyre për temën ose kur u kërkon mendimin e tyre.

Ju mund të pyesni:

- specialistët - në qoftë se dëshironi të gjeni diçka të veçantë në lidhje me një temë; ose
- njerëz të cilët nuk kanë ndonjë përvojë specifike për këtë temë, por ju keni interes të dini se çfarë mendojnë ata për temën tuaj.

Intervistat ose vrojtimit bëhen më të mirë së bashku në një grup të vogël. Në këtë mënyrë ju mund të ndihmoni njëri-tjetrin me pyetje dhe me regjistrimin e përgjigjeve.

Shkoni përmes këtyre pikave në listë:

- Shkruani një përgjigje të shkurtër për çdo pyetje.
- Shënoji pyetjet për të cilat nuk keni marrë përgjigje.
- Diskutoni çdo pyetje të hapur me klasën tuaj.

Hapat për t'u ndërmarrë

1. Qëllimi

- Cila është tema jonë? Çfarë duam të dimë?
- Si duhet të duket produkti ynë final?

2. Përgatitja

- Kush duhet të intervistohet? Sa persona? A luan ndonjë rol mosha ose gjinia?
- Si t'i zgjedhim personat e duhur?
- Kur duhet të zhvillohet intervista/sondazhi?
- Si duhet të zhvillohet ajo?
- Kush duhet të informohet ose prej kujt duhet të marrim leje?
- Si do të regjistrohen përgjigjet (të regjistrohen në kasetë, shënime, pyetësorë)?

3. Pyetjet

- Çfarë pyetje duhet të drejtojmë?
- Sa pyetje mund të drejtojmë? Sa kohë kemi në dispozicion?
- Vendosi pyetjet së bashku për të formuar një pyetësor.

4. Kryerja e vrojtimit/intervistës

- Si të fillojmë me pyetjet?
- Si t'i ndani rolet në grup (drejtimi i pyetjeve, regjistrimi i përgjigjeve, fillimi dhe ndalimi i regjistrimit)?
- Si ta përfundojmë intervistën?

5. Vlerësimi

- Nëse keni intervistuar një specialist, mendoni për gjërat më të rëndësishme që ai tha dhe nxirrini ato në pah.
- Nëse keni pyetur disa njerëz për të njëjtën temë dhe do të doni të dini se sa njerëz dhanë përgjigje të ngjashme, i gruponi përgjigjet për këtë qëllim.

6. Prezantimi

Vendosni nëse prezantimi do të jetë:

- për t'u ndarë me klasën;
- për të shkruar një artikull gazete;
- për të krijuar një poster;
- për diçka tjetër.

Instrumente për nxënësit

Instrumenti 7: Si të interpretojmë fotografitë

Ashtu si tekstet, edhe fotografitë përmbajnë mjaft informacion. Këshillat e mëposhtme do t'ju ndihmojnë për të interpretuar dhe për të kuptuar fotot.

Zbuloni informacion në lidhje me foton

- Cilat janë ngjyrat më të rëndësishme në foto?
- Ku janë format, modelet dhe linjat më të dukshme?
- Çfarë është më e madhe ose më e vogël se normalja?
- Sa e madhe është në realitet sendi / personi në foto?
- Çfarë periudhe kohore (e kaluara, e tashmja) dhe çfarë kohe e vitit ose ditë është paraqitur në foto?
- Nga ç'këndvështrim e shihni subjektin në foto: përmes syve të një bretkoc, një zogu ose të një personi?
- Çfarë mund të dalloni në foto?
- Çfarë lloj fotografie është ajo (foto, poster, pikturë, gdhendje druri, grafikë, kolazh, portret, peizazh, ose karikaturë, etj)?
- Çfarë është e ekzagjeruar ose e theksuar në foto (dritë/hija/, përmasat, plani i parë/sfondi, ngjyrat, lëvizja/qetësia, gjestet, shprehjet e fytyrës)?

Nxirrni në foto

- Çfarë është veçanërisht e rëndësishme në foto?
- Çfarë pëlqeni në lidhje me të?
- Cilat janë karakteristike për fotot?
- Si ndiheni kur shikoni tek fotoja?
- Cila pjesë e fotos është më e bukur?
- Çfarë ju vjen në mendje kur shikoni në foto?

Diskutoni foton

- Përshkruani foton me fjalët tuaja.
- Tregojini njëri-tjetrit se çfarë është me kuptim, më dalluese ose e rëndësishme në foto.
- Drejtojini njëri-tjetrit pyetje rreth fotos.
- Jepini komanda të shkurtra njëri-tjetrit, të tilla si: kërkoni për, gjeni, tregoni, shpjegoni...
- Diskutoni pyetje të tilla si: Përse janë zgjedhur këto foto? Cila foto plotëson tekstin që i përket fotos? Cila foto bie ndesh me atë që është shkruar në tekst?

Puna me fotot

- Zgjidhni një foto dhe aktroni skenat që shihni atje.
- Prezantoni personin që shihni në foto.
- Ndryshojini fotot dhe komentoni për to.
- Krahasoni fotografitë historike me fotot që ju keni.

- Shpjegoni çfarë do të ishte e vështirë për t'u kuptuar në tekst, në qoftë se ju nuk do të kishit pasur ndihmën e fotove.
- Shtoni foto të përshtatshme që plotësojnë tekstin.
- Krahasoni fotot dhe vlerësojini ato. A ju pëlqejnë ? Nëse jo, pse?
- Bëni një përshkrim të fotos me shkrim.
- Mendoni se çfarë ka ndodhur pak para se të bëhej kjo foto ose të pikturohej/vizatohej.
- Mendoni se çfarë do të ndodhte nëse fotoja do të ishte e gjallë.
- Shtoni disa flluska me fjalë, si tekst për foton.
- Përshkruani aromat dhe tingujt për të cilat ju bën të mendoni fotoja.
- Mblidhni fotot të subjekteve të ngjashme.

Interpretoni fotot

- Çfarë titulli do t'i vinit fotos?
- Ku është nxjerrë, pikturuar/vizuar kjo foto?
- Çfarë ka dashur të shprehë fotografi/artisti me këtë foto?
- Përse është realizuar, pikturuar/vizuar kjo foto?

Instrumente për nxënësit

Instrumenti 8: Hartat mendore

Një hartë mendore ju ndihmon të organizoni mendimet tuaja. Këtë do të thotë termi fjalë për fjalë. Hartat mendore mund të jenë të dobishme në shumë situata të ndryshme, kur ju duhet të mendoni për një temë të veçantë: grumbullimi i ideve, përgatitjet për një prezantim, planifikimi i një projekti etj.

Shikoni në hartën mendore më poshtë:

- Cilat janë kategoritë kryesore? Cilat janë nënkategoritë?
- A do të shtonit ju terma të tjerë? Nëse po, cilat?

Udhëzime për krijimin e një hartë mendore

- Shkruani emrin e temës suaj në mes të copës së letres dhe vizatoni një rreth përreth saj. Përdorni letër të madhe.
- Vizatoni disa vija të trasha që nisin nga qendra e rrethit dhe vazhdojnë jashtë tij. Në çdo linjë, shkruani emrin e një nëntemë të lidhur me temën kryesore në mes.
- Nga linjat e trasha, ju mund të vizatoni viza më të holla shtesë që përfaqësojnë nënkategoritë ose pyetjet e lidhura me nëntemën e shkruar në vijën e trashë.
- Përpiquni të gjeni sa më shumë terma të ndryshëm që të mundeni dhe vendosini ato në kategoritë e sakta. Ju mund të përdorni madhësi shkrimi, simbole dhe ngjyra të ndryshme.

Krahasoni hartën tënde mendore me ato të shokëve të klasës

- Çfarë vini re?
- Në çfarë aspektesh janë të ngjashme hartat tuaja mendore?
- Në çfarë aspektesh ato janë të ndryshme?
- Cilat janë termat/konceptet më të rëndësishme?
- A ka kuptim organizimi i nënkategorive?
- A mungon ndonjë gjë e rëndësishme?
- Çfarë do të bëni ndryshe herën tjetër?

Instrumente për nxënësit

Instrumenti 9: Si të krijojmë postera

Një poster ju lejon të regjistroni punën tuaj dhe ta paraqisni atë për shokët e klasës suaj. Është e rëndësishme që një poster të organizohet në një mënyrë që të tërheqë vëmendjen e njerëzve. Ai duhet t'i bëjë vëzhguesit kurioz për të mësuar më shumë.

Në një grup të vogël, shqyrtoni karakteristikat e rëndësishme të një posteri të suksesshëm dhe mendoni elementet që mund t'i integroni në posterin tuaj.

Nëse e keni përgatitur tashmë posterin tuaj, ju mund t'i përdorni këto karakteristika si një listë e plotë për të vlerësuar një poster tjetër.

Listë e kriterëve

Titulli: duhet të jetë i shkurtër dhe interesant; i dukshëm edhe në distancë.

Shkrimi: duhet të jetë i madh dhe i lexueshëm. Në qoftë se përdorni kompjuterin, mos përdorni shumë fonte të ndryshme. Shkruani fjali të shkurtra që janë të dukshme edhe nga distancat që mundëson klasa.

Pikturat, fotografitë, grafikët: këto duhet të mbështesin atë që ju keni për të thënë dhe ta bëjnë posterin interesant. Përqendrohuni vetën në ato që janë mbresëlënëse.

Prezantimi: ku duhet të vendosen titulli, nëntitujt, pikat, simbolet, kutitë, fotografitë ose grafikët? Skicoheni posterin tuaj para se të filloni.

Montojini ato me kujdes: posteri duhet të plotësojë/mbushë formatin e zgjedhur, por nuk duhet të jetë shumë i ngjeshur.

Instrumente për nxënësit

Instrumenti 10: Si të organizojmë ekspozita

Një ekspozitë ndihmon grupet e nxënësve të paraqesin punën e tyre në mënyrë që të tjerët (klasa ose mysafirë të ftuar) mund të marrin një ide se çfarë kanë bërë grupet. Lista e plotë e mëposhtme mund t'ju ndihmojë të planifikoni dhe të organizoni një ekspozitë.

Listë e plotë

1. Çfarë duam të tregojmë?

- Cili është mesazhi kryesor që përpiket të përçojë ekspozita jonë?
- Çfarë titulli mund t'i vëmë ekspozitës sonë?

2. Cila është audiencia?

- Fëmijët dhe mësuesit nga shkolla jonë?
- Prindërit dhe vëllezërit e motrat?
- Klientë nga një zyrë turistike?

3. Ku do të organizohet ekspozita?

- Në klasë ose diku në shkollë?
- Në një vend publik (për shembull, në bashkinë e qytetit)?
- A do të ketë hapësirë dhe dritë të mjaftueshme?
- A do të jemi në gjendje të kemi infrastrukturën e nevojshme?

4. Si mund të organizojmë një ekspozitë të paharrueshme?

- A do të lejoj prekjen e modeleve dhe objekteve?
- A do të lejoj hapësirë për të luajtur, për të provuar gjërat, vëzhgimin ose eksperimentimin?
- A do të lejoj të luhet muzikë apo do të luaj vetë?
- A do të ofroj ushqime të lehta?
- A do të siguroj ciceronë nëpër ekspozitë?
- A duhet të krijoj një fletëpalosje si udhëzues për ekspozitën?
- A do të organizoj një garë ose një kuic?

5. Kush duhet të njoftohet paraprakisht?

- Mësuesit e shkollës sonë?
- Kujdestarët?
- Anëtarët e bordit të shkollës?
- Drejtori i shkollës?
- Ekspertë të cilët mund të na ndihmojnë?
- Të ftuarit?

6. Çfarë duhet të bëjmë?

- Të krijojmë një listë të plotë personale?
- Të krijojmë një listë të materialeve?

- Të krijojmë një plan kohor (kush do të jetë përgjegjës për gjithçka dhe kur duhet t'i realizojë?)
- A duhet të dimë sa para kemi në dispozicion dhe sa është përdorur?
- A duhet të krijojmë një fletëpalosje ose një ftesë?
- A duhet të informojmë gazetatat lokale?

7. Si do të vlerësohet ekspozita?

- Cilat janë kriteret më të rëndësishme?
- Kush do të vlerësojë ekspozitën (mësuesit, shokët e klasës, të ftuarit)?

Instrumente për nxënësit

Instrumenti 11: Si të planifikojmë dhe të prezantojmë

Ju mund të mbani një fjalim për shokët e klasës, prindërit ose fëmijët e tjerë të shkollës suaj. Në çdo rast, ju duhet të përgatiteni mirë për fjalimin tuaj. Lista e plotë e mëposhtme do t'ju ndihmojë të bëni këtë.

Planifikimi i një fjalimi

1. Kush do të dëgjojë?

- Ku duhet ta mbani fjalimin tuaj?

2. Kush do të përgatisë fjalimin?

- A do ta përgatisni vetëm apo në grup?
- Si është organizuar vetë grupi?

3. Cili është qëllimi i fjalimit?

- Çfarë duhet të mësojnë audienca?
- A duhet t'ju japë audienca mendime për fjalimin?

4. Sa kohë keni në dispozicion?

- A duhet t'i lini kohë audiencës për të bërë pyetje?
- A duhet t'i lini kohë audiencës për t'ju dhënë komente?

5. Cilat burimesh keni në dispozicion?

- Dërrasë e zezë / dërrasë e bardhë?
- Video projektor?
- Kompjuter dhe projektor për prezantim në PowerPoint?
- Postera (tabelë)?
- Stereo?

6. Si mund ta përfshini ju audiencën tuaj?

- Jepni kohë për pyetje.
- Krijoni një gjëgjëzë ose një kuic.
- Kaloni përreth objekteve.

7. Çfarë doni të thoni?

- Mendoni për tre deri në gjashtë tituj që janë të rëndësishëm për temën tuaj dhe shkruajini ato në një fletë letre të veçantë.
- Në çdo copë letre, shënoni disa fjalë kyçe për çdo titull.

Mbajtja e fjalimit

Një prezantim mund të ndahet në pjesë të ndryshme: hyrja, pjesa kryesore dhe përfundimi. Këtu janë ofruar disa ide për t'ju ndihmuar në mbajtjen e fjalimit.

1. Hyrja

- Filloni me një citat për temën ose duke treguar një foto ose objekt për të.

- Paraqisni temën kryesore.
- Shpjegoni si do të strukturohet fjalimi.

2. Pjesa kryesore

- Informoni audiencën rreth subjektit të fjalimit.
- Vendosi fletët e parapërgatitura për të treguar titujt dhe informacionin sipas një rendi të caktuar.
- Organizoni fjalimin sipas këtyre titujve.
- Sa herë që filloni me një titull të ri, bëjeni këtë të qartë duke përdorur një foto ose shpjegim.
- Paraqisni një foto, objekt ose pjesë muzikore që lidhet me çdo titull.
- Mendoni si do t'i tregoni fotot, për shembull, nëse do t'i kaloni ato dorë më dorë, do t'i kaloni në një videoprojektor ose do t'i shfaqni në një poster.

3. Përfundimi

- Thoni çfarë ishte e re për ju.
- Thoni çfarë keni mësuar.
- Tregoni një fotografi të fundit.
- Bëjini një kuic shokëve të klasës.
- Lërnini kohë në dispozicion për pyetje.

Instrumente për nxënësit

Shpesh herë prezantimet paraqiten në PowerPoint ose me fletë transparente në një projektor. Rregullat janë të njëjta për të dyja mënyrat.

Kur krijoni një fletë transparente për paraqitje me projektor, bëni kujdes që:

- shkrimi të jetë i qartë dhe i lexueshëm;
- të përdoret vetëm një lloj shkronje;
- të ketë hapësirë të mjaftueshme mes rreshtave;
- të mos ketë shumë tekst të shkruar;
- fletat transparente të jenë të pastra, pa njolla;
- fotot, hartat dhe grafikët të jenë qartësisht të dallueshëm;
- të përdoren vetëm pak ngjyra dhe simbole të ndryshme;
- numri fletëve të mos jetë i madh.

Cila është zgjedhje më e mirë: projektorët me fletë transparente apo një prezantim në PowerPoint?

Për secilin ka avantazhe dhe dizavantazhe. Këtu do të gjeni disa të dhëna të rëndësishme që mund t'ju bëjnë më të lehtë zgjedhjen mes tyre.

Cila prej tyre i shërben më mirë qëllimit tuaj?

Lexoni pikat e mëposhtme për të ndihmuar në zgjedhjen tuaj.

Projektorët janë të mirë në qoftë se ju:

- keni më pak se pesë fleta transparente për të paraqitur;
- dëshironi të tregoni ose të shpjegoni diçka në mes shfaqjes së fletave transparente;
- dëshironi të shkruani në një fletë transparente gjatë prezantimit;
- dëshironi vetëm të tregoni një foto në çdo fletë transparente;
- dëshironi të mbuloni dhe zbuloni diçka në foto;
- dëshironi të ndani detyrën në grupin tuaj dhe të caktoni një fletë transparente për secilin anëtar të grupit.

Prezantimet në PowerPoint janë të mira, në qoftë se ju:

- keni shumë informacion për të paraqitur;
- keni një numër të madh sliderash;
- dëshironi të tregoni pjesë informacioni njëra pas tjetrës në të njëjtën slider;
- dëshironi të tregoni diçka nga Interneti gjatë prezantimit tuaj;
- dëshironi të tregoni një videoklip, një imazh dixhital ose diçka që është e ruajtur në kompjuterin tuaj;
- të përdorni këtë video në një moment të mëvonshëm në kohë ose ta paraqitni atë në një mënyrë krejt tjetër.

Instrumente për nxënësit

Instrumenti 13: Si të shkruajmë artikuj për gazetat

Për të informuar të tjerët në lidhje me temën tuaj, ju mund të bëni, duke luajtur rolin e një gazetari që dëshiron të shkruajë një artikull për një gazetë. Në EQD/EDNJ, të shkruajturit e një artikulli është një mënyrë për të bërë temën tuaj publike. Kjo mund të ndihmojë për të ndryshuar gjërat e këqija në shoqëri.

Një artikull gazete është i ndarë në seksione të ndryshme:

- titulli: duhet të jetë i shkurtër dhe i qartë;
- paragrafi i parë: një hyrje në temë me shumë pak fjali të shkurtra;
- autorët: cili e shkroi artikullin?
- teksti në vijim: vetë artikull;
- nëntitujt: për të ndihmuar lexuesin për të parë "kapituj";
- foto: një foto kuptimplote e treguese për tekstin me një shpjegim të shkurtër nën të.

Listë e kriterëve

- Krahaso një artikull gazete (nga gazeta e sotme) me shembullin që ju shihni më sipër. A mund t'i dalloni seksionet e ndryshme?
- Theksoni seksionet duke përdorur ngjyra të ndryshme.
- Kushtojini vëmendje stilit dhe shkronjave (të theksuara, normale, të pjerrëta).
- Krahasoni artikullin e gazetës suaj me ato të shokëve të tu.
- Përdorini këto seksione në vetë artikullin e gazetës suaj.

Instrumente për nxënësit

Instrumenti 14: Si të vëmë një pjesë në skenë

Aktrimi i pjesëve është një mënyrë e mirë për të pasqyruar jetën e njeriut. Ju mund të krijoni skena duke përdorur një foto, një pjesë muzikore ose një objekt. Kur ju aktroni, ju merrni një rol. Kjo do të thotë që, ju përpiqeni të merrni ndjenjat e një personi të caktuar dhe të veproni si ai. Pas shfaqjes, të gjithë do të jenë në gjendje të mendojnë se cilat pjesë të shfaqjes ishin "të vërteta" dhe cilat ishin pjesë imagjinare.

Aktrimi i "Lirë"

- Shkruani fjalët kyç që përfaqësojnë lojën.
- Vendosni kush do të luajë secilin rol dhe çfarë është e rëndësishme për t'u mbajtur mend në çdo rol.
- Mblidhni të gjitha materialet e nevojshme.
- Përsëritni tekstin.
- Përgatitni skenën.
- Shijoni shfaqjen.

Më pas, diskutoni pyetjet e mëposhtme:

- Çfarë mundët të shihnit?
- A u kuptua gjithçka?
- Çfarë ishte e mirë?
- A mungonte ndonjë gjë sipas mendimit tuaj?
- A kishte teprime?
- Çfarë pyetjesh kemi në lidhje me përmbajtjen?

Krijimi i lojës aktoriale nga një tekst

Lexoni historinë së bashku dhe krijoni skena:

- Kush ishte i përfshirë? Ku ka ndodhur ajo?
- Si e kanë trajtuar njerëzit situatën? Çfarë thanë ata?
- Si reaguan të tjerët?
- Si përfundoi historia?
- Vendosni për numrin e akteve të shfaqjes.
- Kush do të luajë rolet? Çfarë kostumet nevojiten?
- Përsëritni lojën tuaj.
- Vlerësoni lojën tuaj së bashku me shokët e klasës.

Krijimi i lojës aktoriale nga një imazh

- Kërkoni një foto që mund të përdoret si bazë për një dramë.
- Imagjinoni veten në foto.
- Mblidhni ide: si jetonin njerëzit që shihni në foto? Për çfarë janë ata të lumtur? Cilat janë pakënaqësitë e tyre?
- Krijoni një lojë aktoriale duke përdorur këtë foto dhe shënoni fjalët kyçe për çdo skenë.

- Vendosni për numrin e akteve.
- Vendosni kush do të luajë në role dhe çfarë është e rëndësishme në secilin rol.
- Përsëritni lojën dhe gjeni materialet e veshjet.
- Përgatisni skenën dhe ftoni të ftuarit.
- Vlerësoni lojën tuaj së bashku me shokët e klasës.

Instrumente për nxënësit

Instrumenti 15: Si të organizojmë debate

Një debat mund të ndihmojë për të na bërë të vetëdijshëm për mendimet e ndryshme në lidhje me një temë dhe për të kuptuar avantazhet dhe dizavantazhet e çështjeve të diskutueshme. Për të zhvilluar një debat, nevojitet të gjendet një çështje kundërshtuese që mund të përgjigjet me një po ose një jo. Në një demokraci, ekzistojnë gjithmonë më shumë se një zgjidhje ose një mendim.

Dy opinione - një debat

Ja si funksionon:

- Ndani klasën në dy grupe. Një grup është "pro" (në favor të çështjes), grupi tjetër është "kundër" çështjes.
- Secili grup gjen argumentet e mundshme për të mbështetur mendimin e tij. Ato gjithashtu duhet të zbulojnë argumente që shkojnë kundër mendimit të grupit tjetër.
- Shënojin argumentet tuaj duke përdorur fjalët kyç.
- Secili grup cakton dy folës.
- Debatu është i organizuar në tri pjesë: pjesa e hapjes, një debat i hapur dhe pjesa e mbylljes:
 - pjesa e hapjes: secili folës shpjegon shkurtimisht argumentin e tij. Grupi "pro" dhe ai "kundër" marrin radhën e flasin për paraqitjen;
 - debati: folësit paraqesin argumentet e tyre dhe përpiqen të kundërshtojnë argumentet e palës kundërshtare;
 - pjesa e mbylljes: kjo pjesë ka të njëjtën procedurë si ajo e hapjes. Çdo person ka mundësinë të përmbledhë mendimin e tij.

Kohëmbajtësi

Zgjidhni dikë nga klasa, që është përgjegjës për mbajtjen e kohës gjatë debatit.

- Pjesa e hapjes duhet të zgjasë jo më shumë se tetë minuta (çdo person mund të flasë për dy minuta).
- Debatu duhet të zgjasë jo më shumë se gjashtë minuta.
- Pjesa e mbylljes duhet të zgjasë jo më shumë se katër minuta (një minutë për person).
- Nëse dikush e kalon kohën e caktuar, bie një zile.

Vëzhguesit

Nxënësit që nuk flasin gjatë debatit vëzhgojnë se çfarë ndodh. Pas debatit, ata thonë se çfarë kanë vënë re, duke përdorur pikat e mëposhtme si bazë:

- Cilat janë argumentet që u paraqitën?
- Si u ndanë përgjegjësitë dhe detyrat e zbatimit?
- A u lejua çdo folës të flasë apo u ndërpre ?
- Si u përpoqën folës të ndryshëm të përçonin mesazhin e tyre?
- Cilat argumente ishin më bindëse?
- Cilët qenë argumentet më të mira që u paraqitën?
- Cilat qenë fjalët që u përdorën më shpesh?
- Si e shprehën folësit mesazhin e tyre (duke përdorur gjuhën e trupit, me lartësinë dhe tonin e duhur të zërit)?

Objektivi i këtij manuali është të mbështetë mësuesit dhe praktikuesit në Edukimin për Qytetari Demokratike dhe Edukimin për të Drejtat e Njeriut (EQD/EDNJ). Ai u drejtohet çështjeve kryesore rreth EQD dhe EDNJ, duke përfshirë kompetencat për qytetari demokratike, objektivat dhe parimet bazë të EQD/EDNJ, dhe gjithë qasjen e shkollës ndaj edukimit për demokraci dhe të drejtat e njeriut.

Manuali përbëhet nga tre pjesë. Pjesa I përshkruan parimet bazë të EQD/EDNJ deri në momentin që ato janë të dobishme dhe logjikshme për praktikantin. Pjesa II jep udhëzime dhe mjete për të hartuar, mbështetur dhe vlerësuar proceset e nxënësit në të mësuarit konstruktivist dhe ndërveprues. Pjesa III ofron instrumenta për mësuesit dhe nxënësit në EQD/EDNJ.

Vëllimet e tjera në këtë seri ofrojnë modele konkrete të mësuarit dhe materiale në fushën e EQD/EDNJ për nxënësit, nga arsimi fillor deri në atë të lartë të shkollës së mesme.

Ky është Volumi I nga një seri prej gjashtë librash:

EQD/EDNJ Vëllimi I	<i>Edukimi për demokraci - Materiale në ndihmë të mësuesve të edukimit për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut</i>
EQD/EDNJ Vëllimi II	<i>Rritemi në demokraci - Njësi mësimore për edukimin për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut në arsimin fillor</i>
EQD/EDNJ Vëllimi III	<i>Të jetojmë në demokraci - Veprimtari mësimore për qytetarinë demokratike dhe për të drejtat e njeriut për arsimin e mesëm të ulët</i>
EQD/EDNJ Vëllimi IV	<i>Të marrim pjesë në demokraci - Njësi mësimore për edukimin për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut në ciklin e mesëm të lartë</i>
EQD/EDNJ Vëllimi V	<i>Të eksplorojmë të drejtat e njeriut - Nëntë projekte të shkurtëra për arsimin fillor</i>
EQD/EDNJ Vëllimi VI	<i>Mësimdhënia e demokracisë - Një përmbledhje modelesh për qytetarinë demokratike dhe për të drejtat e njeriut.</i>

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

<http://book.coe.int>
Këshilli i Evropës

Këshilli i Evropës ka 47 shtete anëtare, duke mbuluar pothuajse të gjithë kontinentin e Evropës. Ai kërkon të zhvillojë parime të përbashkëta demokratike dhe ligjore në bazë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe dokumente të tjera të referencë për mbrojtjen e individëve. Që kur ai u themelua në vitin 1949, pas Luftës së Dytë Botërore, Këshilli i Evropës ka simbolizuar pajtimin.